



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

**RAPORTI**  
**I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK**

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në**  
**“Inxhinieri Ndërtimi”**  
**“Universiteti “Metropolitan Tirana””**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:


Prof. Assoc. Gafur Muka

Dr. Julian Kashaaraj

Shtator/2021

**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT****Për Programin e studimit: Bachelor në "Inxhinieri Ndërtimi"**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti "Metropolitan Tirana"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit (Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës)
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 357, datë 12.05.2010
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	UMASh Nr. 339, datë 19.08.2013
6	Urdhëri i regjistrimit të Formës së diplomës:	Urdhër QSHA Nr. 362, Datë 23.12.2019
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	UMAS Nr. 10, datë 07.01.2016, bazuar në VKA Nr. 102, datë 3.11.2015, dhe VKA Nr. 102/1, datë 18.12.2015
8	Cikli i studimit:	Cikli I
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	JO
13.1	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
13.2	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
14	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
15	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	<b>16 PAE /9 PAK</b> (ngarkesa mësimore <b>71.3% PAE /28.7% PAK</b> )
16	Numri i studentëve (tre vitet e fundit):	90 Studentë
17	Komente / të tjera:	



## **TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Universiteti "Metropolitan Tirana" u licencua me Vendim Nr.357, datë 12.05.2010 të Këshillit të Ministrave me statusin e Shkollës Private të Arsimit të Lartë "Universiteti Metropolitan Tirana" (Aneksi Nr.05, VKM e licencimit të UMT). Në zbatim të ligjit nr.80/2015 për arsimin e lartë, UMT me Urdhrin nr. 611, datë 28.09.2018 të ministrit përgjegjës për arsimin ka miratuar Statutin e tij, tashmë me statusin si Universiteti "Metropolitan Tirana" (Aneksi Nr.01, Statuti i UMT). Universiteti "Metropolitan Tirana", me njësitë kryesore të tij është akredituar institucionalisht në dhjetor/ 2017, nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë (ASCAL) në bashkëpunim me Agjencinë Britanike të Sigurimit të Cilësisë për një periudhë 5-vjeçare. Pas riorganizimit të UMT si universitet dhe miratimit të statutit të ri, është akredituar, me Vendim të Bordit të Akreditimit, Nr.45, datë 05.07.2019 (Aneksi Nr.13, VBA për akreditimin institucional).

Aktualisht, Universiteti "Metropolitan Tirana" përbëhet nga 3 fakultete dhe secili prej tyre ka në përbërje tre njësi bazë, të organizuara si më poshtë:

**Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës**, që përbëhet nga:

- Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit;
- Departamenti i Arkitekturës dhe Urbanistikës;
- Departamenti i Shkencave të Natyrës.

**Fakulteti i Ekonomisë**, që përbëhet nga:

- Departamenti i Shkencave Administrative;
- Departamenti Financë Bankë;
- Departamenti i Informatikës Ekonomike.

**Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT**, që përbëhet nga:

- Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike;
- Departamenti i Inxhinierisë Elektrike dhe Elektronike;
- Qendra Kërkimore Shkencore.

Programi i ciklit të parë të studimit Bachelor në "Inxhinieri ndërtimi" është hapur për herë të parë në vitin akademik 2011-2012 në zbatim të UMASH nr. 519 datë 18,10, 2011 "Për lejen e veprimtarisë akademike të programeve të studimit të ciklit të parë Bachelor në UMT". Akreditimi i parë i programit është sipas Vendimit të Këshillit të Akreditimit Nr. 102, datë 03.11.2015, dhe 102/1, datë 18.12.2015 dhe Urdhërit të MASR Nr. 102, datë 07.01.2016.

**Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës (FIA)** është njësi kryesore e cila ofron programin e studimit Bachelor në "Inxhinieri Ndërtimi". Njësia bazë përgjegjëse për mbarëvajtjen, organizimin dhe cilësinë e tij është **Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit** në bashkëpunim me njësitë të tjera akademike si dhe strukturave ndihmës akademike, administrative, të cilat japin kontributin respektiv në realizimin e procesit akademik, shkencor dhe administrativ, në funksion të programit të studimit (Aneksi Nr. 4, Organigrama e UMT). Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës, ofron 1 program të ciklit të parë, Bsc në Inxhinieri Ndërtimi), 1 program të ciklit të dytë, MSc në Inxhinieri Ndërtimi dhe 1 Program Studimi integruar Msc, MSc (PI) në Arkitekturë si dhe 2 programe studimi profesionale dyvjeçare. (Aneksi Nr. 52, lista e programeve që ofron FIA në UMT).

Programi në shqyrtim ofrohet në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL" dhe akteve nënligjore në funksion të tij.


Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr 219, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 3



## SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

### Rekomandimi i Këshillit të Akreditimit në Vendimin nr. 102, datë 03.11.2015:

Institucioni të parashikojë politika për rritjen e cilësisë së studentëve, në hyrje për këtë program studimi

#### Analiza e përbushjes së rekomandimit:


Për përbushjen e këtij rekomandimi, UMT ka ndjekur nje plan veprimi.

1. Organizimi i kurseve falas për maturantët e shkollave të mesme, para sezonit te provimeve të maturës.
2. Zhvillimin e mësimave suplementare për studentët që pranohen në UMT, sidomos në shkencat e matematikës dhe fizikës. Leksione dhe ushtrime zhvillohen para fillimit të programit mësimor, por edhe në javët e para të semestrit të parë në vitin e parë.
3. Organizimin e konsultimeve për të gjithë lëndet ku studentet paraqesin dobësi.
4. Politika e bursave, që motivon studentët me rezultate të shkëlqyera
5. Ekperienca e Alumni-t të suksesshëm, që kanë përfunduar Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi, të punësuar në kompani, të fushës së ndërtimit apo që kanë vazhduar studimet në UMT (Master i Shkencave ne Inxhinieri Ndërtimi), është një tjetër instrument, i cili ka rezultuar efikas në përthithjen e maturantëve me rezultate të larta.

Rritja e cilësisë ne hyrje në UMT jepet edhe në Tabelën më poshtë:

Rezultatet e studentëve në hyrje në programin Bachelor: Sipas viteve akademike	Studente të regjistruar për herë të parë në vitin e parë	Nota mesatare ne hyrje
Viti 2017 -2018	14	7.45
Viti 2018 -2019	13	7.49
Viti 2019 -2020	11	7.91
Viti 2020 -2021	13	8.53

GVJ mendon se bazuar në të dhënat, dokumentacionin e vënë në dispozicion, Rekomandimi i Këshillit të Akreditimit është përbushur.



## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Mbështetur në VKM nr.109/2017, ASCAL ka përcaktuar kohën dhe grupet e vlerësimit të jashtëm për vlerësimin e programit të studimit të ciklit të parë Bsc në “Inxhinieri ndërtimi”.

Bazuar në Urdhërin nr. 48, datë 24.06.2021, “Për përcaktimin e ekspertëve në akreditimin e programit të studimit”, grupi i vlerësimit përbëhet nga:

- Prof.Assoc. Gafur Muka
- Dr. Julian Kasharaj

Gjatë gjithë procedurës GVJ është asistuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL, ME. Renata Qatipi.

Përmes sistemit të ASCAL, ekspertëve të jashtëm ju vu në dispozicion i gjithë dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni për vlerësimin e programit të studimit.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit ekspertët përgatitën draft raportin dhe hartuan një gamë pyetjesh të cilat ndihmuan në qartësimin e disa pikave dhe problematikave të këtij raporti.

Gjatë vizitës së kryer në UMT, në datat 08-09 Korrik 2021, u zhvilluan një sërë takimesh mes grupit të vlerësimit të jashtëm dhe përfaqësuesve të Universitetit Metropolitan Tirana. Këto takime u shoqëruan me diskutime intensive dhe në përfundim të tyre GVJ hartoi raportin e mëposhtëm, i cili paraqet mendimet e ekspertëve të jashtëm mbi këtë program studimi.

Në fund të raportit ekspertët kanë hartuar disa rekomandime, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të programit.

Më datë 03.08.2021, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare me Nr. 26/27 Prot., datë 30.08.2021 “Njoftim për dërgimin e Draft - Raportit të Vlerësimit të Jashtëm”, “Universiteti “Metropolitan Tirana”” është njohur me Draft-Raportin e vlerësimit të jashtëm.

“Universiteti MT” përcjell përgjigjen për Draft-Raportin përmes sistemit AMS dhe zyrtarisht me shkresë Nr. 260/1 Prot., datë 01.09.2021 “Kthim përgjigje “Njoftim për dërgimin e Draft - Raportit të Vlerësimit të Jashtëm”, në kuadër të akreditimit të programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Ndërtimi”. Në këtë dokument institucioni deklaron se nuk ka komente për Draft Raportin e Vlerësimit të jashtëm. Kështu Draft Raporti kthehet në Raport përfundimtar



## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Inxhinieri Ndërtimi”

### I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

<b>Standardi I.1</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Referuar dokumentacionit bazë të dosjes së vetvlerësimit (DVV) si dhe gjetjeve gjatë vizitës në institucion (Shënimet e takimeve), GVJ konkludon që programi i studimeve Bachelor në “Inxhinieri Ndërtimi” është një program studimi me programe lëndësh të përditësuara, të konkurueshme e me produkt cilësor për tregun e punës. Të gjitha këto aspekte sjellin që ky program studimi ofrohet në përputhje me interesin kombëtarë për të realizuar nevojat e vendit në fushën e ndërtimit.  Aneksi Nr. 3; Aneksi Nr. 53; Shënimet e takimeve			
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi është ofruar nga Universiteti Metropolitan Tirana që në vitin akademik 2011-2012, me hapjen e UMT. Nga pervoja e fituar (prej 10 vitesh) dhe planeve strategjike të Universitetit, rezulton se ky program në nivel kombëtar është në vijimësi të ruajtjes dhe konsolidimit të vlerave akademike e shkencore.  Aneksi Nr1; Aneksi Nr.2, Aneksi 53.			
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Bazuar në dy dokumentet themelore të universitetit Statuti dhe Plani i zhvillimit strategjike të UMT, te dokumentacioni për kurrikulen e këtij programi, si dhe takimeve në UMT, rezulton se programi i studimit Bachelor në Inxhinieri ndërtimi është në linjë me qëllimet dhe misionin e institucionit, ashtu siç paraqitet evidencat e sipërcituara.  Aneksi Nr1; Aneksi Nr.3, Aneksi 53			
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Referuar elementëve të programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi të paraqitura si evidencë në DVV konstatohet se kurrikula është hartuar dhe organizuar për të nxjerrë të diplomuar cilësorë, me aftësi dhe kompetenca të duhura, që i shërbejnë studentit në cdo vend/pozicion ku ai angazhohet.  Aneksi 53			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### **Standardi I.2 Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshatje dhe në zbatim të	Referuar RVB, ku është përvcaktuar se <i>Profili akademik dhe orientimi i programeve, objektivat, fushat lëndore, struktura dhe organizimi, rezultatet e pritura të të nxënit dhe kualifikimet e synuara profesionale zhvillohen sipas Kornizes Kombëtare te Kualifikimeve për Arsimin e Lartë; UMT synon të pregatise individë të kualifikuar, produktivë dhe kompetentë në fushat e tyre, të</i>


 

strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	<p><i>orientuar drejt kërkimit shkencor</i>, si dhe nga takimet e realizuar ne institucion, rezulton se program i studimit Bachelor në Inxhinieri ndërtimi është konceptuar në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit, me misionin dhe objektivat strategjikë të tij</p> <p>Aneksi Nr.3, Aneksi Nr.01</p>			
<b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	<p>GVJ referuar dokumenteve rregullativ te UMT, Statutit dhe rregullores se tij, rezulton se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me Statutin dhe rregulloren e Universitetit;</p> <p>Vetë aktiviteti i UMT pasqyron qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me rregulloren e statutin e Universitetit.</p> <p>Aneksi Nr.1, Aneksi Nr.2</p>			
<b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.	<p>Referuar aktit te hapjes programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri Ndërtimi" ka kohëzgjatje normale prej 3 vite akademike, 180 ECTS. Ky program ka marrë akreditimin e parë me UMAS Nr. 10, datë 07.01.2016, bazuar në VKA Nr. 102, datë 3.11.2015, dhe 102/1, datë 18.12.2015, duke konfirmuar kështu që emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e tij është në përputhje me fushat dhe orientimet akademike të institucionit.</p> <p>GVJ, referuar evidencave ne dosen e vetëvlerësimit, konstaton se programi Bsc në "Inxhinieri Ndrëtimi", i cili ofrohet nga Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit si njësi bazë dhe Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës si njësi kryesore, është në përputhje me fushat dhe drejtimët akademike të UMT dhe specifikisht të Njësisë kryesore dhe asaj bazë.</p> <p>Dosja e Vetëvlerësimit; aneksi 50</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<input type="checkbox"/> Përbushet plotësisht	<input type="checkbox"/> Përbushet pjesërisht	<input type="checkbox"/> Përbushet kryesisht	<input checked="" type="checkbox"/> Përbushet plotësisht

### Standardi I.3

**Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.	<p>Referuar RVB-së, Dosjes së Vetëvlerësimit si dhe protokollit të takimeve gjatë vizitës në vend, GVJ konstaton që programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri Ndërtimi" ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin profesional të studentëve duke i aftësuar ata në zbatimin e njohurive të marra gjatë zhvillimit të programit të studimit dhe duke mundësuar njohuritë e nevojshme për thellimin e studimeve ne ciklin e dytë.</p> <p>Nëpërmjet informacionit që gjendet në syllabuset e lëndëve të programit të studimit Bsc ne Inxhinieri Ndërtimit, del qartë që synohet që studentëve tu jepen njohuri, dije, aftësi dhe kompetenca profesionale në fushën e inxhinierisë së ndërtimit, në përputhje me nivelin 6 te KSHK. Referuar dhe RVB, synohet që programi i studimit të pajisë studentët me:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- aftësi për të zbatuar njohuritë teorike të disiplinave shkencore dhe inxhinierike;</li> </ul>




	<ul style="list-style-type: none"> <li>- aftësi për të hartuar dhe menaxhuar një situatë teknike tipike në ndërtim;</li> <li>- aftësi për të funksionuar në grupime profesionale ;</li> <li>- aftësi dhe kompetenca për të identifikuar, formuluar dhe zgjidhur probleme standarte të inxhinierisë së ndërtimit;</li> <li>- perceptim dhe njohje të përgjegjësisë profesionale dhe etike;</li> <li>- aftësi për të komunikuar në mënyrë efektive në fushën e teknikes;</li> <li>- aftësi dhe orientim për të përdorur teknikat dhe mjetet moderne inxhinierike të nevojshme për punën si inxhinierë etj.</li> </ul> <p>Kjo u konstatua dhe në takimin me ALUMNI</p> <p>Dosja e vëtvlerësimit; Shënimet e takimeve</p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>GVJ konstatoi që institucioni kryen studime për tregun e punës; disponon evidenca të plota mbi punësimin e të diplomuarve në programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Ndërtimi”. Në takimin me përfaqësuesit e Zyrës së Karrierës, GVJ u njoh me aktivitetin e zyrës për ndjekjen e tregut të punës dhe përdorimin e të dhënave të fituara nga kontaktet me firmat ndërtuese. Përveç komunikimit të formalizuar në dokumenta për interesin reciprok, në këtë zyrë disponoheshin edhe informacionet që merrnin studentët gjatë zhvillimit të praktikave në terren.</p> <p>Rezultati i aktivitetit të zyrës së karrierës konkretizohej në statistika lidhur me punësimin ose jo, të diplomuarve konkretisht rreth 80 % e të diplomuarve rezultojnë të punësuar në profesionin e tyre kurse rreth 18-20% të punësuar jo në profesion ose në pritje, rezultate këto të kënaqshme dhe positive për programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi.</p> <p>[Dosja e Vetëvlerësimit], [Shënimet e takimeve]</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Objekti i programit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi është: që t’u sigurojnë studentëve dhe të diplomuarve dije profesionale, zotësi në përdorimin e tyre, kuptim dhe zgjidhje të problemeve në ndërtim, dëshirë dhe ambicje për të njohur e përvetësuar informacionin bashkëkohor (referuar RVB).</p> <p>GVJ bazuar në informacionet dhe gjetjet gjatë takimeve të realizuara në UMT, në analizën për kurikulën egzistuese, syllabuset e lëndëve në kategorizimin e tyre A-E, si dhe duke parë angazhimin konkret si të personelit akademik, ndihmes akademik dhe administrative, të studentëve e ndihmës ashtu edhe të studentëve konstaton se janë arritur objektivat e programit në fjalë.</p> <p>RVB; Shënimet e takimeve</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

**Standardi I.4**

**Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
-----------------	------------------





<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>Referuar Dosjes së Vetëvlerësimit, GVJ konstaton që UMT ka burimet, kapacitetet dhe përvojën e duhur për të ofruar programin e studimit Bachelor në "Inxhinieri Ndërtimi".</p> <p><b>Strukturat përgjegjëse:</b> Programi i studimit ofrohet nga Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës, i cili ka tre departamente:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. <b>Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit;</b></li> <li>2. Departamenti i Arkitekturës;</li> <li>3. Departamenti i Shkencave të Natyrës.</li> </ol> <p><b>Burimet njerëzore:</b> Stafi akademik bazuar në CV-të rezultoi me përvojë dhe i përshtatshëm në disiplinat specifike të Inxhinierisë së Ndërtimit.</p> <p>Nga të dhënat që jepen në DVV, rezultoi numri i duhur i anëtarëve të stafit akademik me përvojë dhe të përshtatshme në disiplinat specifike të Inxhinierisë së Ndërtimit.</p> <p>Personeli Akademik Efektiv (PAE) në nivel fakulteti (23 pedagogë PAE) të cilët kanë kualifikimin si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 3 Prof. Dr,</li> <li>- 3 Prof. Assoc,</li> <li>- 5 Dr/Doc/PhD</li> <li>- 12 Msc (3 Dr në proces)</li> </ul> <p>Në Departamentin e Inxhinierisë së Ndërtimit, i cili është përgjegjës për programin e studimit, (8 pedagogë PAE), të cilët zotërojnë kualifikimin si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 1 Prof. Dr,</li> <li>- 1 Prof. Assoc,</li> <li>- 2 Dr/PhD</li> <li>- 4 Msc (2 Dr në proces)</li> </ul> <p><b>Burimet Infrastrukturore:</b> Auditore, Klasa për leksione dhe seminare, Laboratore për praktikë profesionale, Laboratorë informatike, Bibliotekë, Mjedise për fotokopjim/librari, Zyra për informimin e studentëve, Zyra për stafin, Sallat e mbledhjeve, Mjedise për personelin e shërbimit, etj</p> <p><b>Shërbime IT:</b> (Shërbime Mësimdhënie Edu4school, Google Services, Go toMeeting, Google classroom, MS Teams etj)</p> <p>Në përfundim, GVJ vlerëson se institucioni ka kapacitete e duhura dhe burimet e nevojshme për ofrimin e programit të studimit Bsc në Inxhinieri Ndërtimi.</p> <p><b>RVB, DVV, Shënimet e takimeve.</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve</p>	<p>GVJ konstatoi që fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Bachelor në "Inxhinieri Ndërtimi" (shih RVB) është në përputhje me fushën kërkimore-shkencore dhe akademike të Fakultetit të Inxhinierisë dhe Arkitekturës, si dhe të Departamentit të Inxhinierisë së Ndërtimit.</p> <p>GVJ bazuar në RVB, dhe në protokollin e takimeve konstaton se programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri Ndërtimi" ofrohet nga Departamenti i</p>

<p>të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Inxhinierisë së Ndërtimit i cili (sipas ligjit të arsimit të lartë) është njësi bazë e Fakultetit të Inxhinierisë dhe Arkitekturës.</p> <p>Departamenti ofron programe studimi në nivelin Bachelor, Master dhe të programeve profesionale jo universitare.</p> <p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Ndërtimi” është në përputhje me fushën kërkimore dhe akademike të Departamentit të Inxhinierisë së Ndërtimit.</p> <p>Përsa i përket kodifikimit të programeve/klasifikimit, referuar dhe RVB, GVJ është në dijeni të mospasjes në nivel kombëtar të këtij klasifikimi, i cili do të mundësonte përafrimin me ato të direktivave evropiane.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

### Standardi I.5

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>GVJ lidhur me vlerësimin e këtij kriteri mori në shqyrtim Raportin e Vlerësimit të Brendshëm të programit, statutin dhe rregulloren e UMT, si dhe aktet rregullative specifike, po ashtu dhe përgjigjet e grupeve gjatë takimeve të organizuara në institucion dhe konstaton se UMT siguron më së miri marrëdhëniet brenda institucionit, kjo sipas detyrave të përcaktuara qartë si ndërmjet strukturave përbërëse të UMT ashtu dhe roleve të përcaktuara sipas strukture.</p> <p>Njësitë bazë të Fakultetit të Inxhinierisë dhe Arkitekturës organizojnë veprimtari mësimore dhe kërkimore shkencore në koordinim të plotë me njëra tjetren.</p> <p>[RVB]; [Statuti], [Rregullore e UMT], [Shënimet e takimeve]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ ose të huaj.</p>	<p>GVJ bazuar në informacionin e Dosjes së Vetëvlerësimit, si dhe në takimin me përfaqësuesin e zyrës së marrëdhënieve me jashtë dhe të projekteve, vlerëson se UMT tashmë e ka të plotësuar këtë kriter dhe e ka në objektivat e tij strategjikë.</p> <p>Nga takimi me studentët, Alumni dhe përfaqësues të tregut të punës u konstatua se bashkëpunimi me IAL vendase dhe të huaja apo me kompani biznesi është realizuar në vazhdimësi dhe do të vijojë të shihet me prioritet.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në mënyrë periodike, njësi përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në</p>	<p>GVJ referuar raportit të vlerësimit të brendshëm, protokollit të takimeve konstaton se Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit analizon arritjet dhe përcakton objektivat lidhur me marrëveshjet e bashkëpunimit.</p> <p>[RVB], [Shënimet e takimeve]</p>

funksion të realizimit të programeve të studimeve.									
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.	Nëpërmjet Dosjes së vetëvlerësimit, si dhe protokollit të takimeve, GVJ konstaton se UMT ka të përcaktuara qartë modalitete e kryerjes së praktikës profesionale, përzgjedhjes së kompanisë ku do kryhet ajo, në përputhje me rregulloren për praktikën profesionale, duke siguruar harmonizim dhe larmishmëri në shpërndarjen e studentëve.  Ky bashkëpunim bëhet përmes Zyrës e Karrierës dhe Alumni, për kryerjen dhe mbështetjen e praktikës profesionale të studentëve të Departamentit të Inxhinierisë së Ndërtimit, në bashkëpunim me Deakanin dhe përgj. e departamentit.  “Ev 50, 77”								
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Nga RVB dhe protokollit i takimeve (me zyrën përgjegjëse) GVJ konstaton se UMT ofron trajnime të mëtejshme profesionale për të diplomuarit në koordinim me punëdhënësit dhe për studentët, konkretisht:  a) Kursi i Vlerësimit dhe Investimit në pasuritë e paluajtshme; b) Kursi i auditimit në energji, etj.  UMT organizon edhe:  - Panairin e Karrierës, i cili zhvillohet periodikisht si një ngjarje vjetore që synon të ofrohen mundësi punësimi dhe praktike për studentët dhe të diplomuarit e këtij institucioni, me pjesëmarrjen e kompanive të fushës.  - Trajnim karriere, i ofruar për t'i informuar studentët se si të përgatisin CV-në e suksesshme;								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të	Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi zhvillohet në përputhje me programin e licencuar nga Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit. Ai është organizuar në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr 219, Tiranë

E-mail: info@ascal.al


Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 11

<p>Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Ai ofrohet në 3 vite akademike, 6 semestra, dhe me kohë të plotë. Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Ndertimi permban 180 ECTS. Një semestër përmban 30 ECTS. Lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E).</p> <p>Shpërndarja e lëndëve është e rregullt dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi.</p> <p>Bazuar në Rregulloren e organizimi të programit të studimit, kreditet ECTS të çdo disipline mësimore dhe veprimtarie formuese përlllogariten duke mbajtur parasysh ngarkesën në orë mësimore në auditor, si dhe punën individuale që duhet kryer nga studenti për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në programin e lëndës. Një kredit është 25 orë mësimore punë e studentit, ku futen orë mësimore në auditor (leksione, seminare, ushtrime, projekt/detyra, dhe veprimtari të tjera formuese brenda disiplinës), si dhe orë pune individuale të studentit.</p> <p>Në periudhën e pandemisë, studenteve u është ofruar shtesë edhe cikli veror i studimeve.</p> <p><b>Plani mesimor, syllabuset, dosja e programit</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Programi i studimit bachelor ne Inxhinieri Ndertimi ne UMT, është niveli 6 i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Ai synon te ofroje:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- njohuri të bazë ne shkencen e ndertimit, duke përfshirë një formim e pregatitje shkencore dhe teknike;</li> <li>- aftësi të nevojshme praktike për të zgjidhur probleme në fushën e ndertimit si ne kantier ashtu dhe ne projektim;</li> <li>- aftësi dhe kompetenca qe te menaxhojnë veprimtari ose projekte komplekse teknike dhe profesionale, duke marrë përgjegjësinë për vendimmarrje në punë ose kontekste studimi</li> <li>- te marrin përgjegjësinë për menaxhimin e individëve dhe grupeve te perfshire ne fushen e ndertimit.</li> </ul> <p>Bazuar në planin mësimor si edhe në programet e lëndëve mund të arrihet në përfundimin se programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi siguron formimin e shprehive të veçanta në specialitete të përshtatshme për ambiente të ndryshme pune në projektim, analizë strukturore, dizajn dhe menaxhim ndërtimi etj. Studentët mund të punësohen në firma ndërtuese, firma këshilluese, firma prodhuese industriale, të përfshihen në agjensitë e ndryshme qeveritare, etj. Të diplomuarit gjithashtu fitojnë kompetencat e nevojshme për të vazhduar karrierën e tyre akademike.</p> <p>[Plani mesimor], [syllabuset], [dosja e programit]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Lëndët qe zhvillohen në programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi janë të ndërthurura midis lëndëve teorike dhe lëndëve, që mbartin aplikimin praktik.</p> <p>Përfshihen lëndët bazë të formimit inxhinierik: matematikë, fizikë, kimi, informatikë, mekanike, gjeometri deskriptive etj dhe vazhdohet me lëndet baze teorike të ndërtimit si: rezistenca e materialeve, analiza e strukturave, hidraulika, topografia, gjeoteknika etj. Pjesën kryesore e zenë lëndet</p>

	<p>profesionale: Konstruksionet prej Betoni të armuar, Teknika e themeleve, Konstruksione murature, Konstruksione Celiku etj.</p> <p>Linje e vecante jane lendet qe lidhen me aplikimin e teknikes kompjuterike si: Informatika, Auto-CAD, Metodatat numerike ne inxhinieri, etj</p> <p>Në sensin e njohurive që i shërbejnë drejtpërdrejtë formimit dhe zbatimit praktik programi përfshin lëndë si: Praktika mesimore, Menaxhimi në Ndërtim, Teknikë Kantieri, Teknologji Ndërtimi (numer i konsiderueshem lendesh, krahasuar me programet analoge që zhvillohen në vend). Po kështu rritjes së aftësisë për t'u përfshirë në tregun e punës i shërbejnë edhe lënda: Legjislacion dhe vlerësim.</p> <p>Si pasojë, programi ofron njohuri bazë dhe specifike, nderlidhje e lendeve teorike me ato aplikative, përgatitje për teknikat e reja llogaritese të përdorura në ndërtim, synon plotësimin dhe pajisjen e studentëve me aftësi dhe kapacitete për të zgjidhur problemet që shtrihen shkencë dhe praktika e ndërtimit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit ka për qëllim të përgatisë profesionistë të aftë për të punuar në tregun e punës si dhe për të zgjidhur çështje komplekse dhe inovative në fushat e aplikuarat profesionale dhe në fushën kërkimore.</p> <p>Duke iu referuar Kurrikulës së Programit Studimor, vërehet që krahas lëndëve të përgjithshme dhe atyre praktike në planin mësimor janë parashikuar të zhvillohen edhe lëndë që ofrojnë njohuri të thelluara dhe të përparuar në fusha akademike apo profesionale. Përfshihen këtu lëndë të zhvilluara kryesisht në vitin e tretë dhe që lidhen me: analizën e strukturave, strukturat e çelikut, strukturat b-a, themelet, muraturen etj.</p> <p>(Aneksi Nr.55, Plani mësimor sipas llojit të veprimtarisë (A-E))</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Programi i studimit është i organizuar në përputhje me VKM nr.41\2018, lëndët e parashikuara në planin mësimor janë të të organizuara sipas kategorive (A-E) me ngarkesën në kredite përkatësisht A, B , C, D, E (Aneksi Nr.55, Plani mësimor sipas llojit të veprimtarisë (A-E).</p> <p>Programi i studimit përfshin praktikën profesionale (6 kredite) e cila realizohet në përputhje me rregulloren specifike dhe në bashkëpunim me kompani ndertimi. Studenti plotëson raportin e praktikës profesionale, e cila dorëzohet në përfundim të saj tek pedagogu përgjegjës. Zhvillimi i praktikës profesionale monitorohet nga pedagogët përgjegjës të caktuar nga departamenti.</p> <p>Programi zhvillohet në përputhje me programin e licencuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Pas përfundimit të programit të studimit në fjalë, studentit i lëshohet diploma "Bachelor" në "Inxhinieri Ndërtimi".</p> <p>[Aneksi Nr.58 Rregullore e programit Bsc në Inxhinieri Ndertimi] [Aneksi Nr.124] [Dokumentacioni i praktikës për programin e studimit], [Dësja e plotë e programit të studimit me elementët përbërës të tij]</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 879, datë 18.12.2019) lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E), që kanë këtë shpërndarje:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kategoria A (6 lëndë të formimit të përgjithshëm /bazë): 33 ECTS (18.33%)</li> </ul>






	-	Kategoria B (15 lëndë të formimit karakterizues): 93 ECTS (51.66%)		
	-	Kategoria C (4 lëndë ndërdisiplinore, profile dhe grup-lëndësh me zgjedhje): 27 ECTS (15%)		
	-	Kategoria D (4 lëndë plotësuese dhe praktika profesionale): 21 ECTS (11.66%)		
	-	Kategoria E (1- detyrimet përmblylëse/mbrojtja e temës së diplomës): 6 ECTS (3.3%)		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X



## Standardi II.2

**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Institucion është i akredituar me Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr.45, datë 05.07.2019, pas riorganizimit si universitet. UMT është akredituar dhe riakredituar. Vendimi i fundit është akreditimi me statusin “universitet”, me VBA nr. 45, datë 05.07.2019, me afat deri në 14.12.2022.</p> <p>Programi i studimit është akredituar me Urdhër të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit Nr. 10, datë 07.01.2016, bazuar në Vendimin e Këshillit të Akreditimit (VKA) Nr. 102, datë 3.11.2015, dhe VKA Nr. 102/1, datë 18.12.2015</p> <p>Nga sa më sipër rezultojnë se njësia kryesore dhe ajo bazë, përgjegjëse për programin e studimit, përmbushin detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p> <p>(Aneksi Nr.13, VBA për Akreditimin Institucional të UMT dhe Certifikata e akreditimit e fundit).</p>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësive përkatëse.	<p>Koordinatori i programit, i cili propozohet nga përgjegjësi i departamentit dhe miratohet nga dekani, përcjell shqetësimet e studentëve në lidhje me realizimin e programit mësimor, në përputhje me planin e miratuar, respektimin e orarit të mësimdhënies nga personeli akademik, cilësinë e sallave të leksioneve dhe seminareve, materialet didaktike etj.</p> <p>Koordinatori i programit përgjigjet për zhvillimin e praktikave mesimore dhe profesionale, organizon, planifikon dhe propozon në përputhje me kalendarin akademik orarin mësimor, kalendarin e provimeve etj. Ai informon vazhdimisht drejtuesin e departamentit dhe Fakultetit nëpërmjet takimeve verbale. Në bazë të Statutit të Universitetit Metropolitan Tirana, Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit, pranë Fakultetit të Inxhinierisë dhe Arkitekturës, është njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi, si dhe për sigurimin e brendshëm të cilësisë.</p>
<b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për	<p>Fakulteti është njësia kryesore akademike që koordinon mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe zhvillimin kulturor në fushat mesimore-kërkimore.</p> <p>UMT është i përbërë nga tre fakultete, të cilët nga ana e tyre përbëhen nga tre njësi bazë (departamente).</p>

<p>organizimin dhe strukturën akademike.</p> <p><b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Autoritetet udhëheqëse akademike të fakultetit janë Dekani, zv.Dekanet dhe Drejtuesit e Departamenteve. Organi kryesor akademik i fakultetit është Dekanati. Autoriteti kryesor administrativ është Administratori i Fakultetit.</p> <p>Struktura e Fakulteti të Inxhinierisë dhe Arkitekturës paraqitet funksionale. Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës- UMT , përbëhet nga 3 tre njësi bazë, apo departamente, në të cilën stafi akademik i brendshëm (PAE) është si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Departamenti i Arkitektures dhe Urbanistikes (8 PAE)</li> <li>2. Departamenti i Inxhinierise se Ndertimit (8 PAE)</li> <li>3. Departamenti i Shkencave te Natyres (7 PAE)</li> </ol> <p>Nga sa më sipër rezulton se njësia kryesore dhe ajo bazë, përgjegjëse për programin e studimit, përmbushin detyrimet ligjore për strukturën akademike.</p> <p>[Statuti i Universitetit], [Rregullorja e FIA], [Rregullorja e programit të studimit] [Aneksi Nr.66, Lista e plotë e PA me kohe të plotë e të pjesshme-FIA-Tab.Nr.2]</p>																																																																														
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p>Fakulteti i Inxhinierise dhe Arkitekturës përbëhet nga tre njësi bazë/ departamente. Kualifikimi i Personelit Akademik në nivel Fakulteti (PAE dhe PAK) është, si më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="730 853 1235 1160"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Arkitekturës</th> <th colspan="2">Viti akademik 2020-2021</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof Dr</td> <td>3</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Prof.Assoc</td> <td>3</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Dr</td> <td>5</td> <td>21</td> </tr> <tr> <td>Msc (Dr në proces)</td> <td>3</td> <td>5</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>9</td> <td>21</td> </tr> <tr> <td>Ne total</td> <td>23</td> <td>51</td> </tr> </tbody> </table> <p>Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit në UMT është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore të Fakultetit të Inxhinierisë dhe Arkitektures, i cili përfshin fusha kërkimi të ndërtimit dhe grupon disiplina mësimore respektive. Në Departamentin e Inxhinierise së Ndërtimit, i cili është përgjegjës për këtë program studimi, në 3 vitet e fundit, rezultojnë të dhënat e kualifikimit të stafit si më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="576 1429 1386 1731"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit</th> <th colspan="2">Viti akademik 2020-2021</th> <th colspan="2">Viti akademik 2019-2020</th> <th colspan="2">Viti akademik 2018-2019</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof Dr</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Prof.Assoc</td> <td>1</td> <td>2</td> <td>2</td> <td>2</td> <td>-</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Dr</td> <td>2</td> <td>10</td> <td>1</td> <td>10</td> <td>2</td> <td>6</td> </tr> <tr> <td>Msc (Dr në proces)</td> <td>2</td> <td>-</td> <td>2</td> <td>-</td> <td>2</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>2</td> <td>18</td> <td>1</td> <td>18</td> <td>2</td> <td>8</td> </tr> <tr> <td>Ne total</td> <td>8</td> <td>31</td> <td>7</td> <td>31</td> <td>7</td> <td>16</td> </tr> </tbody> </table> <p>Nga sa më sipër njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit kanë përmbushur, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. Departamenti i Inxhinierisë të Ndërtimit, që ofron programin e studimit Bachelor në "Inxhinieri Ndërtimi", plotëson kriteret e përcaktuara në</p>	Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Arkitekturës	Viti akademik 2020-2021		PAE	PAK	Prof Dr	3	2	Prof.Assoc	3	2	Dr	5	21	Msc (Dr në proces)	3	5	Msc	9	21	Ne total	23	51	Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit	Viti akademik 2020-2021		Viti akademik 2019-2020		Viti akademik 2018-2019		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof Dr	1	1	1	1	1	1	Prof.Assoc	1	2	2	2	-	1	Dr	2	10	1	10	2	6	Msc (Dr në proces)	2	-	2	-	2	-	Msc	2	18	1	18	2	8	Ne total	8	31	7	31	7	16
Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Arkitekturës	Viti akademik 2020-2021																																																																														
	PAE	PAK																																																																													
Prof Dr	3	2																																																																													
Prof.Assoc	3	2																																																																													
Dr	5	21																																																																													
Msc (Dr në proces)	3	5																																																																													
Msc	9	21																																																																													
Ne total	23	51																																																																													
Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit	Viti akademik 2020-2021		Viti akademik 2019-2020		Viti akademik 2018-2019																																																																										
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																																																									
Prof Dr	1	1	1	1	1	1																																																																									
Prof.Assoc	1	2	2	2	-	1																																																																									
Dr	2	10	1	10	2	6																																																																									
Msc (Dr në proces)	2	-	2	-	2	-																																																																									
Msc	2	18	1	18	2	8																																																																									
Ne total	8	31	7	31	7	16																																																																									

	Ligjin "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", për sa i përket organizimit dhe strukturën së tij akademike.			
	[Aneksi Nr.66, Lista e plotë e PA me kohe të plotë e të pjesshme-FIA-Tab.Nr.2] [Anekset me tabelat përmbledhëse, Bachelor në "Inxhinieri Ndërtimi"]			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X


### Standardi II.3

**Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.**


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Departamenti i Inxhinierisë të Ndërtimit dhe Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë ka informacionet për organizimin dhe përmbajtjen e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi. Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit si njësi bazë përgjegjëse për organizimin e programit të studimit, disponon dokumentacionin për programin e studimit, ku përfshihen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të dhëna të përgjithshme për njësinë dhe programin, objektivat formuese, synimet, kriteret përzgjedhëse, regjistrimet, transferimet, tarifat, metodat e mësimdhënies etj.</li> <li>- rregullorja e programit,</li> <li>- plani mësimor;</li> <li>- syllabuset e lëndëve si dhe ndarjen e lëndëve sipas veprimtarive formuese shqip dhe anglisht,</li> <li>- CV e personelit akademik.</li> </ul> <p>Departamenti arkivon kete dokumentacion që ruhet e menaxhohet nga Përgjegjësi i Departamentit, dhe gjithashtu, i gjithë informacioni arkivohet edhe pranë zyrës së arkivës.</p> <p>[Aneksi Nr.53, dosja e programit] [Ev 114 rregullore e arkivës]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi është i strukturuar në 3 vite akademike dhe 6 semestra. Zhvillohen gjithsej 30 lëndë të ndara sipas 3 viteve (11 lëndë në vitin e parë; 9 lëndë në vitin e dytë; 10 lëndë në vitin e tretë). Në 30 lëndët që parashikohen në planin mësimor përfshihen edhe punimi i diplomës ose provimi final, si edhe praktika mesimore.</p> <p>Studenti mund të zgjedhë një lëndë nga 5 lëndë me zgjedhje. Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 879, datë 18.12.2019) lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E).</p> <p>Bazuar në (VKM 879, datë 18.12.2019) shpërndarja e lëndëve është e rregullt dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi është organizuar në lëndë e module të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin</p>



	<p>vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Programi zhvillohet në përputhje me programin e licencuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.</p> <p>[Dosja e plotë e programit të studimit me elementët përbërës të tij]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në Inxh. Ndërtimi përmban informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit. Mënyra e vlerësimit të dijeve është e përcaktuar në syllabuset e lëndës në varësi të llojit të lëndës. Konkretisht për vlerësimin rezulton:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 10 % pjesëmarrja dhe aktivizimi</li> <li>- 10 % plotësimi dhe realizimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit)</li> <li>- 20 % testimet gjatë vitit</li> <li>- 60 % provimi përfundimtar</li> </ul> <p>Plani mësimor buron nga kurrikula e programit të studimit dhe pasqyron periudhën kohore të zhvillimit të secilit prej moduleve të programit të studimit në vitin akademik. Ngarkesa për 1 kredit është 25 orë punë e studentit.</p> <p>Elementet e studimeve të parashikuara në rregulloren e institucionit në përputhje me specifikën e programit të studimit përfshijnë leksionet, seminarët, ushtrimet, labororet, praktikat mësimore e profesionale, provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare, detyrat e kursit, projektet, etj. Plani mësimor përmban të ndarë ngarkesën në orë në auditor/jashtë auditorit: Ndarja e tyre në program është si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Leksione <b>835</b> (295+290+250) orë mësimore</li> <li>- Ushtrime/Seminare <b>620</b> (240+ 220+160) orë mësimore</li> <li>- Laboratorë <b>50</b> (30+20) orë mësimore</li> <li>- Detyra kursi <b>212.5</b> (87+55+70) orë</li> <li>- Praktike mesimore <b>120</b> orë</li> <li>- Punë individuale e studenteve. 2670 orë</li> </ul> <p>Gjithsej orë teorike: <b>835</b> orë mësimore në auditor</p> <p>Gjithsej orë praktike: <b>1002.5</b> orë mësimore në auditor</p> <p>[Dosja e plotë e programit të studimit me elementët përbërës të tij]; [Aneksi Nr.56 Plan programet e lëndëve/syllabuset]</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Pavarësisht se regjistrimi dhe transferimi i studimeve rregullohen me akte të përvitshme të MASR (përsa i përket afateve të aplikimit dhe dokumentacionit), institucioni ka parashikuar procedurën për regjistrim apo për transferim të studimeve dhe kriteret e përzgjedhjes, si dhe procesin e ekuivalentimit të programeve të studimeve për studentët që transferohen.</p>




	<p>Rregullorja e Universitetit parashikon rastet dhe sasinë e krediteve respektive që njihen.</p> <p>Ndërkohë çdo vit akademik, me propozim të fakultetit, Senati akademik i UMT miraton kriteret specifike të pranimit në programin e studimit për vitin pasardhës. Procesi i pranimit dhe regjistrimit administrohet nga sekretaria mësimore, nga komisionet ad hoc të ngritura nga Dekanati i FIA-UMT për përgjdhjen e kandidatëve në përputhje me kuotat dhe kriteret e miratuara.</p> <p>[Aneksi Nr.01, Statuti i UMT], [Aneksi Nr.30, Procedure aplikimi, regjistrimi dhe transferimi], [Aneksi Nr.33, Kriteret e pranimit]</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Përmbajtja e plotë e programit të studimit u vihet në dispozicion studentëve gjatë javës së parë të fillimit të lëndës/modulit. Po ashtu, FIA ne UMT vë në dispozicion të studentëve Guidën e Studentit e cila përmban informacione të detajuara jo vetëm për programet e studimit por dhe mënyrën e realizimit të tyre dhe infrastrukturën mbështetëse. Programi i lëndës jep informacion mbi lektorin/lektorët që do të zhvillojnë modulën, kursin dhe semestrin kur zhvillohet, karakterin e modulit, njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti; kohëzgjatjen e modulit; kreditet ECTS; objektivat e modulit; elementët e mësimdhënies; detyrimet e studentit; metodat e vlerësimit dhe literaturën.</p> <p>Kriteret e pranimit të studentëve në programin e studimit vendosen cdo vit akademik e miratohet me Vendim të Senatit Akademik, të cilat me tej percillen prane MASR.</p> <p>Syllabuset, për secilën lëndë, ofrojnë informacionet e nevojshme lidhur me ngarkesën brenda dhe jashtë auditorit, kreditet ECTS, përshkrimin e lëndës, objektivat e lëndës, temat për secilën javë, literaturë kryesore dhe mbështetëse, rezultatet e të nxënit të lëndës, kontributi i lëndës në kompetencat e programit të studimit, metodat e vlerësimit të njohurive dhe llogaritjen e ECTS.</p> <p>Në planin mësimor të programit të studimit dhe në syllabuset e lëndëve paraqiten të dhëna të detajuara mbi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Emërtimin e moduleve të grupuara dhe të renditura në semestra;</li> <li>✓ Numri i krediteve për çdo modul dhe raporti i orëve (leksione, seminare, laboratorë);</li> <li>✓ Detyrimet sipas moduleve (seminare, ushtrime, punime, detyra kurse, projekte, praktikë);</li> <li>✓ Mënyra e kontrollit të dijeve të çdo moduli;</li> </ul> <p>Syllabuset e lëndëve janë në përputhje me elementët që parashikohen në shtojcën e VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 i ndryshuar.</p> <p>[Aneksi Nr.79, Guida e studentit; Aneksi Nr.53 dosja e programit]</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen</p>	<p>Programi i studimit, ka pësuar përditësim në syllabuset (në tema të veçanta të tyre), literaturën, në kriteret e pranimit etj. Në planin mësimor të këtij programi nuk janë bërë ndryshime. Në përfundim të çdo viti akademik NJSBC kërkon në formë shkresore që fakultetet dhe departamentet, të</p>





ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	<p>rishikojnë programet e studimit dhe të paraqesin të argumentuara nëse ka ndryshime (deri në masën 20 %) në përputhje me aktet në fuqi.</p> <p>Universiteti përdor të dhëna cilësore dhe sasiore në vlerësimin e lëndëve, programeve të lëndëve dhe mësimdhënies, duke përfshirë studentët dhe palët e interesuara, për të identifikuar pikat e forta dhe të dobëta të programeve të studimit. Kjo politikë vlen për të gjitha programet e studimit të ofruara nga Universiteti dhe rregullohet përmes Politikës së Universitetit Metropolitan Tirana”</p> <p>[Tabela 11_Ndryshimet në planin mësimor, krahasuar me programet e licencuara], [Aneksi Nr.56, Syllabuset e programit sipas planit mesimor]</p>			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Plotë përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi II.4


**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	<p>Ngarkesa e programit të studimit paraqitet në programet e lëndëve. Shpërndarja e ngarkesës respekton parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi, në përputhje me VKM nr.41, Dt. 24.01.2018, duke ruajtur ngarkesën ditore, javore në auditor, për leksione, seminare, ushtrime e laboratorë, detyre kursi etj.</p> <p>(Aneksi Nr.89, Orari mësimor i Bsc i firmosur).</p>
<b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.	<p>Emërtimi dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit, janë në fushën e ndërtimit , duke ju mundësuar studentëve punësimin e tyre në sektorët perkates apo si bazë njohurish për vazhdimin e ciklit të dytë të studimeve. Komponentët mësimorë si mësimi në auditor (leksione, seminare, ushtrime, detyra kursi, laboratorë si dhe kontrolli i vazhdueshëm) janë në funksion të interaktivitetit të studentëve me pedagogun e lëndës dhe në funksion të stimulimit të mendimit të tyre krijues/novator dhe praktik.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Në vitin e parë zhvillohen lëndë bazë si matematikë, fizikë, kimi, anglisht, etj. Më tej kalohet në lëndë më profesionale.</li> <li>- Në vitin e dytë dhe të tretë zhvillohen lëndë të mirëfillta inxhinierike.</li> <li>- Viti i trete i dedikohet lendeve te mirefillta teoriko aplikative.</li> </ul> <p>Studentët zhvillojnë laboratore në lëndë të ndryshme, praktikë mesimore, si edhe njihen me përdorimin e programeve kompiuterike inxhinierike.</p> <p>(Aneksi Nr.53, dosje e programit), (Aneksi Nr.56, Syllabuset e programit sipas planit mesimor).</p>

<p><b>Kriteri 3.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimi profesional.</p>	<p>Ndarja e orëve mësimore në auditor në orë për leksione, seminare, për çdo disiplinë, përcaktohet në planin mësimor të programit të studimit, në bazë të krediteve që ka secila disiplinë. Lëndë të caktuara, në varësi të specifikave, aplikojnë veprimtari të ndryshme në funksion të mësimdhënies duke respektuar lirinë akademike dhe njëkohësisht për të nxitur studentët të praktikohen më shumë në detyrat e kursit/projekte që zhvillojnë.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi, si program i ciklit të parë, është organizuar sipas ligjit 80/2015, VKM nr.41. dt. 24.01.2018. Lëndët dhe raporti i tyre (ngarkesa në orë/kredite) është përcaktuar në përputhje me këto akte ligjore, duke synuar njëkohësisht përafrimin me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p> <p>Përgjatë programit, studentëve u ofrohen mundësi që të përforcojnë aftësitë e tyre grafike dhe të komunikimit me gojë. Një sasi e konsiderueshme kohe është e lidhur drejtpërdrejt me trajnimin praktik në testimin e materialeve, udhëzime në përdorimin e programeve kompiuterike inxhinierike, etj.</p> <p>Viti i dytë dhe i tretë përbëhen kryesisht nga lëndë themelore të inxhinierisë. Në të njëjtën kohë, zbatimi praktik i njohurive të inxhinierisë të ndërtimit paraqitet dhe zbatohet përmes detyrave të kursit dhe projekteve. Studentëve iu ofrohen njohuri menaxheriale, si edhe kryerja e një praktike në kantier.</p> <p>Programi i studimit përfundon me plotësimin e një praktike. Nga sa më sipër rezulton se lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimi profesional.</p> <p>(Aneksi Nr.54, Plani mësimor), (Aneksi Nr.56, Syllabusët e programit sipas planit mesimor).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Natyrë e moduleve të ofruara dhe ngarkesa e tyre në ECTS siguron një integrim të aspekteve teorike dhe praktike që jep një modul/lëndë në përmbushje të objektivave formuese të programit. Për përmirësimin e vazhdueshëm të përmbajtjes së programit, departamentet dhe personeli akademik, përveç eksperiencës së fituar, konsultohen vazhdimisht me partnerë dhe bashkëpunëtorë për të rritur jo vetëm cilësinë e programit por për të mundësuar transferimin, mobilitetin dhe punësimin e integruar në tregun global pas përfundimit të studimeve.</p> <p>Lëndët janë të organizuara në aktivitete formuese Leksione/Ushtime (seminar)/ Projekte/laboratorë/praktika.</p> <p>Në secilën prej tyre ka aktivitete formuese teorike dhe praktike.</p> <p>Gjithsej orë teorike: <b>835</b> orë mësimore në auditor</p> <p>Gjithsej orë praktike: <b>1002.5</b> orë mësimore në auditor</p> <p>Raporti teori praktikë, referuar orëve në auditor do të ishte <b>45.4 %</b> e orëve në auditor i përkasin përgatitjes teorike (leksioneve) dhe <b>54.6 %</b> e orëve</p>




	<p>në auditor krediteve janë të lidhura me përgatitjen praktike përfshirë këtu edhe punimi i diplomës.</p> <p>Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori – praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor.</p> <p>(Aneksi Nr.54, Plani mësimor), (Aneksi Nr.56, Syllabuset e programit sipas planit mesimor). (Aneksi Nr.82, Rrjeti alumni).</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi parashikon lëndë themelore, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe përmblylëse, në përputhje me kërkesat ligjore, duke lehtësuar transferimin dhe lëvizshmërinë e studentëve. Programi i studimit ka përfshirë në kurrikulën e tij mundësi praktike në terren. Studentët duhet të fitojnë dhe përmirësojnë njohuritë praktike në tema të ndryshme inxhinierike që mund të hasin gjatë periudhës së praktikës në një kompani ndërtimi.</p> <p>Pjesëmarrja e studentëve në praktike në bashkëpunim me ndërmarrje dhe kompani që operojnë në këtë fushë, lehtëson punësimin e studentëve në fund të programit të studimit.</p> <p>(Dosja e Programit)</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e lëndëve/ moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Syllabuset e programit të studimit përmbajnë të gjitha elementet sipas shtojcës përkatëse të VKM nr. 41, Dt. 24.01.2018, i ndryshuar, Pjesa e literaturës në çdo syllabus përbëhet nga literaturë bazë e detyrueshme dhe literature ndihmëse. Përditësimi i përmbajtjes së syllabuseve koordinohet në drejtuesit e departamenteve të cilët monitorojnë realizimin e lëndës/modulit në përputhje me syllabusin e miratuar. Literatura synohet te jete e viteve të fundit.</p> <p>(Aneksi Nr.56, Syllabuset e programit sipas planit mesimor).</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi i ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë. Niveli i njohurive është në përputhje me nivelin e ciklit të parë të studimeve. Krahas njohurive shkencore teorike synohet aftësimi praktik i studentëve nëpërmjet laboratorëve dhe praktikave. Studenti përvetëson njohuri shkencore, me aftësi praktike dhe menaxheriale.</p> <p>(Aneksi Nr.56, Syllabuset e programit sipas planit mesimor).</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi i ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë. Niveli i njohurive është në përputhje edhe me nivelin e ciklit të parë të studimeve, duke krijuar bazat e duhura për një studim me të thelluar dhe të përparuar në ciklin e dytë, master.</p> <p>Aneksi Nr.56, Syllabuset e programit sipas planit mesimor).</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin</p>	<p>Të diplomuarit në këtë program studimesh mund t'i përgjigjen nevojave të vendit, duke qenë të aftë për t'u punësuar në fushen e ndërtimit: realizimin e strukturave dhe ne veprat e infrastruktures. Pasqyrimi i nevojave që ka tregu për këtë drejtim, reflektohet në përmbajtjen e</p>



parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	<p>syllabuseve, gje qe kryhet nga departamentet përgjegjëse. Kjo në konsultim të vazhdueshëm, me opinionet e studentëve, bashkëpunëtorëve dhe partnerëve që janë pjesë e tregut te punës</p> <p>Departamenti i Inxhinierisë të Ndërtimit, si njësi përgjegjëse për programin e studimit, është në marrëdhënie me i, me qëllim evidentimin dhe inserimin në programet e lëndëve të nevojave dhe kërkesave të tregut. (Aneksi Nr.11, model pyetësori me studentë).</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nota e përmbushjes së përmbushjes</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi II.5

**Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																																															
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Personeli i angazhuar në zhvillimin e programit të studimit Bsc në Inxhinieri Ndërtimi është konform kërkesave të legjislacionit në fuqi. Personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme që angazhohet në mësimdhënie në programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi plotëson kërkesat që lidhen me detyrimet ligjore. (Tabela 12)</p> <p>Personeli i angazhuar në zhvillimin e programit të studimit “Bsc në Inxhinieri Ndërtimi”, në 3 vitet, rezulton me të dhënat e kualifikimit si më poshtë:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Personeli i angazhuar në zhvillimin e programit të studimit</th> <th colspan="2">Viti akademik 2020-2021</th> <th colspan="2">Viti akademik 2019-2020</th> <th colspan="2">Viti akademik 2018-2019</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>2</td> <td>1</td> <td>2</td> <td>1</td> <td>2</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Prof.Assoc</td> <td>4</td> <td>2</td> <td>4</td> <td>1</td> <td>4</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Dr</td> <td>4</td> <td>2</td> <td>4</td> <td>2</td> <td>6</td> <td>3</td> </tr> <tr> <td>Msc (Dr në proces)</td> <td>3</td> <td>3</td> <td>3</td> <td>3</td> <td>3</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>3</td> <td>1</td> <td>3</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td><b>Ne total</b></td> <td><b>16</b></td> <td><b>9</b></td> <td><b>16</b></td> <td><b>8</b></td> <td><b>16</b></td> <td><b>7</b></td> </tr> </tbody> </table> <p>Bazuar në planin mësimor të miratuar në fillim të çdo viti akademik, bëhet shpërndarja e ngarkesës. Nga verifikimi i të dhënave statistikore, ngarkesa mësimore është mbajtur nga personeli akademik efektiv, sipas të dhënave më poshtë:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>% e ngarkesës mësimore e realizuar nga PAE</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2018-2019</td> <td><b>80 %</b></td> </tr> <tr> <td>2019-2020</td> <td><b>73,3 %</b></td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td><b>71.3 %</b></td> </tr> </tbody> </table> <p>Për 3 vitet akademike, ngarkesa mësimore për këtë program studimi, është përballuar <u>mbi</u> 70% nga stafi akademik me kohë të plotë në përputhje me</p>	Personeli i angazhuar në zhvillimin e programit të studimit	Viti akademik 2020-2021		Viti akademik 2019-2020		Viti akademik 2018-2019		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr	2	1	2	1	2	1	Prof.Assoc	4	2	4	1	4	1	Dr	4	2	4	2	6	3	Msc (Dr në proces)	3	3	3	3	3	1	Msc	3	1	3	1	1	1	<b>Ne total</b>	<b>16</b>	<b>9</b>	<b>16</b>	<b>8</b>	<b>16</b>	<b>7</b>	Viti akademik	% e ngarkesës mësimore e realizuar nga PAE	2018-2019	<b>80 %</b>	2019-2020	<b>73,3 %</b>	2020-2021	<b>71.3 %</b>
Personeli i angazhuar në zhvillimin e programit të studimit	Viti akademik 2020-2021		Viti akademik 2019-2020		Viti akademik 2018-2019																																																											
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																																										
Prof.Dr	2	1	2	1	2	1																																																										
Prof.Assoc	4	2	4	1	4	1																																																										
Dr	4	2	4	2	6	3																																																										
Msc (Dr në proces)	3	3	3	3	3	1																																																										
Msc	3	1	3	1	1	1																																																										
<b>Ne total</b>	<b>16</b>	<b>9</b>	<b>16</b>	<b>8</b>	<b>16</b>	<b>7</b>																																																										
Viti akademik	% e ngarkesës mësimore e realizuar nga PAE																																																															
2018-2019	<b>80 %</b>																																																															
2019-2020	<b>73,3 %</b>																																																															
2020-2021	<b>71.3 %</b>																																																															

	<p>fushën e kualifikimit dhe fushën kërkimore të anëtarëve të stafit dhe pjesa tjetër është përballuar nga stafi me kohë të pjesshme.</p> <p>(Aneksi Nr.66, Lista e plotë e PA me kohe të plotë e të pjesshme-FIA-Tabelat), (Aneksi Nr.53 Dosja e Programit të Studimit _Bachelor në Inxhinieri Ndertimi -Tab12-Plani mësimor i lidhur me PA)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Anëtarët e personelit akademik me kohë të plotë që angazhohen në mësimdhënie janë në përputhje me fushën e programit të studimit, natyrën dhe specifikat e lëndëve/moduleve.</p> <p>Nga verifikimi në institucion rezulton se programi mësimor është realizuar nga personel akademik me kualifikimin e nevojshëm. Personeli akademik ka në përbërjen e tij staf me tituj “Prof” dhe “Prof As.”, me gradën “Doktor” dhe kualifikimin “Msc”.</p> <p>Personeli me kualifikimin Msc është i angazhuar vetëm në zhvillimin e ushtrimeve dhe punëve laboratorike, ndërsa zhvillimi i leksioneve kryhet vetëm me personel akademik me tituj dhe gradë shkencore.</p> <p>Edhe anëtarët e personelit ndihmës akademik dhe personeli me kohë të pjesshme që angazhohen në veprimtaritë mësimore, kanë kualifikimet dhe kompetencën për të zhvilluar programin e lëndës.</p> <p>(Aneksi Nr.56 syllabuse), (Aneksi Nr.61, CV e stafit akademik të programit)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Praktikat profesionale zhvillohen në institucionet më të cilat UMT ka marrëveshje të formalizuara ndërinstucionale dhe drejtohen/mbikëqyren nga pedagogu përgjegjës i caktuar nga departamenti. Ndërkohë në bashkëpunim me institucionet ku do kryhet praktika, caktohet dhe personeli i duhur e i kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale në institucionin e tyre</p> <p>Roli i personelit akademik është i rëndësishëm në bashkëpunimin me këto institucione. Kjo realizohet në përputhje me parashikimet në rregulloren e UMT, Fakultetit e ate të praktikave si dhe në procedurat e përgatitjes dhe mbrojtjes së punimit të diplomës.</p> <p>(Tab-Nr.05, lista e marrëveshjeve me institucione për zhvillimin e praktikës mësimore) (Aneksi Nr.124, Dokumentacioni i praktikës për programin e studimit), (Aneksi Nr.02, Rregullorja e UMT; Aneksi Nr.50, Rregullore e FIA; Aneksi Nr.120, Rregullore e Provimeve; Aneksi Nr.98, Procedurat e përgatitjes dhe mbrojtjes së diplomë.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka personel ndihmës mësimor e specialistë për realizimin e orëve laboratorike dhe praktikave profesionale dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit që ofrohet.</p> <p>Gjatë orëve të mësimin, pedagogët ndihmohen nga asistentët mësimorë dhe/ose asistentët kërkimorë. Laboratorët e kompjuterave mirëmbahen nga personeli administrativ përkatës nën përgjegjësinë e Zyrës së IT, ndërsa Laboratori i Inxhinierisë të Ndërtimit menaxhohet nga nje anetar i stafit të caktuar në këtë detyrë.</p>

	(Aneksi Nr.79, Guida e studentit) [Aneksi Nr.107, Te dhëna për infrastrukturën/ kapacitetet], [Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X
Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.</p>	<p>Lidhur me mësimdhënien, stafi akademik gërsheton metodat tradicionale me ato bashkëkohore, duke futur metoda të reja të mësuarit dhe të transmetimit të dijeve/njohurive. Këto metoda synojnë vendosjen e studentit në qendër të procesit mësimor.</p> <p>Lidhur me metodat inovative të mësimdhënies UMT, ne kushtet e pandemisë COVID-19, i mundësoi studentëve (të cilët pajisen me laptop në momentin e regjistrimit në programin përkatës) procesin e mësimdhënies online</p> <p>Lidhur me këtë proces, u ofrua trajnimi individual mbi baze kerkesash dhe udhëzuesish për stafet akademike që të krijojnë forma më të qëndrueshme dhe të standardizuara të shpërndarjes të të nxëniet të cilat garantojnë edhe përfshirjen e studenteve në to. Konkretisht, mesimi u zhvillua ne platformat GoToMeeting dhe edu4school (platformës menaxhimit te institucionit) në mbështetje të procesit të mësimdhënies për të gjitha lëndët e programeve të studimit që ofron UMT.</p> <p>Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit organizon udhëtime në terren ose workshope në mbështetje te procesit te mësimdhënies. Ne menyre te vecante jane organizuar udhetime ekspertize ne zonat e goditura nga termeti, ku janë trajtuar probleme specifike qe lidhen me mangësite konstruktive në projekt dhe në realizimin e objekteve që paraqisnin defekte. Mbi bazen e rezultateve te vrojtuar ne zonat e goditura nga termeti jane zhvilluar workshope me pjesmarrjen e inxhinierëve dhe specialistëve te vendit e te huaj.</p> <p>Institucioni ka miratuar gjithashtu edhe rregulloren përkatëse të mësimin online</p> <p>(Aneksi Nr.103, Ndërfaqe classroom e një pedagogu, Aneksi Nr.48, Platformat per mesimin online, printscreen te perdorimit te edu4school), (Aneksi Nr.49, Udhezim mbi mesidhenien ne distane.</p>



<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Fakulteti dhe Departamenti, janë angazhuar në plotësimin e standardeve cilesore, si dhe zbatojnë rekomandimet e NJSBC. Në rregulloren e UMT-se janë përcaktuar mekanizmat dhe njësitë përgjegjëse për monitorimin.</p> <p>NJSBC është organ kolegjal, që së bashku me përgjegjësit e departamenteve dhe grupe të ndryshme <i>ad-hoc</i> organizojnë kontrollin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësim nxënies. Instrumentet e monitorimit të mësimdhënies dhe mësim nxënies janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Vlerësimi i mësimdhënies në auditor, kryesisht për antarët e personelit akademik të kategorisë lektor dhe asistentë lektor nga Përgjegjësi i departamentit dhe Dekani.</li> <li>- Vlerësimi i pedagogut dhe i lëndës nga studentët, që kryhet cdo semestër, duke ruajtur anonimat.</li> <li>- Marrja e opinionëve të studentëve në formë të drejtpërdrejtë nëpërmjet takimeve të zhvilluara nga departament/dekanati.</li> <li>- Nëpërmjet qeverisë studentore fakulteti dhe universiteti kanë marrë mendimin e tyre në lidhje me problematika të hasura.</li> </ul> <p>Monitorimi dhe vlerësimi i aftësive mësimdhënëse inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik realizohet në mënyrë periodike nga NJSBC në nivel institucional ndërsa në nivel fakulteti, ky proces monitorohet nga njësitë bazë dhe nga Dekanati.</p> <p>(Aneksi Nr.09, Rregullorja e NJSBC). (Aneksi Nr.13, VBA për Akreditimin Institucional të UMT dhe Certifikata e akreditimit), (Aneksi Nr.122, Shembull_Plan monitorimi për mësimdhënien)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>GVJ konstaton se UMT, përfshin periodikisht studentët në vlerësimin periodik e kryesisht të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Pyetesorët e studentëve për lëndën dhe pedagogun që kryhen periodikisht me frekuencë semestrale, para zhvillimit të provimit përfundimtar të lëndës.</p> <p>Kontrolli periodik realizuar nga përgjegjësi i departamentit në bashkëpunim me NJSBC-n për mënyrën e zhvillimit të leksioneve duke asistuar një herë ose dy herë për çdo pedagog dhe duke diskutuar konkluzionet me pedagogët dhe studentët e grupit</p> <p>Procedura përkatëse mbi ankimin e vlerësimit përcaktohet në Rregulloren e provimeve. Verifikimi i vlerësimit bëhet me komision dhe miratohet nga dekani. Ndryshimet në rezultatin e vlerësimit të studentit behet brenda afatit të miratuar të lejueshëm reflektohet në notën përfundimtare si në sistem ashtu edhe në regjister. Nga sa më sipër rezultojnë që institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve. (Aneksi Nr.115, Pocesverbal i kontrollit ne auditore), (Aneksi Nr.120, Rregullorja e provimeve).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>GVJ konstaton se organi përgjegjës për politikën e cilësisë, është Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) dhe njësi në varësi të këtij organi Zyra e Kurrikulës dhe Cilësisë.</p>

	<p>Në Statutin dhe Rregulloren e UMT janë të përcaktuara detyrat dhe përgjegjësitë e NJSBC. Konkretisht hartimi i formularit të anketimit të studentëve bëhet nga NJSBC, e cila pas procesit të përpunimit statistikor nga zyra e IT –së, bën analizën e rezultateve duke evidentuar problematikat dhe rekomandimet përkatëse. Këto raporte analitike ju bëhen të njohura Dekanateve dhe Rektoratit për të marrë masa konkrete. Në përfundim të këtij procesi, masat e planifikuara për përmirësim të mëtejshme ju komunikohen personelit akademik dhe studentëve në takime me to.</p> <p>[Statut dhe rregullore] [Aneksi Nr.73], [Raport vjetor i aktiviteti mësimor, kërkimor dhe financiar 2018-2019]</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmeve të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Fakulteti dhe Departamenti përdor rezultatet e vlerësimeve periodike për të njohur situatën cilësore të programit dhe për përmirësimin e tij.</p> <p>Konkretisht, gjatë vitit akademik 2020-2021 janë planifikuar dhe zhvilluar seminare/trajnime për mënyrën e zhvillimit të leksioneve, përmirësimin e infrastrukturës mësimore. Institucioni është i përfshirë në projekte ndërkombëtare, si dhe ka nënshkruar memorandum mirëkuptimi me universitetet ndërkombëtare, përmes të cilave motivon stafin të marrë pjesë në programet e mobilitetit të stafit si Erasmus<sup>+</sup>, KA1 ose KA2, për të përmirësuar aftësitë e tyre mësimdhënëse. (Aneksi Nr.76, Minuta të mbledhjeve të dekanatit).</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<b>Niveli i përmbushjes</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi III.2

**Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyrat kursit/ esetë, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>GVJ konstaton se UMT angazhohet që procesi mësimor dhe veprimtaritë e tjera akademike të realizohen në përputhje me përcaktimet ligjore e nënligjore në fuqi si dhe duke respektuar lirinë akademike</p> <p>Metodat e transmetimit të njohurive tek studentët janë në varësi të llojit/specifikës së veprimtarive formuese dhe lirisë së veprimit që ka personeli për zbatimin e metodave të reja të mësimdhënies. Elementët kryesorë të mësimdhënies dhe mësimnxënies janë: <i>Leksionet, Seminarët, Laboratorët, Detyrat e kursit, Projektet e kursit, Praktikatat mësimore e profesionale, Leksionet e hapura dhe forma të tjera sipas rastit.</i></p> <p>Studentët nëpërmjet sistemit të menaxhimit të informacionit, njihen me syllabusin e çdo lënde ku janë të evidentuara format e mësimdhënies dhe mënyra e vlerësimit të lëndës, si dhe me materialet didaktike të lëndës të cilat i aksesojnë nëpërmjet sistemit.</p> <p>Ngarkesa përkatëse për format e mësimdhënies në programin e studimit është si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Leksione <span style="float: right;">835 orë mësimore</span></li> <li>- Ushtrime/Seminare <span style="float: right;">620 orë mësimore</span></li> <li>- Laboratorë <span style="float: right;">50 orë mësimore</span></li> </ul>


	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Detyra kursi <span style="float: right;">212.5 orë mësimore</span></li> <li>- Praktike mësimore <span style="float: right;">120 orë mësimore</span></li> <li>- Punë individuale e studentëve <span style="float: right;">2670 orë mësimore</span></li> </ul> <p>Disa aktivitete të tjera që mund të jenë më të zgjeruara, organizohen nga departamenti dhe pasqyrohen në planin vjetor të veprimtarisë së tij.</p> <p>Syllabusi i secilës lëndë nënshkruhet në fillim të çdo semestri nga pedagogu i lendes. Nga ana tjetër, plani i veprimtarisë së departamentit hartohet nga departamenti gjatë mbledhjeve të departamentit dhe i paraqitet Dekanit të Fakultetit të Inxhinierise dhe Arkitektures për miratim. Pas miratimit, Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit ndjek realizimin e aktiviteteve.</p> <p>(Aneksi Nr.02, Rregullore UMT, Aneksi Nr 50 Rregullore e FIA), (Aneksi Nr.53, dosja e programit), (Aneksi Nr.56 syllabuset e programit)Programi i lëndëve, Anexe me tabela përmbledhëse të Programit të studimit</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>Nga DVV dhe vizita në institucion GVJ konstaton se personeli akademik i UMT përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies, Gjate pandemise, UMT-ja ofroi alternativën online të procesit mësidhënies dhe mësimxënies (Go To Meeting, edu4schools), sipas specifikave të programeve të studimit apo të lëndëve/disiplinave të planit mësimor. Perdoren tabletat dixhitale dhe software qe ndihmojne dhe lejojne komunikimin me aktiv. Jane pregatitur udhezues dhe metodika specifike qe te ndihmojne studimin.</p> <p>NJSBC-ja ka hartuar pyetësorin përkatës për matjen e kënaqësisë së studentit lidhur me alternativën online të zhvillimit të procesit mësimor rezultatet e të cilit jane objekt diskutimi dhe përmirësimi në format e mësidhënies.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Nga DVV dhe vizita në zyrën e burimeve njerëzore GVJ konstaton se Institucioni rekruton staf akademik të kualifikuar. Gjithashtu, janë organizuar programe trajnimi të strukturuar (seminare dhe workshope lidhur me mësimdhënien, kërkimin shkencor, projektet etj) në nivel Universiteti dhe Fakulteti. Stafi akademik perfshihet ne programet e shkëmbimit të stafit me Universitetet e tjera partnere me te cilat ka marrëveshje (erasmus +).</p> <p>Departamenti i Inxhinierise se Ndertimit mbështet stafin e tij akademik për të përmirësuar kompetencat didaktike dhe inkurajon dhe motivon stafin akademik për të përmirësuar më tej mësimdhënien duke organizuar aktivitete të ndryshme trajnimi, leksione të hapura dhe workshope me profesorë të ftuar nga universitete të ndryshme. (Aneksi Nr.25, Udhëzues për planin e mobilitetit për stafin akademik ne kuader te erasmus+)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Personeli akademik eshte me tituj dhe grada, si dhe me formim profesional në formate kombëtare dhe ndërkombëtare. Personeli akademik transmeton njohuritë dhe konceptet e lëndës te studenti duke konkretizuar ato dhe me raste konkrete të eksperiencave profesionale të tyre. Kjo pasi Personeli akademik angazhohet në mësimdhënie përmes një procesi dinamik të vlerësimit të njohurive, kompetencave dhe metodologjisë në mësimdhënie dhe, se shperndarja e lendëve të programit tek stafi akademik realizohet duke u bazuar në fushat e eksperiencës së tyre. Ndhmon ketu edhe angazhimi ne projekte te ndryshme, trajnimi i vazhdeshem etj.</p> <p>Aneksi Nr.61, CV_Personeli Akademik të programit</p>

<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p> <p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.</p>	<p>Nga DVV dhe takimi me stafin akademik, studentët e programit, GVJ konstaton se rishikimi i syllabuseve të lëndëve, kryhet cdo fillim viti në UMT, për të gjitha programet e studimit. Drejtuesit e niveleve të ndryshme në Fakultet dhe Universitet si dhe zyrat e shërbimit ndaj studenteve janë në kontakt me shqetësimet e studentëve. Gjithashtu edhe këshilltarët akademikë janë më afër studenteve të secilit grup. Studentet i paraqesin shqetësimet e tyre pranë këshilltarit akademik, ose pranë zyrës së shërbimit ndaj studenteve.</p> <p>Nje rruge tjeter jane edhe pyetësoret. Pyetësori aktivizohet cdo semester. Rezultatet e pyetësorit përdoren nga organet vendimmarrëse të universitetit si një kontribut për përmirësime të mëtejshme. Në vijim ata, ja përcjellin shqetësimin e studenteve organeve më të larta.</p> <p>Institucioni vendos ne qender studentin. Stafet akademike ndërthurin shpjegimet në nivel teorik dhe empirik, duke u përqendruar në bashkëveprime të vazhdueshme midis profesorit dhe studentit. Metodologjia e mësimdhënies perfshin edhe formen interaktive dhe siguron rritjen e rendimentit te mesimnxenies. Studentet ndjeheshin te lire ne komunikim.</p> <p>[shënimet në vizitë] [Aneksi Nr.48, Platformat per mesimin online;</p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Personeli akademik perdor detyrat e kursit që prezantohen në grup, kjo i jep mundesi secilit të shprehë idetë e veta, të rrisë shkallen e bashkëpunimit. Prezantimet e punimeve nga ana e studentëve, projektet, detyrat dhe punimet laboratorike, inkurajojnë komunikimin e studentit. Forma të tjera që personeli akademik përdor është marrja e mendimeve të studentëve për aspekte te mesimnxenies.</p> <p>[Aneksi Nr.102], [Raport për metodat inovative në procesin e mësimdhënies].</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

### Standardi III.3

**Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mesimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>GVJ konstaton se UMT disponon dy godina në Qytetin Studenti, Rruga “BUDI” dhe “SOTIR KOLEA”, të cilat krijojnë mundësinë e zhvillimit të procesit mësimor.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Godina 1, ka sipërfaqe totale 2347 m<sup>2</sup>, në të cilën ndodhen 9 salla seminari me kapacitet 50 vende dhe 4 salla leksioni me kapacitet 100 vende. Aty ndodhen 2 laboratore. Po kështu në këtë godinë ndodhet edhe biblioteka me 30 vende leximi, e cila ka aktualisht 1250 tituj librash.</li> <li>- Godina 2, e kampusit Universitar ka 2490 m<sup>2</sup> në të cilën ndodhen 8 salla seminari me kapacitet 40 vende dhe 4 salla leksioni me kapacitet 100 vende dhe 4 laboratore.</li> </ul>



	<p>Godinat janë të pajisuar me sistem ngrohje totale si në korridore dhe në zyra apo auditore. Auditoret janë të pastra dhe me të gjitha kushtet për një zhvillim normal e dinjitoz të procesit mësimor.</p> <p><i>GVJ rekomandon zgjerimin i hapësirës së bibliotekës së universitetit.</i></p> <p><b>(Aneksi Nr.108, Asete infrastrukturore akademike _UMT)</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>Ambientet e dedikuara për procesin mësimor në Godinen 1 dhe Godinen 2, janë funksionale, me hapësira të mjaftueshme për studentët dhe stafin akademik për të zhvilluar veprimtarinë mësimore. Auditorët janë të pajisur me PC, video projector dhe me internet (wireless).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>GVJ konstaton se UMT përdor sistemin e menaxhimit të të dhenave të studentëve. Ky sistem është implemetuar që nga viti 2012, dhe është përditësuar në fillimin e vitit akademik 2020-2021 duke përdorë platformën edu4school. Sistemi mundëson menaxhimin e integruar të të dhenave për programet akademike dhe kurrikulat përkatëse, stafin akademik dhe studentët.</p> <p>Sistemi është një platformë e integruar bazuar në një arkitekturë modulare duke krijuar mundësinë e personalizimit të tij sipas nevojave dhe specifikave të UMT-së. Sistemi menaxhon në kohë reale lidhjen interaktive student/pedagog, syllabusin e lëndës dhe materialet didaktike të hedhura nga pedagogu (leksione, materiale të ndryshme), frekuentimin e studentit/lëndë, vlerësimet e studentit (vlerësimi i vazhduar dhe ai përfundimtar/lëndë) etj. Studenti në kohë reale ka akses në ecurinë akademike të tij (lista e notave të lëndëve të shlyera, detyrimet akademike të pashlyera etj).</p> <p><b>(Aneksi Nr.45, Ndërfaqja (Administratori, Pedagogu, Sekretaria, Studenti), (Aneksi Nr.63, Procedura për zhvillimin e provimeve_FIA) (Aneksi Nr.43, Sistemi informatik i menaxhimit të studenteve)</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se studentët kanë akses në literaturën që disponon Fakulteti dhe Universiteti në format fizik, pranë bibliotekës dhe atë online në edu4school.</p> <p>Megjithatë, një pjesë e studenteve nuk kishin interes të përdornin bibliotekën, prandaj rekomandohet që krahas përdorimit të sistemit edu4school, biblioteka e institucionit të ndër marrë masa të tilla të cilat do të lehtësojnë e mundësojnë përdorimin e saj masivisht në të ardhmen.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Biblioteka e institucionit ofron rreth 1250 tituj, të ndare neper seksione, duke përcaktuar titujt e formimit të përgjithshëm, nga ato të profilit.</p> <p>Ne takimet me stafin akademik, rezultoi se literatura e detyruar gjendet në bibliotekë.</p> <p>Megjithatë, GVJ rekomandon shtimi i titujve të bibliotekës, si dhe zgjerimi i hapësirës së saj.</p>

<p><b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Biblioteka është e pajisur me PC, në mënyrë që studentët të kenë mundësi të lexojnë bibliotekat on-line të vëna në dispozicion nga UMT-ja. Studentët kanë akses të pakufizuar edhe në këto adresa, të cilat janë funksionale për bibliotekën elektronike:</p> <p><a href="http://www.thefreelibrary.com">http://www.thefreelibrary.com</a>      <a href="http://www.doaj.org">www.doaj.org</a>  <a href="http://www.gutenberg.org">http://www.gutenberg.org</a>      <a href="http://www.eBacheloro.com">www.eBacheloro.com</a>  <a href="http://www.lawlink.coe.int">www.lawlink.coe.int</a> ;      <a href="http://www.cobis.al">www.cobis.al</a>  <a href="http://www.lawlink.nse.gov.au">www.lawlink.nse.gov.au</a>      <a href="http://www.reatprint.com">www.reatprint.com</a>  <a href="http://www.localjuris.com.fr">www.localjuris.com.fr</a>      <a href="http://www.freelebrary.com">www.freelebrary.com</a>  <a href="http://www.accessmylibrary.com">www.accessmylibrary.com</a></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>GVJ konstaton se UMT disponon infrastrukturën e nevojshme për realizimin e objektivave mësimore. Sallat e leksioneve/semnariere janë të pajisuara me PC, projektore. Biblioteka dhe laboratorët e informatikës janë të pajisura PC me programet e nevojshme. Për përgatitjen e diplomave studenti shfrytëzon si bazën e literaturës në hard copy ashtu edhe literaturë nga interneti apo biblioteka të tjera on-line në mjediset e bibliotekës.</p> <p>Laboratorët janë funksionalë dhe i shërbejnë procesit mësimor, si edhe studimeve specifike. Laboratorët shfrytëzohen nga studentët nën kontrollin dhe udhëheqjen e stafit përkatës akademik dhe ndihmës.</p> <p>Nga vizita në institucion rezultoi se në funksion të programit të studimit “Bachelor në Inxhinieri Ndertimi” janë ngritur laboratorët e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Laboratori e Informatikës,</li> <li>• Laboratori Multifunksional</li> <li>• Laboratori i Gjeoteknikës</li> <li>• Laboratori i Materialeve të Ndërtimit</li> <li>• Laboratori i Shkencave të Natyrës</li> <li>• Laboratori i levizshëm CPT</li> </ul> <p>Laboratorët janë të pajisur me aparatura dhe mjete mësimore bashkëkohore, të mjaftueshme në numër për kryerjen e orëve laboratorike.</p> <p>[Aneksi Nr.107, Ambientet për Infrastrukturën FIA-UMT]</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Stafi akademik dhe studentët janë të pajisur me adresë e-mail, <a href="mailto:e.mbiemer@umt.edu.al">e.mbiemer@umt.edu.al</a>. Gjithashtu përdoren, gjatë procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies, Google Drive and sharing, Google Classroom etj.</p> <p>Me anë të sistemit të menaxhimit të mësimi edu4school, pedagogët përdorin llogarinë e tyre të lëndëve individuale, të hapura nga zyra e IT. Nëpërmjet platformës pedagogët ndajnë shënimet e leksioneve, studentët dorëzojnë projektet ose detyrat, kryejnë dhe aktivitete të tjera të ngjashme, të nevojshme për lëndën specifike.</p> <p>UMT, përdor platformën “GotoMeeting” në zhvillimin e procesit mësimor gjatë COVID 19.</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin</p>	<p>Studentët dhe stafi përdorin sistemin edu4schools për shpërndarjen e informacionit, ruajtjes së të dhënave, menaxhimit të projekteve apo grupeve të punës. Gjithashtu përdoren platforma GoToMeeting dhe email zyrtar me domain <a href="http://www.umt.edu.al">www.umt.edu.al</a>.</p>




elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.									
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Permbyllja e studimeve realizohet ose me provim formimi ose me mbrojtje të punimit të diplomes për studentet me mesatare mbi 8. Në fillim të semestrit të gjashtë, studentet që kanë të drejtë të mbrojnë diplome me punim diplome përzgjedhin nga temat e ofruara ose propozojnë vetë një temë. Departamenti aprovon temën dhe i propozon udhëheqjen e një anëtarit të stafit akademik të departamentit, bazuar në disiplinën në të cilën ai dëshiron të kryejë punimin e diplomës. Pas caktimit të udhëheqësit, studenti dhe anëtarit i stafit akademik janë në kontakte periodike (te pakten tre kontrolle të ndërmjetme) gjatë gjithë semestrit, deri në përfundimin e punimit të diplomës.								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <tr> <th>Përmbushet plotësisht</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

### Standardi III.4

**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/ bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	<p>Institucioni monitoron plotësimin e standardeve të mesimdhënies, duke ju nenshtruar periodikisht proceseve të akreditimit.</p> <p>(<a href="https://www.ascal.al/media/documents/qaa%20eer/University%20of%20metropolitan.pdf">https://www.ascal.al/media/documents/qaa%20eer/University%20of%20metropolitan.pdf</a>)</p> <p>Në përputhje me objektivat strategjike të institucionit, UMT përcakton në Statut dhe rregullore (Ev. 1 dhe 2 statuti dhe rreg), prioritetin për sigurimin e cilësisë, si dhe ngritjen e Njësise së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (organ kolegjal). NJSBC është organi që bashkërendon veprimtarinë e vet me strukturat përgjegjëse në çdo fakultet, në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p> <p>Departamenti Inxhinierisë së Ndërtimit ka përcaktuar kordinatorët e programit të cilët, në bashkëpunim me NJSBC, e mbikëqyrin procesin mësimor. Përveç këtyre strukturave, kontrolli dhe mbikëqyrja bëhen edhe nga departamenti dhe Fakulteti në bashkëpunim me NJSBC-n. Këto njësi bëjnë edhe përhapjen dhe promovimin e eksperiencave të përparuara në mësimdhënie dhe mësimnxënie.</p> <p>(Aneksi Nr.13, VBA për Akreditimin Institucional të UMT dhe Certifikata e akreditimit). (Aneksi Nr.03, Plani strategjik i zhvillimit të UMT). (Aneksi Nr.07, VSA për ngritjen e Njësise së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë) (Aneksi Nr.10, Analizë e NJSBC për pyetësorët e stafit akademik)</p>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	<p>Fakulteti dhe Departamenti Inxhinierisë së Ndërtimit janë përgjegjës për sigurimin e cilësisë të programin të studimit. Institucioni ka angazhuar ekspertizë të jashtme në funksion të rritjes së cilësisë dhe sigurimit të saj.</p> <p>(<a href="https://www.ascal.al/sq/akreditimi/programme-te-akredituara">https://www.ascal.al/sq/akreditimi/programme-te-akredituara</a>)</p> <p>Anetaret e departamentit dhe fakultetit trajnohen vazhdimisht nga NJSBC dhe ekspertet e jashtme të kontraktuar me këto objekt. Eksperiencat e fituar</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr 219, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)


Faqe 31

	<p>ka ndihmuar në përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja në mësimdhënie, kërkim shkencor dhe fushën e sigurimit të cilësisë.</p> <p>Strukturat nxisin studentët që të jenë pjesë e procesit të evidentimit dhe përmirësimit të cilësisë në mësimdhënie.</p> <p>(Aneksi Nr.50, rregulloren e FIA).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Institucioni inkurajon personelin akademik të zhvillojë metoda të reja në mësimdhënie duke u përshtatur me zhvillimet e programit të studimit, me synim që UMT të jetë një institucion novator në fushën e aplikimeve teknologjike. Për studentët e programit Bachelor në Inxhinierinë e Ndërtimit organizohen takime dhe leksione të hapura me profesionistë të fushës. Personeli akademik trajnohet për përdorimin e softeve apo programeve specifike për zhvillimin e procesit të mësimdhënies.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>UMT motivon kualifikimin e mëtejshëm të personelit npr kërkimeve dhe studimeve brenda dhe jashtë vendit. Kualifikimi jashtë vendit organizohet nëpërmjet programeve të mobilitetit të pedagogëve, në kuadër të marrëveshjeve që ka lidhur UMT me institucione të arsimit të lartë, organizata të ndryshme ndërkombëtare si dhe të programeve ndërkombëtare si Erasmus<sup>+</sup></p> <p>UMT ofron mbështetje financiare të gjeneruara nga vetë institucioni apo nga projekte ndërkombëtare dhe ka nxitur, mbështetur kualifikimin e stafit akademik të fokusuar në organizimin e konferencave/aktiviteteve shkencore programet e shkëmbimit, promovimin e personelit akademik, etj.</p> <p>(Aneksi Nr.24, Lista e projekteve të aplikuara nga UMT dhe projektet fituese)</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Institucioni mbështet personelin akademik dhe atë ndihmës akademik duke iu dhënë mundësinë për trajnime të ndryshme në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Gjithashtu, i motivon në pjesëmarrje në veprimtari jashtë UMT, brenda ekspertizës së ndërtimit.</p> <p>(Aneksi Nr.22, Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe antarësimet në rrjete) (Aneksi Nr.27, Lista e universiteteve bashkëpunuese në kuader të shkëmbimit/mobilitetit dhe trajnime ku stafi ka marrë pjesë)</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>GVJ konstaton se në statut dhe strategji, institucioni përcakton se personeli akademik dhe ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe zbatimin e metodave të reja. Përgjegjësi i departamentit përgjigjet për ecurinë e punës kërkimore shkencore dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, duke respektuar lirinë akademike dhe kërkimore të personelit akademik</p> <p>UMT ofron mbështetje institucionale duke vënë në dispozicion të personelit akademik infrastrukturë mbështetëse (laboratore, ambiente, sisteme/ programe informatike, biblioteka etj.</p> <p>GVJ, gjatë takimeve me drejtuesit dhe stafin akademik, konstaton se Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës periodikisht në fund të vitit akademik analizon punën kërkimore dhe mësimore duke evidentuar arritjet dhe mangësitë, si dhe përcakton ecurinë për të ardhmen</p>



	(Aneksi Nr.02, rregullore e UMT, Aneksi Nr.50 Rregullore e FIA). (Aneksi Nr.108, Asete infrastrukturore akademike _UMT_Tab_Nr.8) (Aneksi Nr.73, Raport vjetor i aktiviteti mësimor, kërkimor dhe financiar 2018-2019).			
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	NJSBC dhe Fakulteti vënë në fokusin e tyre metodat e mesimdhënie. Referuar takimeve me stafin dhe NJSBC evidentohet të jene organizuar seminare, leksione të hapura, konsultime, work-shope etj. për metodat e reja, me pjesëmarrjen e të gjithë personelit akademik të UMT. Sfidat që solli periudha e pandemise ishin një shtyese që ndihmoi institucionin në implementimin e metodave inovatore të mesimdhënie.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Plotësisht përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi III.5</b>	
<b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	<p>Kriteret dhe mënyra e testimit dhe e vlerësimit të njohurive, aftësive, kompetencave profesionale përcaktohen në rregulloret e institucionit, rregulloren e programit. Gjithashtu, Senati Akademik ka miratuar një vendim të posaçem për vlerësimin e vijuar. Në këto rregullore janë parashikuar elementet e procesit të vlerësimit si detyra kursi, punë në grup, provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare.</p> <p>Mënyra e vlerësimit përcaktohet edhe në syllabuset e çdo lënde në bazë të specifikave të saj. Studentet njihen me këto rregullore si një e drejtë dhe detyrim i tyre, si dhe janë parashikuar si pjesë përbërëse e kontratës së shkollës dhe studentit. Ato janë të publikuara dhe studentët mund t'i aksesojnë në çdo moment. Procesi i vlerësimit përgjithësisht rezultojnë të jete:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 10 % pjesëmarrja dhe aktivizimi</li> <li>- 10 % plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit)</li> <li>- 20 % testimet gjatë vitit</li> <li>- 60 % provimi përfundimtar.</li> </ul> <p>GVJ mendon se kjo ndarje e vendosur nga institucioni është e bazuar në parimin e vlerësimit gjatë gjithë vitit.</p> <p>(Aneksi Nr.56, Plan programet e lëndëve/syllabuset_ Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi)</p>
<b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	<p>Në rregulloren e UMT-se dhe në rregulloret e tjera të provimeve apo të programit që e plotësojnë atë, përcaktohet detyrimi për të informuar studentët në fillim të çdo moduli/ lende me metodologjinë e testimit dhe të vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. Referuar takimeve me stafin dhe studentet, rezultojnë të jete realizuar një proces i tille.</p> <p>Studentët njihen me kriteret dhe mënyrat e vlerësimit nëpërmjet sqarimit nga ana e pedagogut të lëndës të syllabusit përkatës.</p>




	(Aneksi Nr.120, Rregulloren e provimeve)			
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	<p>Sipas Rregullores se provimeve, testimi i njohurive dijeve dhe aftësi të fituara nga studentët realizohet duke vlerësuar me pikë pjesëmarrjen dhe aktivizimin, detyrat e kursit, (projekte etj), labororet, provimet e ndërmjetme dhe provimit përfundimtar. Në nivel programi studenti vlerësohet edhe për praktikën dhe detyrimet permbyllëse për mbrojtjen e diplomës.</p> <p>Teza e provimit hartohet duke kombinuar pyetjet me alternativa, zbërthim konceptesh, ushtrime praktike si dhe ushtrime të ndryshme sipas lëndës. Mënyra e vlerësimit dhe shpërndarja e pikëve brenda lëndës bëhet sipas modelit të detajuar (model teze) gjithsej 100 pikë, por mbetet në kompetencë të pedagogut përgjegjës të lëndës shpendarja e peshës specifike për secilin komponent të vlerësimit. (Aneksi Nr.120, Rregulloren e provimeve; Aneksi Nr.63, Udhëzimi mbi procedurat për zhvillimin e provimeve_FIA).</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<b>Standardi III.6</b>	
<b>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	<p>Vlerësimi i dijeve të studentëve bëhet duke u bazuar në pikët e grumbulluara gjatë vitit sipas formës së vlerësimit të vazhduar gjatë semestrit, sipas komponentëve të përcaktuar në syllabusin e lëndës, ku pesha në % dhe menytrat e vlerësimit janë specifike sipas llojit të lëndës.</p> <p>Testimi dhe vlerësimi i dijeve të studentëve të programit realizohet pergjatë gjithë semestrit akademik. Ne pergjithesi janë përcaktuar dy testime-kontrolle ne javen e katert dhe javen dymbedhete si dhe nje provim i ndërmjetëm-midterm (java e 8 e semestrit). Studentët testohen me teste, projekte, detyra, etj. sipas syllabusit përkatës</p> <p>(Aneksi Nr.56 syllabuset e programit), (Aneksi Nr.58, Rregullore e programit_Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi).</p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	<p>Për të siguruar transparencën, objektivitetin e vlerësimit të njohurive të studentëve dhe për të shmangur rastet e subjektivizmit, UMT ka vënë në zbatim sistemin elektronik edu4school nëpërmjet të cilit realizohen testime në format quizesh (me alternativa) ose e kombinuar dhe me pyetje të natyrës teorike, te cilat korrigjohen nga pedagogu i lëndës. Provimet zhvillohen me barcode, ne menyre anonime. Detyrat, projektet, dorëzohen në mënyrë elektronike dhe/ose të printuar tek pedagogu përkatës. Notat hidhen në mënyrë elektronike në Sistemin Interaktiv edu4school.</p>
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	<p>Vlerësim përfundimtar realizohet nga komisionet e provimeve (jo më pak se 2 pedagogë, nën drejtimin e titullarit të lëndës) të ngritura nga departamentet dhe të miratuara nga Dekani i Fakultetit, siç parashikohet nga Rregullorja e përgjithëshme e UMT-së, Regullorja e provimeve dhe Udhëzimi i Dekanit të FIA.</p>

	(Aneksi Nr.120, Rregulloren e provimeve; Aneksi Nr.63, Udhëzimi mbi procedurat për zhvillimin e provimeve_FIA).
<b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	Kontrolli i testeve dhe provimeve zhvillohet në mënyrë konfidenciale sipas rregullave të parashikuara në rregulloren e brendshme dhe të provimeve. Vlerësimi i njohurive në mes të vitit dhe në fund të vitit bëhet i koduar në mënyrë anonime. Format e kontrollit parashikohen në rregulloren e provimeve. Teza përgatitet nga titullari i lëndës dhe asistenti ose një anëtar tjetër i komisionit. Tezat sekretohen nga sekretaria me barkod dhe kontrollohen nga pedagogu në mënyrë anonime. Pedagogu shpall rezultatet dhe sekretaria identifikon emrin me rezultatin në fletën e provimit. Institucioni vë në dispozicion të studentëve për realizimin e provimeve sallat e leksioneve, që janë të pajisura me kamera, për monitorimin e procesit të provimit.  (Aneksi Nr.120 rregullorja e provimeve) (Aneksi Nr.63, Udhëzim i FIA mbi Procedurat për zhvillimin e provimeve)
<b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Vlerësimi i njohurive behet sipas rregullave të UMT-së. GVJ nga dokumentacioni dhe takimi me studentët konstaton se në kontrollin e dijeve vleresohen dijet dhe puna individuale e studentit. Nëpërmjet komunikimit të drejtpërdrejtë, stafi akademik gjatë orëve të seminareve u ofron studentëve komente /feedback për performancën e tyre lidhur me përvetësimin e njohurive gjatë seminareve/testimeve të ndërmjetme, nivelit të përgatitjes/prezantimeve të detyrave të kursit/projekteve, duke iu dhënë këshilla/orientime për përmirësimin e performancës në të ardhmen.  [Aneksi Nr.63, Udhëzim i FIA mbi Procedurat për zhvillimin e provimeve]
<b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.	Departamenti dhe personeli akademik bazohen në rregulloren e provimit dhe të etikës lidhur me mënyrën e mbikëqyrjes, dhe të masave ndeshkuese në rast plagjature gjatë procesit të provimit. Përsa i përket detyrave të kursit dhe kryesisht të punimeve të diplomave, personeli akademik dhe drejtuesit e departamentit dhe Fakultetit, orientojnë/miratojnë tematika kryesisht aplikative ose gjysëm aplikative, ku të dhënat që përdoren (kryesisht të punimet e diplomave) të jenë autentike.  Çdo antar i stafit akademik dhe jo akademik sipas detyrave të ngarkuara është përgjegjës për garantimin e një niveli të lartë të ndershmërisë në çdo kohë dhe rrethanë, referuar draft kontrates së pedagogut dhe Rregullores së Etikës.  (Aneksi Nr.120 rregullore në provimit) [Aneksi 14.Rregullorja e Etikes -UMT). (Aneksi Nr.64, Procedura e përgatitjes dhe mbrojtjes së punimit të diplomës)
<b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	GVJ, gjatë viztës në Sekretarinë mësimore konstaton që vlerësimi kryhet me sistem prej 10 notash. Nota me e ulët kaluese është 5. Rezultatet e provimit ju bëhen të njohura studentëve nga sistemi edu4school, ose edhe me komunikim verbal dhe individual, në departament. Në raste kur provimet zhvillohen me shkrim, komisioni shpall dhe çelësin e zgjidhjes. Teza korigjohet nga komisioni dhe brenda tre diteve, studenteve ju komunikohen rezultatet paraprake nëpërmjet sistemit. Mbas përfundimit të procesit të vlerësimit teza depozitohet në departament.  Gjate vitit pedagogët janë të lirë të alternojnë metodat kontrolluese dhe vlerësuese të cilat përfshijnë kontroll të vazhdueshëm nëpërmjet provimeve,



	teste me pyetje alternative, quize, prezantime ne grup ose individuale, etj. (Aneksi Nr.120, Rregullore e provimit)			
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Referuar takimit me studentet, ata njohin te drejten e tyre për ankimim. Mbas shpalljes se rezultateve paraprake nga pedagogu në sistem, studenti ka të drejtën e kontestimit të mundshëm brenda afateve të përcaktuara në rregullore. Mbas kontestimit të notës nga studenti, kërkesa e tij për rivlerësim shqyrtohet nga komisioni i provimeve dhe pedagogu i lëndës të cilët më pas vendosin për notën përfundimtare.  Mbas kësaj faze, serisht studenti ka të drejtën e kontestimit të notës në instanca më të larta, ku kërkesa shqyrtohet me nje komision të vaçantë.  (Rregullore e UMT), (Rregullore e provimeve)			
<b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Kërkesa per ankimim note shqyrtohet nga komisioni fillestar apo komisionet e tjera të ngritura, duke respektuar rregulloren e provimeve dhe rregulloret e tjera që lidhen me procesin e provimeve në UMT.  (Aneksi Nr.120, Rregulloren e provimit; Aneksi Nr.63, Udhëzimi mbi procedurat për zhvillimin e provimeve_FIA).			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi III.7



**Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	<p>Plani mësimor i programit të studimit përfshin lende teorike dhe praktike ne fushen e ndertimit, praktiken profesionale dhe diplomën. Kjo kurrikul parapergatit studentet per thellimin e studimeve ne ciklin master.</p> <p>Syllabuset e lëndës/modulit paraqesin objektivat, aftësitë dhe kompetencat që fiton studenti në lëndën përkatëse.</p> <p>Departamenti ofron sherbime shtese krahas procesit mesimor, te tilla si konsultime apo leksione te hapura. Stafit akademik perfshin studentet ne veprimtari jashtekurrikulare. Gjithashtu, shkembimet e studenteve ndihmojne ne perthithjen e aftesive ne fushen e ndertimit.</p> <p>Studentët perfshihen edhe ne veprimtarine kerkimore te stafit. Ato inkurajohen për të punuar në grup gjatë procesit mësimor. Në seminare organizohen diskutimet e çështjeve të caktuara duke i ndarë studentët në grupe sipas roleve që do të luajnë dhe secili grup përfaqëson një grup interesi.</p> <p>UMT ka krijuar nje bazë komunikimi dhe marrëdhëniesh, e cila i siguron kushte dhe mundësi për të realizuar praktikat mësimore dhe internshipe për studentët. Në politikat e tij, FIA po punon për zgjerimin e mëtejshëm të bashkëpunimit me institucione arsimore si dhe me organizatat e biznesit dhe institucionet shtetërore.</p>

	<p>Projektet kërkimore kanë në fokus bashkëpunimet në fushën kërkimore, mobilitetin e studentëve dhe stafit akademik. Gjatë vitit 2019 -2020, UMT ka aplikuar ne 17 projekte të ndryshme dhe është në procesin e implementimit të 7 projeteve të cilat i ka fituar. Në kuadër të projekteve kërkimore dhe mobilitetit JoinEU-SEE III, ERAWEB I, CEEPUS, në vitin akademik 2017-2020 nga Fakulteti, 3 studentë kanë realizuar nje tremujor studime në universitetet partnere në kushtet e mobilitetit. Gjithashtu kanë bashkëpunuar në kërkimin shkencor dhe në mësimdhënie 14 pedagogë.</p> <p>(Aneksi Nr.56, syllabuset), (Aneksi Nr.99, Lista aktiviteteve (leksione te hapura)). (Aneksi Nr.27, Lista e universiteteve bashkëpunuese në kuader të shkembimit/mobilitetit). (Aneksi Nr.23, Lista e marreveshjeve ne kuader te programeve te FIA) (Aneksi Nr.24, Lista e projekteveve aplikuar nga UMT dhe projektet fituese) (Aneksi Nr.28, Lista e shkëmbimeve ndërkombëtare të studentëve dhe stafit)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Lidhur me kete kriter, programi i studimit permban lendet Bazat e Informatikes, Metoda numerike ne Inxhinieri, AUTOCAD, lëndë të gjuhëve të huaja, etj. Në disa parashikohet implementimi i softwareve inxhinierike si SAP, ANSYS, ETABS, MS PROJECT, Autocad etj.,</p> <p>Syllabuset e lëndës/modulit paraqesin përmbajtjen e saj, dhe ndarjen sipas veprimtarive formuese, kreditet dhe orët përkatëse. Objektivat, aftësitë dhe kompetencat janë paraqitur ne syllabus. Keto elemente qe detajohen ne cdo lende jane pjese e objektiveve te pergjitheshme te programit.</p> <p>(Aneks.56: Syllabuset e lendeve)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Referuar takimit me stafin akademik, GVJ konstaton se ne javet e fundit, pedagoget e lendes informojne studentet mbi kompetencat e fituara qe duhet te demonstrojne ne provim. Studentët orientohen në lidhje me strukturën dhe natyrën e pyetjeve që do të ketë provimi final dhe gjithashtu edhe për peshën që do të ketë në notën finale të modulit provimi final.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Stafi akademik i departamentit angazhohet në aktivitete shkencore, në konferenca dhe simpoziume workshope, si dhe zhvillon leksione në institucione ndërkombëtare në kuadër të Erasmus+. Gjithashtu, nëpërmjet marrëveshjeve me IAL të tjera iu është krijuar mundësia e mbështetjes konkrete për kërkimin shkencor.</p> <p>Stafi i Departamentit te Inxhinierise së Ndërtimit organizon diskutime me studentet për temat e diplomës, per mundesite e punesimit te tyre, u prezanton pjesmarrjen e departamentit në konferenca dhe simpoziume, merr pjesë dhe organizon workshope me studentet.</p> <p>RVB, Takime, Ev 28,27,24,74,72</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Studentët e programit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi kanë në dispozicion laboratorët kompjuterikë, laboratorët fizike te inxhinierisë së ndërtimit, si dhe praktikat profesionale. Persa i përket përgatitjes profesionale dhe zhvillimit të kompetencave të studentëve, Departamenti bashkërendon punën e vet me strukturat e tjera, duke i asistuar ne zhvillimin e praktikave profesionale, gjë që përbën edhe një objeksion gjatë zhvillimit të saj.</p>





<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>GVJ, gjatë takimit me stafin akademik konstaton se studentët inkurajohen për të punuar në grup në zgjidhjen e detyrave të shtëpisë apo të kursit, gjatë procesit mësimor, në praktika, laboratore etj. Kjo punë realizohet nën drejtimin e pedagogut udheheqës apo të lëndës.</p> <p>Puna në grup mbi interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave të ndryshme perben një ndër kompetencat e programit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi</p> <p>[Kurrikula e programit të studimit]</p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p> <p><b>Kriteri 9.</b> Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.</p>	<p>GVJ konstaton se në Departament ka klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative dhe kërkimore, në bashkëpunim me studentët. Kërkimi shkencor në UMT aplikohet përmes stimulimit të inovacionit në projekte shkencore dhe projekte të shoqërisë civile. Në UMT është krijuar dhe funksionon qendra kërkimore</p> <p>Puna me projektet kërkimore në UMT, ka si fokus bashkëpunimet në fushën kërkimore, mobilitetin e studentëve dhe stafit akademik, mundësinë e realizimit të programeve të përbashkëta të studimit, si dhe marrjen e përvojave të reja kërkimore.</p> <p>Kështu studentët inkurajohen të zhvillojnë ide inovative në detyra e projekte, të avancojnë dhe promovojnë punimet e tyre shkencore në seminare dhe aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p>Në UMT janë krijuar dhe funksionojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Qendra Metroresearch</i> si pjesë integrale e aktivitetit shkencor dhe akademik të UMT, që prezanton standarde të aplikueshme kryesisht në fushën e edukimit, menaxhimit, lidhshmërisë, ndërtimit, TI, zhvillimit të qendrueshëm etj., dhe ofron mentorim, menaxhim apo konsulta për partnerët strategjikë në zhvillimin e projekteve kërkimore.</li> <li>- Metropolitan Incubator (pjesë e Qendrës Metroresearch dhe UMT). Këtu, studentët dhe të rinjtë kanë mundësinë të krijojnë një Start-Up dhe t'i finalizojnë idetë me një produkt përfundimtar.</li> <li>- UMT organizon <i>Konkursin Kombëtar "Start Up City"</i>, (në nivel universitar Shqiperi dhe Kosovë). Sivjet u zhvillua edicioni i tretë. Në "Start Up City" fituesit përfitojnë 2500 euro. Start Up City" ndihmon studentët dhe të rinjtë të zhvillojnë idetë e tyre të biznesit, duke i prezantuar përballë një jurie.</li> </ul> <p>Evidenca 99, 72</p>			
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>UMT ka një numër marrëveshjesh bilaterale për shkëmbimin e studentëve, lista e të cilave është vënë në dispozicion të GVJ. Marrëveshjet aktive janë me:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Universitetin Politeknik të Barit,</li> <li>- Universitetin Teknik "Gheorghe Asachi" në Iasi, etj.</li> </ul> <p>Stafi Akademik dhe studentët e universiteteve partnere shkëmbehen çdo semester.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>





**Standardi III.8****Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>UMT parashikon procesin e diplomimit të studentëve në tërësi në aktet e brendshme rregullatore. Rregullorja e Fakultetit shpreh procesin e diplomimit të studentëve që studiojnë në FIA. Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës ka të miratuar rregulloren specifike të diplomimit ku janë të përcaktuara procedurat, formatet dhe modalitetet e mbrojtjes së diplomës.</p> <p>Procedura për provimin final dhe mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve është e publikuar në faqen e internetit, të cilën studentët mund ta aksesojnë. Për studentët me mesatare mbi 8 ofrohet mundësia e zhvillimit të tezës së provimit.</p> <p>Komisioni dhe kryetari i komisionit për provimin përfundimtar ose mbrojtjen e diplomes caktohen nga Përgjegjësi i Departamentit dhe miratohen nga Dekani. Kryetari i komisionit në bashkëpunim me anëtarët plotësojnë një program tematikash për lëndën e provimit të përgjithshëm përfundimtar (banka e tematikave), si dhe për projektin e diplomimit dhe i shpërndajnë ato tek studentët në fillim të semestrit. Pedagogët punojnë me studentët, i orientojnë, i ndihmojnë të punojnë në mënyrë të pavarur dhe ndajnë materialet që mund t'i ndihmojnë ato të kryejnë punën e tyre kryesisht kërkimore.</p> <p>(Aneksi Nr.02, Rregullore e UMT). (Aneksi Nr.64, Procedura e përgatitjes dhe mbrojtjes së punimit të diplomës)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Në rregulloren e UMT, GVJ konstaton se Teza e Provimit të përgjithshëm përfundimtar është e përbërë nga grupe të ndryshme pyetjesh të përgatitura nga lëndët teknike që studentët kanë ndjekur gjatë studimeve. Përqindja e secilit grup pyetjesh përcaktohet në bazë të ngarkesës së lëndës (krediteve) në kurrikul dhe raportit të tyre me lëndët e tjera.</p> <p>Komisioni i provimit të përgatit tezen për provimin e përgjithshëm përfundimtarë bazuar në pyetjet e paraqitura nga secili pedagog i përfshirë në proces, sipas përqindjes së përcaktuar.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/diplomave.</p> <p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Stafi akademik përfshihet në konsultimin për provimin e përgjithshëm përfundimtar sipas nje orari të caktuar. Kryetari i komisionit të provimit të përgjithshëm përfundimtar organizon dhe ndjek orarin e konsultimit të realizuar nga pedagogët e seciles tematike.</p> <p>Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve infrastrukturën, si dhe staf ndihmës për të asistuar studentët për kryerjen e matjeve, analizave dhe testeve të ndryshme. Personeli akademik dhe ndihmes asistojnë dhe ndihmojnë studentët e programit bachelor në realizimin e punimit të diplomes</p> <p>(Aneksi Nr.02, Rregullore e UMT). (Aneksi Nr.64, Procedura e përgatitjes dhe mbrojtjes së punimit të diplomës)</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në</p>	<p>Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve dhe konkluzioneve, përpunimin e tyre, si dhe paraqitjen dhe shkrimin e temës</p>

<p>nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve, orgjinalitetin e tyre dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Provimi përfundimtar ose projekti i diplomimit vlerësohet me notë, nga komisioni i provimit ose i mbrojtjes së diplomes</p> <p>Vleresimi behet ne baze te vleresimeve te pavarura te anetareve te komisionit pas prezantimit te temes nga kandidati dhe pas pergjigjeve te pyetjeve te bera nga komisioni. Nota komunikohet ne prani te komisionit nga kryetari i komisionit .</p> <p>Ne rastin e provimit perfundimtar nota del pas vleresimit te cdo tematike nga anetari i komisionit pergjegjes per fushen perkatese</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Në përfundim të studimeve, pasi studenti plotëson të gjitha kërkesat e procedurës së diplomimit, duke përfshirë 180 ECTS zyrtar përkatëse përfundojnë procedurën zyrtare të diplomimit për studentin. Sekretaria mesimore pajis studentët e diplomuar me diplomën dhe suplementin e diplomës sipas formateve të aprovuara nga MASR.</p> <p>Institucioni realizon ceremoni diplomimi. Diploma mbart elementët e përcaktuar nga MASR dhe lëshohet vetëm njëherë. Institucioni mban kopje të saj dhe studenti mund të pajisjet vetëm me vërtetime në rast humbjeje të saj. Studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar, në rastet kur ai e kërkon këtë gjë. Referuar vizites ne sekretarine mesimore, dokumentacioni për studentët ruhet nga IAL për një periudhë të pacaktuar në hardcopy si dhe në databazën digjitale që tashmë disponon UMT, sistemi edu4schools.</p> <p>Dokumentacioni themelor për studentët është:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Regjistri themeltar i studentit i cili vërteton regjistrimin e studentit që pajiset me numër matrikullimi deri në marrjen e diplomës ose certifikatës;</li> <li>• Regjistri i arritjeve akademike të studentit që vërteton rezultatet e studentit gjatë aktivitetit të tij akademik;</li> <li>• Regjistri i lëshimit të diplomave dhe certifikatave që vërteton emetimin certifikatave dhe diplomave.</li> <li>• Dosja e studentit, që përmban: dëftesën e maturës, ID, formularin e aplikimit, etj.</li> </ul> <p>Këto dokumente si dhe procesverbalet e provimeve, ruhen pas diplomimit, në arkivën e institucionit dhe më pas sipas ligjit per arkivat. Të dhënat origjinale të studentit i kthehen atij, ndërsa institucioni ruan kopje të njësuar me origjinalin në formë hardcopy dhe elektronike.</p> <p>(Aneksi Nr.95, Rregullore e Sekretarisë; Aneksi Nr.114, Rregullore e arkivës), (Aneksi Nr. 87, Shembull_Dosje studenti të regjistruar)</p>






<b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar, në rastet kur ai e kërkon këtë gjë. Ky material është i përgatitur në dy gjuhë, fakt që ndihmon studentin kur shkon jashtë shtetit për studime ose punësim.			
<b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	Këto dokumente si dhe procesverbalet e provimeve, ruhen pas diplomimit, në arkivën e institucionit dhe më pas, sipas ligjit për arkivat. Të dhënat origjinale të studentit i kthehen atij, ndërsa institucioni ruan kopje të njësuar me origjinalin në formë hardcopy dhe elektronike.  Universiteti arkivon dokumentacionin e studentit pas diplomimit në zyrat e arkivës. Rast pas rasti, bazuar në kërkesat specifike të studentëve, leshohen vërtetime për qëllime të ndryshme.  [Rregullore e diplomes], (Aneksi Nr.87, Shembull_Dosje studenti të regjistruar)			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X
<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi IV.1</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ.	Gjatë aktivitetit akreditues në UMT, GVJ u interesua posaçërisht për të dhënat lidhur me personelin akademik PAE, PAK dhe me atë ndihmësimor-shkencor dhe administrativ. Konsideruar si një faktor shumë i rëndësishëm për mbarëvajtjen e gjithë aktivitetit të një institucioni, por veçanërisht procesit mësimor dhe atij kërkimor shkencor, GVJ konsultoi dokumentin e sjellë nga Institucioni lidhur me plotësimin e këtij kriteri (RVB, EV 1-2, EV 29, EV 66-72) si dhe protokollin e mbajtur gjatë vizitës në UMT dhe konkludon në plotësimin e këtij kriteri nga ana e institucionit.  Të dhënat për personelin e angazhuar në PS “Bsc në Inxhinier Ndërtimi” ishin të plota dhe të aksesueshme. Të formuluar dhe të miratuara, mbështetur në dispozitat ligjore e aktet nënligjore e, për pasojë, edhe në rregullimet ligjore të UTM, (Statut, Rrugullore, plan strategjik), ato garantojnë qoftë arritjen e objektivave në processin mësimor e atë kërkimor shkencor, qoftë edhe për të ndjekur një dinamikë në progresimin cilësor të tyre.  [Evidenca 1 Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana] [Evidenca 2 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana] [Evidenca 29 Udhëzim mbi politikat e punësimit të stafit akademik në UMT] [Evidenca 66 FIA Lista e plote e personelit me kohe te

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr 219, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 41

	<p>plote dhe me kohe te pjesshme] [Evidenca 68 Modeli i formularit të vlerësimit të Performacës] [Raporti i Vlerësimit të Brendshëm] [Shënimet e vizitave në UMT]</p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Për të dëshmuar plotësimin e këtij kriteri Institucioni vuri në dispozicion të GVJ dokumentacionin përkatës, si dhe mundësoi takimin me stafin akademik të PS.</p> <p>Nga konsultimi me dokumentacionin, gjatë vizitës në zyrën e burimeve njerëzore dhe në takimin me personelin akademik, GVJ konstaton që rekrutimi i PA bëhet në përputhje me bazën ligjore dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit. GVJ u njoh me realizime konkrete të procedurave të rekrutimit dhe i gjeti ato në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p> <p>[Evidenca 1 UMT Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana] [Evidenca 2 UMT Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana] [Evidenca 29 UMT Udhëzim mbi politikat e punësimit të stafit akademik në UMT] [RVB] [Shënimet e vizitave në UMT]</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Në RVB thuhet që: <i>për përzgjedhjen e PA, institucioni ngre komisionet ad-hoc të vlerësimit me 5 antarë, nga të cilët 3 janë përfaqësues të Departamentit, një i Dekanatit dhe një i rektoratit.</i></p> <p>GVJ kërkoi njohjen me punën e këtij komisioni. Në përgjigje të kësaj kërkesë shpjegimet na u dhanë nga vetë PA, kur treguan procedurat konkrete të rekrutimit të tyre ndërsa dokumentacionin e plotë e gjetëm tek Zyra e Burimeve Njerëzore. Bazuar në këto gjetje GVJ gjykon plotësimin e këtij kriteri.</p> <p>[RVB] [Shënimet e vizitave në UMT]</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Nga RVB, GVJ konstaton se nevojat për rekrutim të personelit akademik i paraqet Departamenti që mbulon PS. Nevojat mbështeten në shpërndarjen sa më eficiente të ngarkesës mësimore të lëndëve të kurrikulës konkrete. Pra, personeli i rekrutuar lidhet konkretisht me përballimin sa më të plotë të ngarkesës së lëndëve, për të cilat ka edhe përvojën edhe njohuritë e duhura që garantojnë zhvillimin me cilësi të procesit mësimor dhe angazhim në punën kërkimore shkencore. Gjatë takimeve në institucion GVJ mësoi që personat e rekrutuar kanë përballuar me cilësi ngarkesën mësimore dhe kanë angazhim domethënës në kërkimin shkencor. Në takimin e GVJ me studentët, ata shprehën vlerësime për cilësinë e mësimdhënjes nga pedagogët e angazhuar në PS “Bsc në Inxhinier Ndërtimi”</p> <p>[Evidenca 29 Udhëzim mbi politikat e punësimit të stafit akademik në UMT] [RVB] [Shënimet e vizitave në UMT]</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

#### Standardi IV.2

**Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të</p>	<p>Gjatë vizitës në UMT, GVJ vizitoi ambientet bazë si të infrastrukturës administrative ashtu edhe të asaj mësimore e kërkimoro-shkencore. Gjatë këtyre vizitave, bazuar edhe në të dhënat e RVB, GVJ gjeti që të gjitha ambientet e vëna në dispozicion të aktivitetit universitar ishin me kushte të mira. Auditorët, klasat</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr 219, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 42

<p>barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>për seminarët e ushtrimet si dhe laboratorët kishin paisjet e nevojshme për një aktivitet normal mësimor dhe një kërkim optimal shkencor. Edhe ambientet e tjera si zyra, mjedise çlodhëse, koridore etj krjionin mjedis të këndshëm dhe funksional. Hapsirat ishin të bollshme, me ndriçim të mirë me kondicionierë për kondicionimin e temperaturave. Të pyetur për shfrytëzimin e kapaciteteve ambientale e teknologjike përgjigja ishte se kapacitetet e projektuara ishin afërsisht sa dyfishi i atyre të shfrytëzuara çfarë flet për përballim e kërkesave për PS edhe nqs ato dyfishohen. Sa i përket trajtimit financiar si në paga ashtu edhe në kualifikim pedagogët u shprehën se ai ishte stimulus dhe inkurajues, Po ashtu GVJ konstaton se UMT kishte një projekt konkret për ndërtimin e një korpusi të ri universitar me sipërfaqe rreth 10 000 m<sup>2</sup>. Në përfundim, pasi konsultoi të gjitha dokumentacionet e vëna në dispozicion, GVJ vlerëson plotësimin e këtij kriteri.</p> <p>[Evidenca 91 FIA Ambjente per infrastructure] [Evidenca 108 FIA Asetet Infrastrukturore akademike] [RVBShënimet e vizitave në UMT]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Nga dokumentat që na vuri në dispozicion UMT (DVV) si dhe protokollit i vizitave në institucion, GVJ u informua për metodat dhe procedurat që ndiqen në këtë institucion me qëllim kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit. Ai konstatoi që mënyrat e ndjekura janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Angazhimi i lektorëve të huaj dhe personaliteteve nga fushat inxhinierike</li> <li>- Trajnimet për njohjen e përvetësimin e metodave inovative në procese specifike</li> <li>- Programet e mobilitetit në kuadër të programeve ndërkombëtare</li> <li>- Pjesëmarrje në aktivitete të përbashkëta me institucione të huaja dhe vendëse</li> <li>- Trajnimet me AKKSH për mundësitë e aplikimit dhe informacion mbi aplikimet.</li> </ul> <p>Për t'u njohur me efencën e këtyre metodave, GVJ drejtoi pyetje gjatë takimit me stafin akademik. Tek pyetja: <i>sa ju mbështet institucioni për kërkimin shkencor</i>, një pedagog pohoi që universiteti ofron mobilitet me partnerët, ofron laboratorët e tij si dhe lidhje marrveshjesh. Ndërsa një tjetër pedagog (me rreth 5 vite punë) tha që për pjesëmarrjen në një konferencë jashtë vendit të gjitha shpenzimet i financoi universiteti. Nga një analizë tërësore GVJ vlerëson që kriteri plotësohet, <i>por ai do të sugjeronte një përfshirje edhe më të madhe në projekte për realizimin e doktoratave, natyrisht duke shfrytëzuar mundësitë për financimin, aktivizimin dhe zhvillimin e tyre.</i></p> <p>[Tabela 6 Cilësia e Stafit Mësimdhënës për PS] [RVB] [Shënimet e vizitave në UMT]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Referuar dokumentave të tillë si RVB, Tab 17, EV 3, EV 18, EV 102 si dhe vizitave në ambientet e universitetit, të cilat ishin në dispozicion të PS Bsc "Inxhinieri Ndërtimi", GVJ konstaton që disponohen teknologji të reja, të cilat janë në përdorim. Psh u konstatua që teknologjia e mësimit online në sistemin e menaxhimit GoToMeeting ishte adaptuar në kushte optimale, duke u krijuar lehtësi si pedagogëve ashtu edhe studentëve në përmirësim të cilësisë së mësimdhënjes dhe mësimnxënjes online. Po kështu me teknologji të re ishin paisur laboratore si ai i materialeve të ndërtimit, gjeoteknikës, laboratorit</p>

	<p>multifunksional etj, të cilët ishin funksionues edhe në sajë të kualifikimit profesional të PA. Në përfundim GVJ konfirmon plotësimin e këtij kriteri.</p> <p>Tabela 17 Të dhëna të plota për platformat online  [Evidenca 3 Plani strategjik i UMT] [Evidenca 18 Politika e cilësisë UMT] [Evidenca 48 Platformat për mësimin online] [Evidenca 102 Raport për metodat innovative] [RVB] [Shënimet e vizitave në UMT]</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Në RVB thuhet: <i>Angazhimi i Burimeve njerzore për realizimin e PS në UMT mbështetet në legjislacionin për arsimin e lartë</i>”.</p> <p>GVJ e gjen të vërtetë këtë pohim dhe, në takimin me personelin akademik, u informua që si ngarkesa e tyre në auditor ashtu edhe ajo jashtë auditorit janë optimale dhe u lejon atyre përmbushjen e të gjitha objektivave të PS “Bsc në Inxhinieri ndërtimi”</p> <p>[RVB] [Shënimet e vizitave në UMT] [Evidenca 57 Ngarkesa në auditor sipas formës së mësimdhënjes] [Tab 4 Ngarkesa totale e PA të programit në një vit akademik]</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

### Standardi IV.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>UMT vë në dispozicion të realizimit të aktivitetit mësimor, kërkimit shkencor dhe administrimit të tij dy godina me sipërfaqe respektive 2347 m<sup>2</sup> dhe 2490 m<sup>2</sup> (EV 91,108). Sipërfaqja e vënë në dispozicion të FIA (njësia kryesore) për PS Bsc në “Inxhinieri Ndërtimi” është 2754 m<sup>2</sup>. Ambiente të vëna në dispozicion shfrytëzohen si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Auditorë mësimi</li> <li>- Studio/Atelie</li> <li>- Ambiente për aktivitete promovuese</li> <li>- Laboratorë</li> <li>- Ambiente për kërkimin shkencor</li> <li>- Ambiente shërbimi si (bibliotekë, salla interneti, fotokopjime, salla studimi, zyra për informim të studentëve si dhe ambiente ndihmëse të tilla si koridoret, ballkonet banjot)</li> </ul> <p>Pyetjes për shfrytëzimin e kapaciteteve që ofron institucioni, grupi i NJSBC iu përgjigj që për PS “Bsc në “Inxhinieri Ndërtimi”” kapacitetet e ofruara përmbushin kërkesat ligjore dhe standardet e vendosura. Kjo është dëshmuar edhe në vlerësimet për akreditimin e institucionit.</p> <p>GVJ, gjatë vizitës në institucion, i vizitoi të gjitha këto ambiente dhe konstaton që ato janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike duke marrë në konsideratë numrin e studentëve, grupet mësimore dhe natyrën specifike të programit të studimit e moduleve përkatëse.</p>

	[Evidenca 91 FIA Ambjente per infrastrukture] [Evidenca 108 FIA Asetet Infrastrukturore akademike] [Evidenca 62 Numri i studentve te regjistruar per here te pare ne FIA ne 5 vite] [RVB] [Shënimet e vizitave në UMT]			
<b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Gjatë vizitës në UMT, GVJ vizitoi mjediset mësimore ku zhvillohej procesi për realizimin e PS “Bsc në Inxhinieri Ndërtimi” të tilla si: auditorët, laboratorët, studiot, ambientet e shërbimit etj dhe konstaton që ato janë të pajisura me mjete të tilla si kompjutera, software profesionale, aksesime në literaturë, mundësi shumëfishimi etj, të cilat garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.  [Evidenca 102 Raporti mbi metodat inovative në procesin e mësimdhënjes] [RVB] [Shënimet e vizitave në UMT]			
<b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Në RVB thuhet: <i>në të gjitha ambientet mësimore të institucionit ka paisje të tilla si projektues video, kompjutera, internet të cilat janë funksionale.</i>  Gjatë vizitës në UMT, GVJ konstatoi që të gjitha këto mjete (paisje) ishin në dispozicion të studentëve. Po kështu GVJ vizitoi edhe laboratorët e institucionit të vëna në dispozicion edhe të PS “Bsc në Inxhinieri Ndërtimi” si laborator i materialeve të ndërtimit, laborator i shkencave të natyrës, laborator i gjeoteknikës, laborator i informatikës dhe ai multifunksional, laborator i GIS dhe topografisë etj. Të gjithë këto laboratore ishin vendosur pajisjet dhe teknologjitë e nevojshme në shërbim të procesit të mësimdhënies dhe atij të kërkimit shkencor. Në laboratorin e gjeoteknikës, i cili në mënyrë specifike i shërbente PS Bachelor në “Inxhinieri Ndërtimi”, GVJ pa edhe aneksin CPT, i cili shërben për evidentimin e karakteristikave të truallit, në të cilin do të ndërtohet dhe, duke qenë i vetmi në Shqipëri, përdorej jo vetëm për aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit “Bsc në Inxhinieri Ndërtimi”, por edhe për programet e ciklit të dytë dhe studime për të tretët.  [DVV] [RVB] [Shënimet e vizitave në UMT]			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.	GVJ vizitoi ndër të tjerë edhe 3 laboratore të informatikës dhe atë multifunksional dhe konstatoi që ato ishin të pajisur me kompjutera të përshtatshëm dhe kishin të instaluar si programet standarte Microsoft ashtu edhe programe profesionale të lidhura me përdorimin e teknologjive bashkëkohore të fushës së ndërtimit.  [Evidenca 107 Ambientet për infrastrukturë të UMT] [Evidenca 108 FIA Asetet Infrastrukturore akademike] [RVB] [Shënimet e vizitave në UMT]			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	GVJ, mbështetur në RVB, EV 107 dhe vizitën në institucion konstaton që UMT, kryesisht me kapacitetet që zotëron (laboratore, studio) por edhe në bashkëpunim me institucione të tjera (kryerjen e praktikave mësimore, internshipet) garanton mjedise të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.[Evidenca 107 Ambientet për infrastrukturë të UMT] [Evidenca 108 FIA Asetet Infrastrukturore akademike] [RVB] [Shënimet e vizitave në UMT]			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

**Standardi IV.4**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ vizitoi bibliotekën e “Universitetit Metropolitan Tirana”, e cila ofronte kushte për akses të barabartë, e pa pagesë për të gjithë studentët. Biblioteka ishte e pajisur me PC, ku mundësohej përdorimi i literaturës në format elektronik pa kufizim nga studentët si dhe i programeve kompjuterike.</p> <p>Referuar RVB, Rregullores së UMT, rregullores së bibliotekës dhe takimeve të zhvilluara, rezulton se: <i>Biblioteka e UMT ofron shërbim falas për studentët, personelin mësimdhënës e administrativ, si dhe persona të tjerë, në përputhje me rregulloren e bibliotekës si me personel ashtu edhe online. Bazuar në rregulloren e UMT-së biblioteka shkencore e Universitetit është bibliotekë publike që mund të përdoret edhe nga lexues të tjerë. Ajo ka në fondin e saj tekste mësimore bazë si dhe libra e revista në gjuhën shqipe dhe të huaj.</i></p> <p>Biblioteka kryen dixhitalizimin e skedarëve si dhe shkëmben informacion me biblioteka të tjera akademike brenda e jashtë vendit.</p> <p>[Evidenca 107 Ambientet për infrastrukturë të UMT] [Evidenca 108 FIA Asetet Infrastrukturore akademike] [Evidenca 109 Relacion Biblioteke] [RVB] [Shënimet e vizitave në UMT]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka e UMT ka në dispozicion të studentëve të PS “Bsc në Inxhinieri Ndërtimi” tekste mësimore të hartuara nga pedagogët e tij si dhe nga pedagogët më me emer të universiteteve të tjera në vend. Në bibliotekë ka rreth 1250 tituj librash si dhe një numër të konsiderueshëm revistash shkencore. Po ashtu, edhe leksionet e shkruara zënë vend të konsiderueshëm për lëndët dhe kurrikulat e reja. Përpijekje paraprake janë bërë edhe për sigurimin e literaturës ndihmëse cilësore. Librat janë ‘de facto’ në dispozicion dhe numri i kopjeve është i mjaftueshëm, në raport me numrin e studentëve të regjistruar.</p> <p>Sidoqoftë, duke konsideruar që procesi i botimeve e publikimeve të rezultateve të studimeve e të kërkimit shkencor është një proces tejet dinamik dhe me prurje të madhe në literaturë, mbetet detyrë e vazhdueshme e institucionit pasurimi në vijimësi i fondit të bibliotekës.</p> <p>[Evidenca 109 Relacion Biblioteke] [RVB] [Shënimet e vizitave në UMT]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>“Universiteti Metropolitan Tirana” ofron aplikacionin “edu4school”. Nëpërmjet këtij aplikacionit studentit i mundësohet akses në leksione dhe materialet e ndryshme didaktike që janë në përputhje me syllabuset lëndore të Universitetit dhe tekste bashkëkohorë. Studentet konsultohen me leksionet në kohë reale. Ata kanë akses edhe në adresa online të cilat shfrytëzohen si biblioteka elektronike të tilla si:</p> <p><a href="http://www.thefreelibrary.com">www.thefreelibrary.com</a>  <a href="http://www.gutenberg.org">www.gutenberg.org</a></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr 219, Tiranë

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 46

	<a href="http://www.cobis.al">www.cobis.al</a> <a href="http://www.reatprint.com">www.reatprint.com</a> etj Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua që UMT është në përfundim të lidhjes së marrëveshjes me RASH për akses në bibliotekën online: <a href="https://ulibrary.rash.al">https://ulibrary.rash.al</a> [Evidenca 109 Relacion Biblioteke] [RVB] [Shënimet e vizitave në UMT]			
<b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Gjatë vizitës në bibliotekën e UMT, GVJ konstatoi që ajo ishte e paisur me programe kompjuterike që aksesonin të gjithë fondin e bibliotekës dhe mundësonin shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve. Evidenca 109 Relacion Biblioteke] [RVB] [Shënimet e vizitave në UMT]			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.  <b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Nga akreditimi i mëparshëm institucionit i rekomandohet të pasurojë bibliotekën me tituj të literaturës bazë dhe ndihmëse. Në përmbushje të këtij rekomandimi GVJ informohet që ai është përmbushur plotësisht pasi është sjellë e gjithë literature bazë dhe ndihmëse e programuar në syllabuset e lëndëve. Po kështu GVJ konstaton që UMT planifikon shtimin e zërave të literaturës në bibliotekë dhe përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të PS, duke bashkëpunuar ngushtësisht me personelin akademik në plotësim të nevojave dhe rekomandimeve të tij.  Në RVB dhe në EV 109 si dhe gjatë vizitës në bibliotekën e UMT, GVJ konstaton që biblioteka u vihet në dispozicion studentëve në orët 08.30 deri në 20.30 (nga e hëna deri të premten) dhe nga ora 09.00 deri në orën 13.00. Nga pyetjet që iu drejtuan studentëve në takimin me ta, GVJ mësoi që ata ishin të kënaqur me shërbimin e bibliotekës.  [Evidenca 109 Relacion Biblioteke] [RVB] [Shënimet e në UMT]			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi IV.5

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Nga dokumentacioni i DVV, takimet me stafin akademik, studentët, stafin administrativ, GVJ konstaton se Universiteti Metropolitan Tirana, përdor dhe zhvillon vazhdimisht sistemet e informimit. UMT dispon sistemin e tij funksional <i>edu4schools</i> , të përshtatur me të gjitha elemnetet e specifikat që ka UMT dhe programet që ofron.  GVJ hyri në këtë sistem dhe u njoh konkretisht me disa nga rubrikat e tij.  Gjithashtu referuar RVB dhe takimeve të zhvilluara, GVJ mësoi që UMT është pjesë e Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH) dhe QSHA. Nëpërmjet platformave që ofrojnë këto struktura realizohet procesi i aplikimit dhe regjistrimit on-line të kandidatëve (maturantëve U-Albania) në programet e UMT-së, si dhe matrikullimi i studentëve bazuar në të dhënat e detajuara të përcjella nga UMT-

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr 219, Tiranë



E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 47

	<p>ja. Gjithashtu, UMT përdor shërbimet e “ASCAL Management System” (AMS) nëpërmjet të cilit administrohen dhe menaxhohen të gjitha informacionet elektronike që lidhet me të dhënat e institucionit, strukturën akademike, kualifikimet dhe të dhëna të tjera të cilat përditësohen në kohë reale.</p> <p>Institucioni, menaxhon një cikël të plotë të një studenti: regjistrimin, vlerësimet e studentit deri në diplomim, transferimin e studimeve të studentit, pagesat etj, në format hard copy dhe elektronik (<i>nëpërmjet sistemit edu4schools etj</i>).</p> <p>[Evidenca 43 Sistemi informatik i menaxhimit të studentëve] [Evidenca 44 Manual përdorimi të sistemit informatik të studentve] [Evidenca 45 Ndërfaqja, administratori, pedagogu, sekretaria, student] [RVB] [Shënimet e vizitave në UMT]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Faqja zyrtare e UMT, pasqyron veprimtarinë administrative, institucionale, akademike, kulturore e sociale, jep informacion lidhur me dokumentet rregullative të institucionit, vendime të Senatit Akademik (miratim kriteresh, kuota, afate aplikimi, regjistrimi të studentëve etj.), ciklet dhe programet e studimit, organigrama, njoftime/thirrje për projekte etj. Në faqen e UMT, informacionet që lidhen me programin e studimit, planin mësimor, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, janë në dy gjuhë: gjuhë shqipe dhe angleze</p> <p>Rrjetet sociale janë një tjetër mënyrë komunikimi që përdor institucioni.</p> <p>Komunikimi i brendshëm kryhej edhe nëpërmjet postës elektronike me domain të institucionit ..... @umt.edu.al me të cilin është pajisur i gjithë personeli akademik, ndihmësakademik, personelit administrativ, si dhe studentët (RVB, protokollit takimeve në institucion). GVJ e testoi funksionimin e sistemit të brendshëm të menaxhimit të informacionit dhe e gjeti atë funksional.</p> <p>Evidenca 43 Sistemi informatik i menaxhimit të studentëve] [Evidenca 44 Manual përdorimi të sistemit informatik të studentve] [Evidenca 45 Ndërfaqja, administratori, pedagogu, sekretaria, student] [Faqja zyrtare e UMT (<a href="https://umt.edu.al/">https://umt.edu.al/</a>)] [RVB] [Shënimet e vizitave në UMT]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p> <p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të</p>	<p>Të gjitha metodat e përdorura të ruajtjes dhe shkëmbimit të informacionit administrohen nga personi përgjegjës i sektorit të teknologjisë dhe informacionit në nivel rektorati si dhe nga drejtoria e komunikimit, të cilët janë njëkohësisht përgjegjës për sigurinë e informacionit dhe ruajtjen e tij.</p> <p>Në UMT ka rrjet të brendshëm të lidhur me internet për stafin akademik, sekretarinë mësimore dhe studentët.</p> <p>Institucioni ka siguruar për punonjësit akademikë dhe jo akademikë infrastrukturën e nevojshme për përmbushjen e detyrave të tij, si pajisje kompjuterike dhe shërbime interneti, pajisje të tjera të rëndësishme si printer, fotokopje, skaner, etj.</p> <p>GVJ konstaton që sistemi edu4schools përmbush kërkesat për komunikim interaktiv dhe shkëmbim të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve. Po ashtu rrjeti i brendshëm (Intranet) që lidh me internet stafin akademik, sekretarinë mësimore dhe studentët (EV 45) është një rrjet shumë i dobishëm për shkëmbime edhe konfidenciale, të nevojshme për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe administrativ.</p>



<p>dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>UMT perdor platformen GoToMeeting, platforme e cila eshte siguruar nepermjet abonimit te Institucionit ne kompanine qe e tregon.</p> <p>Kjo platformë mundëson komunikimin interaktiv dhe shkëmbimin e informacionit midis stafit dhe studentëve kryesisht ne mesimdhënie online.</p> <p>Si sistemi edu4scholls, sistemi intranet, domain: .... @umt.edu.al, ashtu edhe rrjetet sociale të cilat kontribuojnë në menaxhimin e informacionit në UMT garantojnë monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundësojnë raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p> <p>[Evidenca 43 Sistemi informatik i menaxhimit të studentëve] [Evidenca 44 Manual përdorimi të sistemit informatik të studentve] [Evidenca 45 Ndërfaqja, administratori, pedagogu, sekretaria, studenti] [RVB] Shënimet e vizitave në UMT]</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>GVJ konsultoi faqen zyrtare ta UMT, ku afishohen të gjitha informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme dhe konstatoi që ato publikohen në dy gjuhë: shqip dhe anglisht.</p> <p>Faqja Zyrtare (<a href="https://umt.edu.al/">https://umt.edu.al/</a>)</p>			
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përbushet</b></p>	<p><b>Përbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

#### Standardi IV.6

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>UMT planifikon fonde të mjaftueshme për programin e studimit “Bch në Inxhinieri Ndërtimi”, ku parashikohet mbështetja financiare e nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi (3 vjet). UMT harton raportin financiar të përvitshëm.</p> <p>Burimet e financimit të UMT janë: fondet dhe kontributet e themeluesve, të ardhurat nga tarifa e shkollimit që paguan çdo student në bazë të tarifave të miratuara, të ardhurat nga projektet e fituara në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe të ardhurat nga shërbime për të tretë të ofruara nga UMT.</p> <p>Referuar RVB, veprimtaria ekonomike e UMT pasqyrohet në dokumentacionin financiar të detyruar për t’u plotësuar dhe dorëzuar në organet e tatim-taksave sipas legjislacionit financiar në fuqi.</p> <p>Administratori i UMT përgjigjet për realizimin e planit financiar dhe raporton në Bordin e Lartë Drejtues për veprimtarinë ekonomike-financiare.</p> <p>[Evidenca 118 Shpenzimet dhe te ardhurta FIA ne 3 vitet e fundit tabela] [Evidenca 128 Buxheti i UMT_FIA] [Evidenca 129 Auditimi financiar] [RVB] [Shënimet e vizitave në UMT]</p>

<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Në RVB thuhet: Plan i financimit të PS “Bch në Inxhinieri Ndërtimi” përmban financimin e burimeve njerzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit. GVJ konsultoi dokumentacionin shoqërues (EV 118,128), u interesua të dijë situatën lidhur me pagesat e personelit, masën e financimit të kërkimit shkecor, gjendjen dhe paisjet në infrastrukturë. Ai gjithashtu u interesua të dijë procedurën për hartimin e projekt buxhetit. Në përfundim GVJ konstatoi që ky kriter plotësohet.</p> <p>[Evidenca 118 Shpenzimet dhe te ardhurta FIA ne 3 vitet e fundit tabela] [Evidenca 128 Buxheti i UMT_FIA] [RVB] [Shënimet e vizitave në UMT]</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Në EV 129 është paraqitur “Raport i Audituesit të pavarur mbi pasqyrat financiare të shoqërisë për periudhën ushtrimore 1 janar 2020 deri më 31.12.2020”. Në këtë dokument përmbahet një pasqyrë e hollësishme financiare e të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët dhe ndarjen e këtyre burimeve.</p> <p>[Evidenca 129 Auditimi financiar] [RVB] [Shënimet e vizitave në UMT]</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Lidhur me dokumentacionin e raporteve financiare për tri vitet e fundit, GVJ konsultoi EV 118 dhe, gjatë vizitës në UMT, u interesua për procedurën e monitorimit të aktivitetit dhe treguesve financiarë. Ai mësoi që Bordit të Administrimit të UMT (BA) i raportohet periodikisht nga zyra e financës mbi menaxhimin financiar.</p> <p>UMT bën një analizë të përgjithshme të kostove ku përfshihen shpenzimet për mësimdhënie, pagat e stafit mbështetës administrativ, pagesat për qeranë, energjinë elektrike, telefonat, internetin, për paisjet si kompjutera, IT, paisje laboratike, blerja e licencave për programet kompjuterike, tarifat e akreditimit, bibliotekën elektronike etj dhe, mbi këtë bazë, planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p> <p>[Evidenca 128 Buxheti i UMT_FIA] [RVB] [Shënimet e vizitave në UMT]</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>Mbështetur në analizën e kostove si më sipër, UMT bën bilancin e të ardhurave dhe shpenzimeve. Ky bilanc bëhet për çdo PS. Më tej, në funksion të nevojave dhe prioriteteve bëhet planifikimi i blerjeve dhe kryerja e tyre. GVJ u interesua lidhur me gjendjen financiare duke u referuar edhe tek asetet disponuese dhe konstaton plotësimin e këtij kriteri.</p> <p>Evidenca 128 Buxheti i UMT_FIA] [Evidenca 108 FIA Asetet Infrastrukturore akademike] [RVB] [Shënimet e vizitave në UMT]</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>UMT është përgjegjëse për përcaktimin e kuotave dhe kriterëve përzgjedhëse në të gjitha programet e studimit që ofron dhe, për këtë qëllim, ka hartuar dhe zbaton një sërë aktesh rregullatore (EV 1-3). Në këtë kuadër, pranimi i studentëve për çdo vit akademik kryhet në përputhje me kuotat dhe kriteret e propozuara dhe të miratuara për çdo program studimi, të cilat bëhen publike në faqen zyrtare të institucionit <a href="https://umt.edu.al/">https://umt.edu.al/</a>.</p> <p>Kriteret specifike të pranimit dhe numri i kuotave në programin e studimit “Bsc në Inxhinieri Ndërtimi” propozohen nga Departamenti Inxhinierisë së Ndërtimit dhe miratohen nga Dekanati i FIA. Në planifikimin e kuotave të pranimit për vit akademik, merren në konsideratë kapacitetet akademike dhe infrastrukturore të UMT. Pas miratimit të tyre në Senatën akademik të UMT-së, përcillen për certifikim nga MASR. (EV 30, 31, 34, 35, 36)</p> <p>I gjithë informacioni i mësipërm, bëhet publik në faqen zyrtare të UMT (EV 36) dhe në rrjetet sociale të universitetit, veçanërisht kriteret dhe kërkesat e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit, si dhe kuotat e pranimit për çdo program studimi. Universiteti nëpërmjet politikave dhe procedurave që ndjek, garanton barazinë dhe të drejtën për të gjithë kandidatët për studentë. Prej vitesh UMT, nëpërmjet komisioneve <i>ad-hoc</i> të përbëra me përfaqësues nga çdo fakultet dhe sistemeve informatike që përdor, ka zhvilluar procedura të drejta të përzgjedhjes së studentëve që regjistrohen në ciklin e parë të studimeve dhe në ciklin e dytë.</p> <p>Regjistrimi i studentëve, ecuria përgjatë programit të studimit, mundësitë e transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesëshme, vlerësimi i dijeve dhe procedura e diplomimit janë të sanksionuara në aktet rregullatorë, procedura të miratuara e të bëra publike.</p> <p>Institucioni kujdeset që nga regjistrimi i studentëve dhe pajisja e tyre me numër matrikullimi, krijimi i dosjes së plotë të studentit dhe deri në dalje duke u kujdesur për diplomimin dhe suplementin e diplomës.</p> <p>GVJ kërkoi disa dosje studentësh (random) dhe konstatoi se ishin në përputhje me kërkesat ligjore.</p> <p>Evidenca 1 UMT Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana   Evidenca 2 UMT Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana   Evidenca 3 Plani strategjik i</p>




	<p>zhvillimit të UMT] [Evidenca 30 Procedurat e aplikimit, rregjistrimit dhe transferimit] [Evidenca 31 Vendim i rektoratit për ngritjen e komisionit për pranimin e kandidatëve në ciklin e parë dhe të integruar v. 2020-21] [Evidenca 34 Raport i MASR mbi certifikimin e kuotave të pranimit në UMT] [Evidenca 35 Proces verbal i Komisionit të Pranimit të Maturantëve me përllagaritjen e pikëve dhe rankimin e kandidatëve] [Evidenca 36 Publikimi në web-in e UMT të gjithë njoftimeve] [<a href="https://umt.edu.al/">https://umt.edu.al/</a>] [RVB] [Shënimet e vizitave në UMT]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konsultoi dokumentacionin e administrimit, procedurat, rregulloret etj, të cilat janë të publikuara në faqen zyrtare të universitetit. Ai u informua që studentët, personalisht ose nëpërmjet qeverisë studentore, mund të gjejnë informacionin e duhur në fakultet, departamente dhe në çdo strukturë përgjegjëse për mbarëvajtjen e procesit mësimor. Ai mësoi që, në përputhje me aktet rregullative në fuqi, institucioni e kryen në disa drejtime informimin sa më të gjerë në lidhje me programin e studimit dhe kriteret e veçanta për tu pranuar dhe, në bashkëpunim me Fakultetet e UMT, me KS dhe zyrën e karrierës organizojnë aktivitete informuese për kandidatët apo familjarë të tyre në mjediset e UMT. Në këto aktivitete bëhen prezantime rreth organizimit të studimeve, të drejtave dhe detyrimeve të studentëve, informacione mbi kontaktet e nevojshme, njohjen me të gjitha ambientet fizike të fakultetit apo të universitetit. Guida e studentit është material që ka informacionin e nevojshëm që duhet të ketë studenti në fillim të vitit akademik, veçanërisht informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, infrastrukturën laboratorike dhe shërbimet e tjera që përfitojnë studentët në FIA.</p> <p>[Evidenca 79 Guida e studentit] [Evidenca 78 Aktivitetet e Zyrë së Karrierës] [Evidenca 12: Aktet për përfshirjen e studentëve në organet kolegjiale të UMT] [Evidenca 80 Shembull_Java eorientimit_FIA] [Evidenca 104_Aktivitetet të kryera nga studentët_keshilli studentor] [Evidenca 105 Rregullore e Këshillit Studentor UMT] [RVB] [Shënimet e vizitave në UMT] [<a href="https://umt.edu.al/">https://umt.edu.al/</a>]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Nga dokumentacioni i ofruar si dhe nga takimi me studentët, GVJ mësoi që ata i njihnin dhe njëkohësisht për ta ishin të aksesueshme kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit. Në këtë kuadër organizoheshin aktivitete të tilla si: Dita e informimit, Panairi i Punës, Për një ditë student në UMT si dhe çdo student paisëj me “Guidën e studentit”.</p> <p>Nga konsultimi i faqes zyrtare të UMT del që ato janë të aksesueshme edhe nga publiku.</p> <p>[Evidenca 30 Procedurat e aplikimit, rregjistrimit dhe transferimit] [Evidenca 87 Dosje studenti të rregjistruar Shembull] [Evidenca 36 Publikimi në web-in e UMT të gjithë njoftimeve] [RVB] [Shënimet e vizitave në UMT] [<a href="https://umt.edu.al/">https://umt.edu.al/</a>]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Gjatë vizitës në UMT, GVJ konsultoi dokumentacionin lidhur me kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve dhe konstatoi që kriteri bazë është ai i notës mesatare. Ky kriter për studentët e PS “Bch në Inxhinieri Ndërtimi” varej nga oferta vjetore, kapacitetet institucionale. GVJ mesoi gjithashtu se nga akreditimi i mëparshëm i këtij PS ishte dhënë rekomandimi për parashikimin e politikave për rritjen e cilesisë në hyrje</p>

	<p>per kete PS. Ne tabelen e paraqitur tek RVB (faqe 5) del qe cilesia ne hyrje ka ardhur duke u permiresuar nga viti 2017 deri ne vitin 2021.</p> <p>[Evidenca 62 Numri i studentëve të rregjistruar pë herë të parë në FIA në 5 vite] [RVB] [Shënimet e vizitave në UMT]</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Institucioni përcakton procedurat e aplikimit të shtetasve të huaj që dëshirojnë të jenë pjesë e UMT-së, si dhe kuotat përkatëse. Në lidhje me kriteret e përzgjedhjes së studentëve të huaj janë të njëjta si studentët shqiptarë por deri tani nuk është aplikuar ndonjë procedurë rekrutimi e studentëve të huaj. Aktualisht programi i studimit ofrohet në gjuhën shqipe.</p> <p>Krahas programit të bursave për kategori të ndryshme, për studentët aktivë ofrohen internshipe dhe punësim pranë institucionit ose partnerëve të tij. Veprimtaria jashtë shkollore në kontribut për institucionin ju vlerësohet studentëve orë pune, duke ju reduktuar tarifën e studimit.</p> <p>Institucioni ka krijuar një inkubator in Campus, i cili operon prej 3 vitesh, duke inkubuar idetë e studentëve dhe duke ofruar trajnime dhe ekspertizë nëpërmjet organizimeve të bootcampeve.</p> <p>[RVB] [Shënimet e vizitave në UMT]</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Në faqen zyrtare të institucionit <a href="https://umt.edu.al/">https://umt.edu.al/</a>, përpara fillimit të çdo viti akademik, UMT udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat dhe kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit “Bch në Inxhinieri Ndërtimi”. Po kështu këtij qëllimi i shërbejnë edhe aktivitetet e posaçme të cituara më lart si dhe informacionet e posaçme që japin Zyra e Këshillimit të Karrierës, ajo e Shërbimit ndaj Studentit etj.</p> <p>Evidenca 30 Procedurat e aplikimit, rregjistrimit dhe transferimit] [Evidenca 87 Dosje studenti të rregjistruar Shembull] [Evidenca 80 Shembull_Java e orientimit_FIA] Evidenca 36 Publikimi në web-in e UMT të gjithë njoftimeve] [RVB] Shënimet e vizitave në UMT] [<a href="https://umt.edu.al/">https://umt.edu.al/</a>]</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

## Standardi V.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Sa i përket informacionit që vë në dispozicion UMT për kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin, GVJ konstatoi që këto informacione i vihen në dispozicion studentit nëpërmjet publikimit të vendimeve specifike në faqen zyrtare të institucionit dhe nëpërmjet akteve normative institucionale (EV 1-2, 50, 79). Rol të rëndësishëm luajnë edhe këshillat studentorë, shënimet që mbahen nga stafi akademik, stafi ndihmës akademik, sekretaria mësimore si dhe sistemi edu4schools. Përdorimi i të gjitha këtyre burimeve dhe shfrytëzimi i të gjitha këtyre mundësive bën që informacioni mbi kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve të jetë i plotë dhe i hollësishëm.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr 219, Tiranë



E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 53


	[Evidenca 1 UMT Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana] [Evidenca 2 UMT Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana] [Evidenca 50 Rregullore e FIA] [Evidenca 79 Guida e studentit] [RVB Shënimet e vizitave në UMT]			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	<p>Dosjet personale të studentit ruhen e menaxhohen nga sekretaria mësimore. Në këto dosje gjenden informacione mbi adresat, e-maillet dhe numrat e telefonit të studentëve të UMT-së, që janë të përfshirë në formë elektronike në databazat e secilit fakultet. Pjesë e sistemit të informimit janë edhe kriteret dhe procedura e transferimeve drejt programeve të studimit që ofron FIA/UMT. Ky proces bazohet në aktet e nxjerra nga MASR si dhe nga procedurat e brendshme të UMT.</p> <p>Ne dosjet e studenteve ruhen kualifikimet e mehershme apo studimet e pjesshme.</p> <p>[Evidenca 1 UMT Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana] [Evidenca 2 UMT Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana] [Evidenca 30 Procedurat e aplikimit, rregjistrimit dhe transferimit] [Evidenca 50 Rregullore e FIA] [Evidenca 79 Guida e studentit] [RVB]</p>			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	<p>GVJ konstaton që sistemi i menaxhimit edu4schools funksionon për t'u dhënë studentëve saktë dhe në kohë të gjitha informacionet lidhur me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p> <p>Mundësi të tjera jepen nga përdorimi i faqes zyrtare të UMT, komunikimet zyrtare në domain-in @umt.edu.al, interesimit të drejtë përdrejtë të studentëve në Sekretarinë Mësimore, Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe asaj të Mbështetjes së Studentëve etj.</p> <p>[Evidenca 1 UMT Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana] [Evidenca 2 UMT Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana] [Evidenca 43 Sistemi informatik i menaxhimit të studentëve] [Evidenca 44 Manual përdorimi të sistemit informatik të studentve] [Evidenca 45 Ndërfaqja, administratori, pedagogu, sekretaria, studentit] [Evidenca 79 Guida e studentit] [RVB] [Shënimet e vizitave në UMT]</p>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	<p>Gjatë vizitës në UMT, në takimet me studentët dhe personelin akademik GVJ mësoi se Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit jep informacione lidhur me mënyrën e punimit të tezës së diplomës si për formatin e shkrimit ashtu edhe për organizimin e përgjithshëm të saj. Në mbështetje të këtij procesi japin informacione edhe dekanati i FIA, po ashtu edhe Zyra e Këshillimit të Karrierës.</p> <p>Në përfundimin e studimeve në “Bachelor Inxhinieri Ndërtimi”, kriteri i notës mesatare mbi 8 i klasifikon studentët në ata që bëjnë tezë diplome dhe na ata që i nënshtrohen një provimi të përgjithshëm.</p> <p>[Evidenca 64 Procedura e përgaditjes dhe mbrojtjes së diplomës] [RVB] [Shënimet e vizitave në UMT]</p>			
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	<p>Për plotësimin e këtij kriteri UMT organizon aktivitete të tilla si “Dita e Informimit”, “Për një ditë student në UMT”, “Panairi i punës”, boton dhe shpërndan “Guidën e studentit” si dhe informon nëpërmjet faqes zyrtare të UMT-së <a href="https://umt.edu.al/">https://umt.edu.al/</a>.</p> <p>[Evidenca 36 Publikimi në web-in e UMT të gjithë njoftimeve] [Evidenca 79 Guida e studentit] [RVB] [Shënimet e vizitave në UMT]</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

**Standardi V.3**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve “Bch në Inxhinieri Ndërtimi” studenti informohet nëpërmjet gjithë sistemit të menaxhimit të procesit që ka krijuar institucioni si: platforma edu4schools, faqja zyrtare <a href="https://umt.edu.al/">https://umt.edu.al/</a>, komunikimi në domain-in @umt.edu.al, kontaktet e drejtpërdrejta me “Sekretarine Mësimore”, Zyrën e Këshillimit ta Karrierës”, Zyrën e Mbështetjes së Studentëve”, koordinatori i departamentit etj. Nga të gjitha këto burime ai njihet me kohëzgjatjen e studimeve në “Bch Inxhinieri Ndërtimi” (3 vjet), ngarkesën në kredite vjetore (60 ECTS), Kurrikulën (EV 54), syllabuset (EV 56).</p> <p>Evidenca 36 Publikimi në web-in e UMT të gjithë njoftimeve   Evidenca 54 Plani mësimor   Evidenca 56 Plan programet (syllabuset) e lëndëve   RVB   Shënimet e vizitave në UMT   <a href="https://umt.edu.al/">https://umt.edu.al/</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese, studentët e programit të studimeve “Bsc në Inxhinieri Ndërtimi” informohen nëpërmjet gjithë sistemit të menaxhimit të procesit që ka krijuar institucioni si: platforma edu4schools, faqja zyrtare <a href="https://umt.edu.al/">https://umt.edu.al/</a>, komunikimi në domain-in @umt.edu.al, kontaktet e drejtpërdrejta me “Sekretarine Mësimore”, Zyrën e Këshillimit ta Karrierës”, Zyrën e Mbështetjes së Studentëve”, koordinatori i departamentit etj. Nga të gjitha këto burime ai informohet që në PS “Bch Inxhinieri Ndërtimi” zhvillohen 30 lëndë/module gjatë gjithë kohëzgjatjes, duke përfshirë këtu edhe praktikën si dhe tezën e diplomës. Po ashtu ai informohet se PS ofron edhe 5 lëndë me zgjedhje, tipologjia C. Tek përmbajtja e çdo syllabusi ai informohet mbi tipologjinë, llojin dhe kodin e lëndës. Po ashtu atij i jepet emri i titullarit të lëndës dhe adresa elektronike e tij. Më tej i bëhet i njohur kodi i etikës dhe objektivat e të nxënit duke vazhduar me temat që do zhvillohen dhe format e kontrollit të dijës. Në fund ai informohet për literaturën bazë dhe atë të rekomanduar.</p> <p>Evidenca 14 Rregullore e etikës UMT   Evidenca 54 Plani mësimor   Evidenca 56 Plan programet (syllabuset) e lëndëve   RVB   Shënimet e vizitave në UMT   <a href="https://umt.edu.al/">https://umt.edu.al/</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Mbi mundësitë e punësimit si dhe mbështetjen që jep institucioni për orientimin drejt dhe në tregun e punës, studenti informohet po ashtu nëpërmjet gjithë sistemit të menaxhimit të procesit që ka krijuar institucioni si: platforma edu4schools, faqja zyrtare <a href="https://umt.edu.al/">https://umt.edu.al/</a>, komunikimi në domain-in @umt.edu.al, kontaktet e drejtpërdrejta me “Sekretarine Mësimore”, Zyrën e Këshillimit ta Karrierës”, Zyrën e Mbështetjes së Studentëve”, Zyrën Alumni, koordinatori i departamentit etj. Rol të veçantë në këtë drejtim marrin Zyra e Këshillimit ta Karrierës”, Zyra e Mbështetjes së Studentëve” dhe Zyra Alumni. Në takimin me studentët GVJ mësoi se prej këtyre zyrave marrin shërbimin e duhur. Po kështu në takimin me përfaqësues të tregut të punës dhe të diplomuarit në këtë PS, GVJ u njoh me ofertën e tyre për të ndihmuar sa më shumë në punësimin e kontigjenteve që mbarojnë PS “Bsc në Inxhinieri Ndërtimi” dhe</p>




	kontributin që japin ata në sigurimin e Internship-eve. Këta të fundit na informuan gjithashtu se institucioni mban lidhje të vazhdueshme me ta.  [Evidenca 43 Sistemi informatik i menaxhimit të studentëve] [Evidenca 44 Manual përdorimi të sistemit informatik të studentve] [Evidenca 82 Rrjeti Alumni] [RVB] [Shënimet e vizitave në UMT] [https://umt.edu.al/]			
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Nëpërmjet gjithë sistemit të menaxhimit në UMT studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Gjatë takimit me studentët ata pohuan disponimin e këtij informacioni dhe lehtësitë e aksesimit në të.  [Evidenca 43 Sistemi informatik i menaxhimit të studentëve] [Evidenca 44 Manual përdorimi të sistemit informatik të studentve] [Evidenca 82 Rrjeti Alumni] [RVB] [Shënimet e vizitave në UMT] [https://umt.edu.al/]			
<b>Kriteri 5</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.	GVJ konstatoi që në UMT sistemi i informacionit të brendshëm funksionin mirë në të gjitha format e organizimit të tij, kryesisht në platformën edu4schools, faqen zyrtare <a href="https://umt.edu.al/">https://umt.edu.al/</a> , komunikimin në domain-in @umt.edu.al, platformën e mësimit online GoToMeeting. Në të gjitha këto forma menaxhimi informacioni është lehtësisht i arritshëm dhe shterues.  [Evidenca 43 Sistemi informatik i menaxhimit të studentëve] [Evidenca 44 Manual përdorimi të sistemit informatik të studentve] [Evidenca 48 UMT Platforma për mësimin online] [Evidenca 49 UMT Udhëzimi mbi mësimdhënien në distancë] [RVB] [Shënimet e vizitave në UMT] [https://umt.edu.al/]			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X


#### Standardi V.4

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.	Institucioni administron, ruan dhe arkivon çdo dokument dhe informacion zyrtar që lidhet me aktivitetin e vet. Në këtë kuadër, për ruajtjen e dokumentacionit në letër dhe në formë elektronike në nivel institucioni ka një Zyrë të Protokoll-Arkivës, e cila është përgjegjëse për ruajtjen dhe dokumentimin e dokumentacionit zyrtar në përputhje me Ligjin e Arkivave Nr.9154, datë 6.11.2003 dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi. Arkivimi i dokumentacionit (materialet shkresore, akademike apo financiare) ruhen në dosje të veçanta të ndara në vite
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Në UMT arkiva themelore përbëhet nga dokumentacioni i plotë i dosjeve me të dhënat e studentëve që nga momenti i regjistrimit deri te diplomimi i tyre, i cili ruhet në formë të printuar, elektronike ose edhe në regjistra të plotësuar me dorë në zyrën e sekretarive mësimore
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve	



<p>gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Sekretaret dhe arkivistët mbajnë regjistrin themeltar për çdo program studimi, regjistrin e diplomave të lëshuara, dosje personale të studentëve, dokumentacion të procedurave të transferimit apo çregjistrimit, procesverbale të provimeve, urdhra, udhëzime të ministrisë apo të organeve drejtuese të universitetit, botime dhe procedura publikimi, bazë të dhënash në lidhje me aktivitetet e organizuara etj</p>																				
<p><b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Në regjistrë hidhen të gjitha të dhënat në lidhje me progresin akademik të studentëve, që nga pranimi deri në diplomim, ata që janë larguar apo që përsërisin vitin. Të dhënat për periudhën 6 vjecare, nga akreditimi i mëparshëm janë si më poshtë:</p>																				
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<table border="1" data-bbox="651 506 1342 719"> <thead> <tr> <th>Numri i studentëve të regjistruar</th> <th>Per here të parë</th> <th>Studente të transferuar në vitet ndërmjetëse</th> <th>Nota mesatare</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2017-2018</td> <td>14</td> <td>44</td> <td>7.45</td> </tr> <tr> <td>2018 -2019</td> <td>13</td> <td>28</td> <td>7.49</td> </tr> <tr> <td>2019-2020</td> <td>11</td> <td>25</td> <td>7.91</td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td>13</td> <td>-</td> <td>8.53</td> </tr> </tbody> </table>	Numri i studentëve të regjistruar	Per here të parë	Studente të transferuar në vitet ndërmjetëse	Nota mesatare	2017-2018	14	44	7.45	2018 -2019	13	28	7.49	2019-2020	11	25	7.91	2020-2021	13	-	8.53
Numri i studentëve të regjistruar	Per here të parë	Studente të transferuar në vitet ndërmjetëse	Nota mesatare																		
2017-2018	14	44	7.45																		
2018 -2019	13	28	7.49																		
2019-2020	11	25	7.91																		
2020-2021	13	-	8.53																		
	<p>FIA ka arkivën e vet. Pjesë e arkivës është dokumentacioni që lidhet me rregulloret e programeve të studimit, ngarkesën mësimore të pedagogëve, marrëveshjet vjetore të stafit akademik, dokumentacion provimesh, punime diplomash të studentëve, të dhëna të aktivitetit shkencor, raporte analize dhe çdo dokumentacion që gjykohet i rëndësishëm në dokumentimin dhe sigurimin e cilësisë së veprimtarisë akademike të njësisë. Pjesë e dokumentacionit janë po ashtu dhe dosjet e stafit akademik, kualifikimet e tyre në vite, aktiviteti shkencor si dhe vlerësimet periodike të performancës.</p> <p>Në bazë të akteve normative, studentët kanë të drejtën e tërheqjes së dosjes individuale, por duke lënë në arkivë një kopje të saj, të siguar nga personi dhe arkiva. Bazuar në LAL 80/2015, UMT ruan kopje elektronike të dokumentacionit zyrtar. Sistemi i menaxhimit edu4schools i cili është aktualisht në përdorim në UMT/FIA, mundëson shërbime të cilat janë në implementim e sipër.</p> <p>Nëpërmjet sistemit, FIA disponon të dhënat e personelit akademik dhe studentëve të cilat përditësohen nga profili individual i përdoruesit. Ndërkohë, sekretaria mësimore dhe administratori i sistemit në UMT, kanë të drejtën e gjenerimit të statistikave vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e integruar të studimit, transferimet, largimet dhe të diplomuarit në çdo vit akademik. Të dhënat e gjeneruara përdoren për analiza të ndryshme të institucionit, analizën vjetore dhe publikime. (Evidenca.73, Raport vjetor i aktiviteti mësimor, kërkimor dhe financiar 2018-2019)</p> <p>Sistemi mundëson ndjekjen e ecurisë së studentëve pasi në të regjistrohen notat e marra në të gjitha lëndët/modulet, frekuentimi dhe shlyerja e detyrimeve të paracaktuara në çdo lëndë/modul.</p> <p>Proceset e ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave personale të studentëve realizohen bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe rregulloren e universitetit dhe të arkivës. Informacioni në lidhje me studentët ruhet në databazën e sistemit të brendshëm. Ky informacion është konfidencial dhe</p>																				




	<p>mund të aksesohet vetëm përmes një kërkesë me shkrim apo zotërimit të një llogarie nga studenti, për të dhënat e tij për sa kohë studenti është i regjistruar. Ky i fundit përmes llogarisë personale mund të shikojë vetëm ecurinë e tij në sistem dhe të marrë të dhëna për këtë. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit nga sekretaria mësimore dhe çdo veprim mbi to është lehtësisht i verifikueshëm nga personat e autorizuar. Sistemi regjistron automatikisht çdo editim, ndërhyrje, kohën e ndryshimit dhe llogarinë nga ka ardhur ndryshimi. Për dokumente zyrtare, si procesverbale notash, vërtetime, ato gjenerohen vetëm nga persona të autorizuar dhe në një periudhë të caktuar kohe. Më pas këto dokumente janë unike dhe të patjetërsueshme.</p> <p>Aksesi në sistemin edu4schools të UMT është i autorizuar dhe i monitoruar. Çdo informacion në sistem konsiderohet i klasifikuar dhe çdo ndërhyrje në të për qëllime të tjera përveç atyre të përcaktuara në profilin e çdo përdoruesi, dënohen sipas përcaktimeve ligjore.</p> <p>[Evidenca 1 UMT Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana] [Evidenca 2 UMT Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana] [Evidenca 87 Shembull dosje studenti te regjistruar] [Evidenca 95 Rregullore e Sekretarisë] [Evidenca 114 Rregullore e arkivës] [Evidenca 43 Sistemi informatik i menaxhimit të studentëve] [Evidenca 44 Manual përdorimi të sistemit informatik të studentve] [Evidenca 73 Raporti i aktivitetit mësimor, kërkimor e financiar] [Dosja e vetëvlersimit] [RVB] [Shënimet e vizitave në UMT] [<a href="https://umt.edu.al/">https://umt.edu.al/</a>]</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi V.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Përfaqësimi i studentëve në nivelet e vendimmarrjes dhe administrimit të UMT, është garantuar në Statut dhe aktet rregullatorë të institucionit dhe fakulteteve. Studentët përfaqësohen në organet kolegjiale të universitetit, siç janë Senati Akademik, në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, në Dekanatin e FIA, në komisionet ad-hoc të ngritura në kuadër të vlerësimeve dhe analizave në nivel institucional dhe programi duke u nxitur të marrin pjesë në jetën universitare dhe duke integruar sugjerimet e tyre në veprimtarinë e përditshme të institucionit.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Këshilli studentor i UMT (KS UMT) është organ kolegjial, përfaqësuesit e të cilit janë të zgjedhur nga vetë studentët. Në këtë kuadër, komunikimi institucional me këto organe është një mënyrë e drejtpërdrejtë për të marrë në rrugë të shpejtë mendimin dhe zërin e studentëve. Këshilli Studentor ka rregulloren e vet të funksionimit dhe e bazon veprimtarinë e vet në procedura të miratuara nga studentët. Aktivitetet e KS mbështeten në forma të ndryshme nga ana e institucionit.
<b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të	Organizohen periodikisht aktivitete dhe evente të shumta me karakter akademik, social kulturor etj. Studentët e FIA dhe nëpërmjet KS ose

mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave jeburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	individualisht janë ftuar të marrin pjesë dhe të bashkëpunojnë në projekte e aktivitete shkencore e sociale, të cilat rrisin dhe përmirësojnë jetën sociale e profesionale të studentëve në FIA.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.	KS në bashkëpunim me Fakultetin dhe struktura të tjera të UMT, kryen një sërë aktivitete në vit, duke u nisur nga Konferencat studentore të mbështetur nga institucioni, apo në aktivitete ku studentët marrin pjesë në mënyrë aktive duke punuar tema shkencore dhe eksperimentale nën udhëheqjen e profesorëve, trajnime me tematika të ndryshme brenda e jashtë vendit. Nëpërmjet KS, studentët japin mendime për cilësinë e mësimdhënies dhe të programit të studimit si dhe lidhur me çështje të ndryshme, kurrikulat e programeve, praktikat, sezonet e provimeve etj. Përfshirja e studentëve në procesin e përmirësimit të metodologjisë së mësimdhënies në programin e studimit është i vazhdueshëm dhe bazohet në bashkëpunimin student-pedagog dhe për këtë FIA/UMT motivon studentët për bashkëpunim të vazhdueshëm.			
<b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Studentëve të të gjitha programeve të studimit, u mundësohet dhënia e mendimit për metodat e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. UMT ka të përcaktuar në rregulloren e provimeve dhe të programit të studimit modalitetet e këtij procesi, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e pedagogut përgjegjës të lëndës/modulit.  [Evidenca.01, statute i UMT; Evidenca.02, Rregullore e UMT; Evidenca.08, Përbërja e NjSBC] [Evidenca 9 Rregullore e NjSBC] [Evidenca 12: Aktet për përfshirjen e studentëve në organet kolegjiale të UMT-së] [Evidenca 105 Rregullore e Këshillit Studentor UMT] [Evidenca 58 Rregullore e programit] [Evidenca 120 Rregullore e provimeve] [RVB] [Shënime të vizitave në UMT]			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht <b>X</b>

<b>Standardi V.6</b> <b>Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	GVJ, referuar RVB, mëson që UMT ka të ngritur një sistem funksional informacioni për të përçuar tek studentët gjithë çfarë atyre u nevojitet në lidhje me PS: procesin mësimor, rregulloren e brendshme të institucionit, rregulloren e studimeve, rregulloren e provimeve, procedurat që lidhen me aktivitete të ndryshme të procesit mësimor etj. Në rang institucioni funksionon dhe një zyrë e posaçme e informimit të studentëve dhe e publikut që në organogramë quhet Drejtoria e Komunikimit. Informacionet shpërndahen si në hard copy ashtu edhe në format elektronik. Informacionet merren edhe nga faqja zyrtare e institucionit si dhe koordinatorët e programit. Po ashtu studenti informohet në kuadër të departamentit për organizimin e mësimin, aktivitete të ndryshme, diplomimin, ecurinë e procesit mësimor etj. Në strukturën organike të njësisë kryesore, informacione për studentët japin edhe Sekretaria Mësimore, Zyra e Këshillimit të Karrierës, Zyra

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr 219, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)


Faqe 59

	<p>e Mbështetjes së Studentëve etj. Aktiviteti informues i këtyre shërbesave rregullohet sipas parashikimeve ligjore dhe akteve rregullatore të UMT. Gjatë vizitës në institucion GVJ kontaktoi përfaqësues të Sekretarisë Mësimore, NjsBC, Zyrës së Kurrikulës e Cilësisë, Zyrës së Burimeve Njerëzore, Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, Zyrës së Shërbimit të Studentëve, Zyrës së Marrdhënieve me Jashtë, Zyrës së Hartimit e Menaxhimit të Projekteve. Në të gjitha këto takime GVJ u informua për aktivitetin e tyre në shërbim të studentëve.</p> <p>Evidenca 4 Organigrama, struktura  [Evidenca 50 Rregullore e FIA] [Evidenca 95 Rregullore e Sekretarisë] [Evidenca 77 Rregullore e Zyrës së Këshillimit të Karrierës] [RVB] [Shënimet e vizitave në UM] [<a href="http://www.umt.edu.al">www.umt.edu.al</a>]</p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Siç u trajtua më sipër institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p> <p>[Evidenca 50 Rregullore e FIA] [RVB] [Shënimet e vizitave në UM] [<a href="http://www.umt.edu.al">www.umt.edu.al</a>]</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>UMT ofron shërbimin e këshillimit të karrierës nëpërmjet Zyrës së Këshillimit të Karrierës. Nga kjo zyrë merren informacione në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p> <p>[Evidenca 50 Rregullore e FIA] [Evidenca 77 Rregullore e Zyrës së Këshillimit të Karrierës] [RVB] [Shënimet e vizitave në UM] [<a href="http://www.umt.edu.al">www.umt.edu.al</a>]</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Gjatë vizitës në UMT në takimin me përfaqësues të Zyrës së Këshillimit të Karrierës, GVJ konstatoi që kjo zyrë ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p> <p>[Evidenca 77 Rregullore e Zyrës së Këshillimit të Karrierës] [RVB] [Shënimet e vizitave në UM] [<a href="http://www.umt.edu.al">www.umt.edu.al</a>]</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

<b>Standardi VL1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Institucioni ka të sanksionuar në Statut përgjegjësinë institucionale për sigurimin e cilësisë në nivel institucional, programeve të studimit dhe aspekteve të veçanta të mësimdhënies e mësimnxënies.</p> <p>NJSBC është ngritur me Vendim të Senatit Akademik, dhe ka në përbërjen e saj 5 anëtarë permanentë dhe 1 ekspert të jashtëm. NJSBC ka hartuar politikat e Cilësisë në institucion, funksionon mbi bazën e rregullores së NJSBC, si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi.</p> <p>Angazhimin institucional për krijimin e mekanizmave të sigurimit të cilësisë, UMT e ka parashikuar në Planin e zhvillimit strategjik të Institucionit, në të cilin parashikohet përgjegjësia institucionale për konsolidimin e cilësisë dhe mekanizmat me të cilat kjo do të arrihet. Gjithashtu, institucioni në plotësim të objektivave strategjike të tij lidhur me sigurimin e cilësisë, ka në nivel drejtuesi zv/rektorin për sigurimin e cilësisë.</p> <p>[Evidenca 1 Statuti UMT] [Evidenca 3 Plani strategjik i UMT] [Evidenca 4 Organigrama, struktura e UMT] [Ligji 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”] [Evidenca 9 Rregullore e NJSBC] [Evidenca 7 VSA për ngritjen e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë] [RVB] [Shënimet e vizitave në UMT]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Njësisia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, është organi kryesor i sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel institucional, e cila harton procedura dhe politika për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe bashkëpunon me përfaqësuesit e saj në çdo njësi kryesore në përputhje me standardet shtetërorë të cilësisë dhe kodin e cilësisë.</p> <p>Njësisia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është organ kolegjal. Ajo përbëhet nga përfaqësues të personelit akademik të njësisive kryesore, (një) përfaqësues i Këshillit Studentor dhe (një) ekspert i jashtëm dhe (një) përfaqësues i administratës. Anëtarët e Njësisë miratohen nga Senati Akademik me propozim të Rektorit. Kompetencat e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. harton politikat dhe procedurat për sigurimin e brendshëm të cilësisë, akte të cilat miratohen nga Senati Akademik.</li> <li>2. harton standardet për sigurimin e cilësisë në përputhje me Kodin e Cilësisë.</li> <li>3. vlereson në mënyrë periodike rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore shkencore në njësitë kryesore</li> <li>4. të Universitetit në përputhje me standardet.</li> <li>5. kryen studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga Universiteti.</li> </ol>

	<p>6. Në fund të çdo semestri, para sezonit të provimeve, organizon pyetësonin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi.</p> <p>7. pas çdo vlerësimi bën me dije Rektoratin lidhur me rezultatet dhe propozimet përkatëse.</p> <p>8. pas çdo vlerësimi raporton para Senatit Akademik rezultatet dhe propozimet përkatëse.</p> <p>Në zbatim të detyrimeve që lindin në përmbushje të standardeve dhe kritereve të sigurimit të cilësisë dhe përcaktimeve të NJSBC në nivel institucional, FIA ka të përcaktuar personin përgjegjës i cili koordinon procesin e sigurimit të cilësisë në Fakultet dhe bashkërendon punën me NJSBC në nivel institucional.</p> <p>Për monitorimin e cilësisë së mësimdhënies, FIA ka përdorur instrumentet standarde të hartuara nga NJSBC për mbledhjen e informacionit sikundër janë takimet, sondazhet dhe anketimet me studentët. NJSBC ka përgatitur një set pyetjesh sipas tematikave të cilat janë shpërndarë tek studentët për t'u plotësuar në mënyrë anonime. Më pas janë analizuar të dhënat dhe është finalizuar procesi dhe komunikuar rezultatet.</p> <p>Në nivel fakulteti, kryhet vlerësimi i performancës të personelit akademik në lidhje me ofrimin cilësor të programit të studimit, jo vetëm në aspektin e mësimdhënies, por dhe në aspektin e kërkimit shkencor, kontributit për institucionin. Përgjegjësit e departamenteve, në përfundim të vitit akademik, plotësojnë performancën e stafit akademik përkatës. Për secilin pedagog bëhet vlerësimi sipas formularit të performancës.</p> <p>Përgjegjësit e departamenteve vlerësojnë edhe aktivitetin administrativ të pedagogëve duke vlerësuar korrektesën në kryerjen e detyres se mesimdhënjes, realizimin e shërbimeve ndaj studentëve, respektimin e afateve kohore të këtyre aktiviteteve dhe të rregullores së fakultetit. Plotësimi i performancës së stafit akademik i bëhet me dije Dekanit dhe depozitohet në Dekanat. Në përfundim të këtij procesi hartohet raporti paraprak, i cili është vënë në dispozicion të titullarit të fakultetit. Të gjithë analizat /raportet/të dhënat e dala nga procese vlerësimi janë pjesë e raporteve vjetore në nivel departamenti/fakulteti/universiteti, duke evidentuar problematika sipas aspekteve dhe adresuar ato për zgjidhje, proces ky i vazhdueshëm lidhur me përmirësimin e cilësisë.</p> <p>[Evidenca 1 Statuti UMT] [Evidenca 3 Plani strategjik i UMT] [Evidenca 4 Organigrama, struktura e UMT] [Evidenca 9 Rregullore e NJSBC] (Evidenca 8 Përbërja e NJSBC) [Evidenca 10 Analizë e NJSBC për pyetësonët e stafit akademik] [Evidenca 11, Model i pyetësonit për studentet] [Tab 7-Stafi sipas kualifikimit] [Evidenca 7 VSA për ngritjen e Njësise së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë] [Evidenca 73 Raport vjetor i aktiviteti mësimor, kërkimor dhe financiar 2019-2020] [Evidenca 40 Plani Vjetor 2019 - 2020 – FIA] [RVB] [Shënimet e vizitave në UMT]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të</p>	<p>Referuar RVB mësohet që krahas SBC përdoret edhe SJC (Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë). Sa i përket SBC institucioni e ka të ngritur dhe funksional atë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentë dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm. Për</p>




<p>jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>sigurimin nga jashtë të cilësisë në UMT janë bërë edhe akreditime institucionale edhe akreditime për PS. Nëpërmjet tyre janë dhënë vlersime SWOT, të cilat e kanë inkurajuar institucionin të punojë për realizimin e rekomandimeve. GVJ konstaton që rekomandimet e akreditimit të fundit për PS “Bch në Inxhinieri Ndërtimi”, lidhur me tërheqjen e studentëve me notë mesatare më të lartë janë konsideruar nga institucioni dhe janë paraqitur në RVB.</p> <p>[Evidenca 9, rregullore e NJSBC) (Evidenca 8 Përbërja e NJSBC) [Evidenca.10 Analizë e NJSBC për pyetësorët e stafit akademik] [Evidenca 13 Vendimi për akreditimin instucional të UMT nga BA dhe Certifikata e akreditimit] [Tab 7- Stafit sipas kualifikimit] [RVB] [Shënimet e vizitave në UMT]</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Në ndjekje të dinamikës së ecurisë së PS në UMT, konstatohet rritja dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë. Kjo tregon që institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit “Bch në Inxhinieri Ndërtimi”, në kuadër të SBC-së.</p> <p>[Evidenca 9, rregullore e NJSBC] [Evidenca 7 VSA për ngritjen e Njësise së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë] [Evidenca 18 Politika e cilësisë UMT] [Evidenca 13 Vendimi për akreditimin instucional të UMT nga BA dhe Certifikata e akreditimit] [Evidenca 8: Përbërja e NJSBC-së] [RVB] [Shënimet e vizitave në UMT]</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

**Standardi VI.2 Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p>	<p>UMT si IAL ka ngritur njësitë e tij për sigurimin dhe realizimin e cilësisë. Njësia përgjegjëse për PS “Bch në Inxhinieri Ndërtimi” është Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit. Ai jo vetëm organizon konkretisht gjithë aktivitetet e këtij PS por edhe koordinon punën për realizimin sa më cilësor të tij. Në UMT përgjegjësia administrative për SC bie mbi drejtuesin e departamentit dhe koordinatorin e programit. Detyrat e tyre rregullohen me dispozita ligjore (EV 2, 58). Pasi sigurohen të dhënat ato dërgohen në FIA, i cili koordinon aktivitetin për SC me NJSBC. Kjo e fundit, mbështetur në rregulloren e saj (EV 9) kryen vlerësimin e brendshëm të cilësisë dhe bashkëpunon me vletësimin e jashtëm. Përveç kësaj, nga Njësia kryesore kryhen periodikisht monitorime te procesit mësimor, rezultatet e të cilave analizohen dhe, nga këto analiza nxirren përfundime për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë (EV 122)</p> <p>[Evidenca 2 UMT Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana] [Evidenca 58 Rregullore e programit te studimit] [Evidenca 9 Rregullore e NJSBC] [Evidenca 122 Plan monitorimi për mësimdhënien FIA] [RVB] [Shënimet e vizitave në UMT]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe</p>	<p>Në UMT përdoren mekanizma të tillë si analiza vjetore në rang fakultetesh, ku evidentohet cilësia e PA, cilësia e syllabuseve, cilësia e literaturës së përdorur, rezultatet e studentëve, marrëveshjet e bashkëpunimit, veprimtaria kërkimore</p>



Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr 219, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 63

mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.	shkencore, infrastruktura në funksion të programit etj, duke hartuar një plan masash për përmirësim e PS edhe në studimet e ciklit të parë [Tabela 21 Cilësia në hyrje dhe dalje e studentëve] [Tabela 23 Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve] [RVB Shënimet e vizitave në UMT]			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	Si metodologji vlersimi, në UMT përdoren “Pyetsorët për vlersimin e pedagogëve” që plotësohen në fund të çdo semestri. Rol të veçantë merr Bordi i Provimeve i cili vlerëson cilësinë e provimeve dhe përgadit raporte vjetore që ia dërgon për shqyrtim e veprim Komisionit të Përhershëm për SC dhe Senatit. Përdoret si metodologji edhe vlersimi i performances akademike në mësimdhënie, kërkim shkencor e projekte.  [Evidenca 58 Rregullore e Programit] [Evidenca 10 Analizë e NjSBC për pyetsorët e stafit akademik] [Evidenca 11 Model i pyetsorit për studentët] [Evidenca 18 Politika e cilësisë UMT] [Evidenca 42 Shembull. Praktika e miratimit dhe përmirësimit të kurrikulës të një PS] [Evidenca 68 Modeli i formularit të vlerësimit të Performacës] [Tabela 6 Cilësia e stafit mësimdhënës për PS] [RVB] [Shënimet e vizitave në UMT]			
<b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Të gjitha gjetjet në procedurat dhe metodologjitë për sigurimin e cilësisë u përcillen autoriteteve vendimmarrëse për PS (përgjegjës departamenti/dekan) si dhe organeve kolegjiale (dekanati/senati akademik) të cilët, mbështetur në aktet ligjore e nënligjore marrin masat përkatëse.  [Evidenca 2 UMT Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana] [Evidenca 9 Rregullore e NjSBC] [Evidenca 58 Rregullore e Programit] [Evidenca 18 Politika e cilësisë UMT] [Evidenca 68 Modeli i formularit të vlerësimit të Performacës] [RVB] [Shënimet e vizitave në UMT]			
<b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.	Raportet e vlerësimit përfshijnë rezultatet e arritura dhe masat që merren për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë. Ato paraqiten në senat dhe në Bordin e Administrimit ku diskutohet e miratohet plan i masave me afate të përcaktuara për realizim. GVJ, nisur nga puna e bërë por edhe nga historia e vlersimeve, përkatësisht akreditimeve, gjykon që sigurimi dhe përmirësimi i cilësisë në PS “Bsc në Inxhinieri Ndërtimi” ka arritur gjithmonë në rritje.  [Evidenca 50 Rregullore e FIA] [Evidenca 71 Modeli i formularit të vlerësimit të Performacës] [Evidenca 73 Raport vjetor i aktivitetit mësimor kërkimor e financiar] [Evidenca 93 Raport mbi aktivitetin kërkimor shkencor të stafit akademik] [Evidenca 115 Procesverbali i kontrollit në auditore] [Evidenca 119 Vendimi i Senatit për vlerësimin e vazhduar] [RVB] [Shënimet e vizitave në UMT]			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht <b>X</b>

<b>Standardi VI.3</b> <b>Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtijshme të studentëve</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësisia e	Në arkivën e UMT janë dokumentuar të gjitha proceset e vlersimeve të PS, si ato të brendshme ashtu edhe ato të jashtme (akreditime) nga viti 2010-



Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr 219, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 64



<p>brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>2011 kur është hapur PS “Bch në Inxhinieri Ndërtimi”. Në të gjitha rastet konstatohet që konkluzionet e vlersimeve janë përdorur për të bërë progres në SC. Pra UMT e ka përfshirë këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p> <p>[Evidenca 13 Vendimi për akreditimin institucional të UMT nga BA dhe certifikata e cilësisë] [Evidenca 16 Aplikimi në ASCAL për akreditimin e PS mbi fillimin e procesit të vlerësimit] [Evidenca 18 Politika e cilësisë UMT] [Evidenca 50 Rregullore e FIA] [Evidenca 114 Rregullore e arkivës UMT] [RVB Shënimet e vizitave në UMT]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>UMT për kryerjen e vlerësimit ka përdorur metodat e mëposhtme të vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Monitorimin nga NjsBC në nivel institucional</li> <li>• Monitorim i vazhduar nga koordinatori i programit</li> <li>• Vlersime nga komisione ad-hoc të ngritura nga dekani në bashkëpunim me NjsBC.</li> <li>• Sondazhe, anketime dhe mbledhje informacioni nga studentët</li> <li>• Monitorime nga drejtuesit e departamentit</li> </ul> <p>Në të gjitha rastet është marrë parasysh natyra dhe specifika e fushës akademike të programit të studimit.</p> <p>[Evidenca 2 Rregullore e UMT] [Evidenca 50 Rregullore e FIA] [Evidenca 9 Rregullore e NjsBC] [Evidenca 7 VSA për ngritjen e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë] [Evidenca 71 Modeli i formularit të vlerësimit të Performacës] [Evidenca 115 Procesverbali i kontrrollit në auditore] [Evidenca 119 Vendimi i Senatit për vlerësimin e vazhduar] [RVB Shënimet e vizitave në UMT]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>GVJ konstaton që në UMT në kuadër të vlerësimit, realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdoren metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim i didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës. Të gjitha këto metoda janë dokumentuar dhe rezultatet e tyre janë përdorur për të realizuar përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Një tregues për këtë janë edhe rezultatet e akreditimeve institucionale e programore.</p> <p>Evidenca 2 Rregullore e UMT] [Evidenca 50 Rregullore e FIA] [Evidenca 9 Rregullore e NjsBC] [Evidenca 7 VSA për ngritjen e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë] [Evidenca 71 Modeli i formularit të vlerësimit të Performacës] [Evidenca 115 Procesverbali i kontrrollit në auditore] [Evidenca 119 Vendimi i Senatit për vlerësimin e vazhduar] [RVB Shënimet e vizitave në UMT]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit</p>	<p>GVJ konstaton që në UMT, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdoren metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit, institucioneve që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr 219, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)


Faqe 65

<p>akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>program. Të gjitha këto metoda janë dokumentuar dhe rezultatet e tyre janë përdorur për të realizuar përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Një tregues për këtë janë edhe rezultatet e akreditimeve institucionale e programore.</p> <p>Evidenca 71 Modeli i formularit të vlerësimit të Performacës] [Evidenca 10 Analizë e NjSBC për pyetorët e stafit akademik] [Evidenca 11 Model pyetori për studentët] Evidenca 18 Politika e cilësisë] [RVB Shënimet e vizitave në UMT]</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

**Standardi VI.4**

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Në dokumentet rregullatore të këtij institucioni thuhet se “<i>të gjitha strukturat përbërëse të UMT janë përgjegjëse për SC të PS-ve që ai ofron bazuar në mekanizmat e SC dhe akteve rregullatore.</i> Synimi kryesor i përcaktuar në këto akte është gjithëpërfshirja e kontribuesve në procesin e mësimdhënjes dhe aktiviteteve të tjera akademike. Në këtë kuadër, përgjegjësi kryesor për mbarëvajtjen dhe cilësinë e PS “Bsc në Inxhinieri Ndërtimi” është “Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit. Pikërisht kjo njësi përgjegjëse ka ngritur, propozuar, aktivizuar e monitoruar gjithë aktivitetin për SC. Po ashtu fakulteti i FIA ka koordinuar këtë aktivitet, realizimi i të cilit pastaj kërkon gjithëpërfshirje të strukturave të institucionit. RVJ konstaton që SC për PS “Bsc në Inxhinieri Ndërtimi” është realizuar me përfshirjen e gjithë aktorëve, të brendshëm e të jashtëm, të interesuar dhe të ngarkuar për këtë process.</p> <p>Evidenca 2 Rregullore e UMT] [Evidenca 50 Rregullore e FIA] [Evidenca 9 Rregullore e NjSBC] Evidenca 16 Aplikimi në ASCAL për akreditimin e PS mbi fillimin e procesit të vlerësimit] [Evidenca 18 Politika e cilësisë] [RVB Shënimet e vizitave në UMT</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>UMT, mbështetur në aktet ligjore (Ligji 80/2015) dhe ato rregullatore ka përcaktuar përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe kërkon e garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave. Kryesore në këtë proces është NjSBC, në përbërje të së cilës ka aktorë të brendshëm, studentë dhe aktorë të jashtëm. Të dhënat e kërkuara dhe të siguruar nga kjo zyrë i vihen në dispozicion GVB i cili harton RVB. GVJ i ka konsultuar të gjitha materialet e DVV, ka hartuar protokollin e takimeve në institucion dhe konstaton që aktorët e ngarkuar për SC i kanë ushtruar me përgjegjësi detyrat e tyre.</p> <p>[Ligji 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” Evidenca 1 UMT Statuti i Universitetit Metropolitan Tirana. Evidenca 2 UMT Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana] [Evidenca 3 Plani strategjik i zhvillimit të UMT]</p>




	[Evidenca 8: Përbërja e NJSBC-së] Evidenca 9 Rregullore e NJSBC] Evidenca 18 Politika e cilësisë] [RVB Shënimet e vizitave në UMT]			
<b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.	Në shqyrtimin e gjithë materialeve të DVV si dhe në takimet gjatë vizitës në UMT, GVJ gjen që në sigurimin e cilësisë në PS “Bch në Inxhinieri Ndërtimi” është garantuar dhe është realizuar përfshirja e njësisë bazë (Departamentit të Inxhinierisë së Ndërtimit) dhe kryesore (FIA), përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.  [Evidenca 2 UMT Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana] [Evidenca 3 Plani strategjik i zhvillimit të UMT] [Evidenca 8: Përbërja e NJSBC-së, ] [Evidenca 9 Rregullore e NJSBC] [Evidenca 18 Politika e cilësisë] [RVB] [Shënimet e vizitave në UMT]			
<b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Në kontrollin, realizimin dhe monitorimin e cilësisë për PS “Bsc në Inxhinieri Ndërtimi”, të dhënat e përdorura janë të plota, të qarta dhe të sakta. Këto cilësi të të dhënave u konfirmuan edhe gjatë vizitës së GVJ në institucion. Kjo dëshmon që përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit ka respektuar integritetin akademik dhe ka shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.  [Dosja e vetëvlersimit] [RVB] [Shënimet e vizitave në UMT]			
<b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Për krijimin e bazës së të dhënave lidhur me plotësimin e standarteve të cilësisë janë përfshirë edhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me PS. Në grupet e vetëvlersimit janë përfshirë edhe pedagogë të huaj të angazhuar si PAE në PS si dhe studentë. Po ashtu nga vizita në institucion, GVJ mësoi që janë konsultuar edhe ekspertë të tjerë nga tregu i punës dhe nga partnerët bashkëpunues. Mëndimet dhe sugjerimet janë konsideruar jo vetëm duke u përfshirë në RVB por edhe duke u realizuar konkretisht.  [Dosja e vetëvlersimit] [RVB] [Shënimet e vizitave në UMT]			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<b>Standardi VI.5</b>	
<b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Në DVV gjen që politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për PS “Bch në Inxhinieri Ndërtimi” janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. GVJ, gjatë vizitës në institucion, në takim me përfaqësues të zyrave të NJSBC dhe asaj të Kurrikulës dhe Cilësisë u njoh me veprimtarinë konkrete të këtyre zyrave dhe konstaton që aktiviteti konkret i tyre synon dhe realizon përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Dëshmi e këtij progresi janë edhe rezultatet e akreditimeve si të institucionit ashtu edhe të PS “Bsc në Inxhinieri Ndërtimi”

	Evidenca 2 Rregullore e Universitetit Metropolitan Tirana] [Evidenca 3 Plani strategjik i zhvillimit të UMT] [Evidenca 8: Përbërja e NjSBC-së] [Evidenca 9 Rregullore e NjSBC] [Evidenca 18 Politika e cilësisë] RVB] [Shënimet e vizitave në UMT]
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Gjatë takimit me përfaqësues të zyrave të NjSBC dhe asaj të Kurrikulës dhe Cilësisë, GVJ u informua për të gjitha procedurat që ndiqen nga këto zyra për sigurimin e cilësisë, duke filluar me rishikimin e planeve mësimore, vlersimin e mësimdhënjes nga pedagogët nëpërmjet vizitave në klasa dhe intervistimit të tyre mbi cilësinë e programeve, angazhimin e studentëve nëpërmjet sondazheve mbi zhvillimin e provimeve etj. Në këto zyra shqyrtohej edhe RVB, ndiqej plotësimi i standardeve të kërkuara për akreditimin e programeve, ndërtimi i pyetsorëve, krijimi i sistemit të patronazhit, ku pedagogët e vjetër ndihmojnë të rinjtë etj. E gjithë procedura publikohet duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.  [Evidenca 8: Përbërja e NjSBC-së] [Evidenca 9 Rregullore e NjSBC] [Evidenca 14 Rregullore e etikës] [Evidenca 18 Politika e cilësisë] [RVB] [Shënimet e vizitave në UMT]
<b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Gjatë takimit me NjSBC dhe përfaqësuesit e Zyrës të Kurrikulës dhe Cilësisë, GVJ mësoi që i gjithë aktiviteti i tyre organizohet dhe realizohet mbi bazën e një plani periodik, në hartimin e të cilit merren në konsideratë të gjitha problemet e evidentuara nga aktiviteti i mëparshëm me synim përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.  [Evidenca 9 Rregullore e NjSBC] [Evidenca 18 Politika e cilësisë] [RVB Shënimet e vizitave në UMT]
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Sipas RVB, proceset e vlerësimit në kuadër të akreditimit të UMT si institucion apo si programe, kanë patur impakt në ndërgjegjësimin e të gjitha strukturave, personelit akademik dhe studentëve për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë. GVJ konstaton që UMT çmon dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, për përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit “Bch në Inxhinierinë e Ndëtimit”.  [Evidenca 18 Politika e cilësisë] [Evidenca 13 Vendimi për akreditimin institucional të UMT nga BA dhe certifikata e cilësisë] [Evidenca 16 Aplikimi në ASCAL për akreditimin e PS mbi fillimin e procesit të vlerësimit] [Evidenca 8: Përbërja e NjSBC-së] [RVB] [Shënimet e vizitave në UMT]
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Për informimin dhe ndërgjegjësimin e personelit dhe studentëve mbi sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit “Bch në Inxhinieri Ndërtimi”, NjSBC organizon takime me strukturat e rektoratit dhe fakulteteve. Takime kryhen edhe me studentët dhe përfaqësuesit e tyre në organet kolegjiale. Po ashtu studentët kanë përfaqësuesit e tyre në Grupin e Vetëvlersimit dhe NjSBC, çfarë u mundëson atyre që të përcjellin në mënyrë të vazhdueshme mendimet e tyre mbi problemet e cilësisë dhe të sugjerojnë masa që duhen marrë për përmirësimin e mëtejshëm të saj.  [Evidenca 7 Vendimi i Senatit Akademik (VSA) për ngritjen e NjSBC] [Evidenca 8: Përbërja e NjSBC-së] [RVB Shënimet e vizitave në UMT]

Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Inxhinieri Ndërtimi”, “Universiteti Metropolitan Tirana”**

**Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Programi i studimit “Bsc në Inxhinieri Ndërtimi” realizohet ne përputhje me strategjinë dhe profilin e institucionit.
2. Programi studimit “Bsc në Inxhinieri Ndërtimi” mbështetet në një plan mësimor të mirëstrukturuar dhe kompetitiv, çfarë dëshmohet me thithje kontigjentesh cilësore dhe përqindje të lartë punësimi në tregun e punës.
3. Stafi akademik rezulton i kualifikuar dhe kompentent në transmetimin e dijeve dhe njohurive tek studentët, duke i vlerësuar ata objektivisht, duke i orientuar ata drejt së dobishmes dhe duke i motivuar për përvetësim cilësor e të qëndrueshëm të njohurive.
4. Akordimi i bursave në këtë program studimi bëhet i motivuar, shpërblyes por edhe social, duke inkurajuar e realizuar interesim për prurje më cilësore, çfarë e dëshmon dhe rritja e cilësisë së kontigjenteve në hyrje dhe e konkurrencës në rezultate.
5. Cilësia e bashkëpunimi me ALUMNI është reflektuar në përmirësimin e procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies si dhe kapjen e tregut të punës.
6. Projektet e bashkëpunimit në përgjithësi si dhe ato të mobilitetit në veçanti kanë ndikuar në shkëmbim përvojash dhe futje risish në PS “Bsc në Inxhinieri Ndërtimi”.
7. Përdorimi i platformave online në zhvillimin dhe realizimin procesit mësimor në PS “Bsc në Inxhinieri Ndërtimi” rezultojnë të suksesshme dhe pse ato janë dizenuar, duke marrë në konsideratë veçoritë e aktivitetit të institucionit dhe të programeve të studimeve.
8. PS zhvillohet në një ambient ku ekziston një lidhje e fortë dhe ndërveprim i suksesshëm midis fakultetit dhe studentëve.
9. Një inkurajim dhe motivim i fortë për PS “Bsc në Inxhinieri Ndërtimi” në rrugën e produkteve cilësore janë edhe vlerësimet nga aktorë të jashtëm si Agjensia e Akreditimit, Tregu i punës, Alumni etj.

**Pika të dobta**

1. Edhe pse plotësohen kriteret e standarteve si për hapsirën ashtu edhe për fondin e bibliotekës, ne kuadrin e rritjes së ofertës për literaturë dhe kërkesës që ajo të jetë sa më bashkëkohore konstatohet që situata aktuale nuk është në nivelin e kërkuar për shfrytëzimin eficient të saj.

2. Mosprania e terreneve të dedikuara sportive brenda territorit të Universitetit krijon problem për realizimin e dëshirave si të studentëve ashtu dhe PA në ushtrimin e këtyre aktiviteteve
3. Numri i kufizuar i vendparkimeve i bën të vështira dhe jo të preferuara vizitat për ta njohur më nga afër infrastrukturën akademike dhe administrative të institucionit, çfarë ndikon jo pozitivisht në rritjen e pëlqyeshmërisë për të.
4. Numri i kufizuar i projekteve të doktoratave ndikon në ngadalësim të procesit të kualifikimit të personelit akademik dhe paksimin e numrit të studentëve, që duan të përfshihen në to.



### **GVJ identifikon këto pika për përmirësim të mëtejshëm:**

1. *Zgjerim të hapësirës ambientale dhe shtim të fondit në bibliotekën e institucionit. Ky rekomandim mbështet edhe objektivat që ka vetë UMT.*
2. *Shtim të terreneve sportive për ta bërë më atraktiv qëndimin e studentëve dhe personelit në ambientet e institucionit*
3. *Zgjerim të mundësive të parkimit për të lehtësuar lëvizjet drejt dhe nga institucioni..*
4. *GVJ sugjeron një përfshirje edhe më të madhe në projekte për realizimin e programeve të doktoratave, natyrisht duke shfrytëzuar mundësitë për financimin, aktivizimin dhe zhvillimin e tyre.*

### **Conclusions of the Evaluation of the study program of the first cycle Bachelor in “Civil Engineering” of the “Metropolitan Tirana University”**

#### **Strengths and affirmations**

1. The study program, “Bachelor in Civil Engineering”, is realized in line with the strategy and the profile of the institution.
2. The study program, “Bachelor in Civil Engineering”, relies on a well-structured and competitive curriculum, which is evidenced by the absorption of qualitative contingents and high rates of employment in the labor market.
3. The academic staff results qualified and competent in transmitting knowledge to students, by objectively evaluating them, by orienting and motivating them for acquiring qualitative and sustainable knowledge.
4. The allocation of scholarships in this study program marks it more motivating, rewarding and social, by encouraging and realizing interest for better quality input, which is evidenced by the increase in the quality of incoming contingents and competition in results.
5. The quality of cooperation with ALUMNI is reflected in the improvement of the teaching and learning process, as well as highly reaching the labor market.
6. General cooperation projects and those of mobility in particular, have influenced the exchange of experiences and have introduced innovations in the study program “Bachelor in Civil Engineering”.



7. The use of online platforms in the development and implementation of the teaching process in the study program "Bachelor in Civil Engineering" are successful and are designed by taking into account the specifics of the activity of the institution and study programs.
8. The study program is realized in an environment where there is a strong connection and successful interaction between faculty and students.
9. A strong encouragement and motivation for the study program "Bachelor in Civil Engineering" in the way of quality products, are the evaluations by external actors such as the Accreditation Agency, Labor Market, Alumni, etc.

#### **Weak points**

1. Although the criteria of standards are met for both the environment and the library fund, in the context of increasing the supply of literature and the demand, in order to be as contemporary as possible, it is concluded that the current situation is not at the level required for its efficient use.
2. The absence of dedicated sport fields in the territory of the University creates problems in the realization of student's and academic staff desires in realizing these activities.
3. The limited number of parking lots makes visits difficult and not preferable, to get to know more closely the academic and administrative infrastructure of the institution, which has a negative effect in increasing the fondness of the University.
4. The limited number of doctoral projects affects in slowing down the qualification process of the academic staff and the reduction of the number of students who want to be included in them.

#### **Recommendation**

1. *Expansion of the environmental space and increase of the fund in the library of the institution. This recommendation also supports the objectives of MTU itself.*
2. *Addition of sports fields to make the visit of students and staff in the premises of the institution more attractive*
3. *Expansion of parking possibilities to facilitate movements to and from the institution.*
4. *External Evaluation Group suggests an even greater involvement in projects for the implementation of doctoral programs, by using the opportunities for their financing, activation and development.*



**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Përbushen plotësisht	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X